

RITA PETRO:

Në romanin tim nuk dua që njerëzit të lexojnë historinë time, por historinë e vetes së tyre

Bisedoi Andreas Dushi

Pas disa vëllimesh të njohura me poezi si “Vrima”, “Këtu poshtë këndohet live” etj., Rita Petro vjen për herë të parë me një roman, “Lindur së prapthi” botuar nëntorin e kaluar. Kjo bisedë me të lidhet pikërisht me këtë roman, por jo vetëm. Flitet edhe për lexuesin ideal, idealin e letërsisë apo dilema mes prozës dhe poezisë...



EPISODI I PESTË:

**HISTORIA DHE KOHA.
EVOKIMI I REALIZMIT TË
SHEK. XIX NË ROMANET
E ANILDA IBRAHIMIT.**

Nga Dr. Fabio M. Rocchi



Veprat e Anilda Ibrahim përfaqësojnë kulmin e asaj triade ideale shkrimtaresh – Dones, Vorpsi dhe, pikërisht, Ibrahim – që ka krijuar në panoramën italofoone një univers njohës kompakt. Ky univers ka qenë koherent nën profilin e temave dhe karakteristikave të personazheve dhe situatave më të shpeshta të shfaqura në fabula.

**SI MË MBROJTËN
TRIFON XHAGJIK A DHE
STAVRI RAFAEL**

nga Sadik Bejko

(fq. 5)

Ndjehem krenar, veçanërisht i vlerësuar, që (nga “Klubi i Poezisë”) më nderuan të jem në fshatin Peshtan, dhe që munda të flas në ditën e inaugurimit të memorialit të poetit të pushkatuar Trifon Xhagjika.

SHËNIME MBI LIBRAT

**INTERTEKSTUALITETI
NË ROMANIN “KUSH
E SOLLI DORUNTINËN”
TË KADARESË**

Nga Islam Haxhiu

(fq. 10)

Refleksion rreth veprës *Zbulimi i Zef Pllumit*
të autorit Kujtim M. Shala

**DASHURIA PËR NJERIUN
DHE PËR DHEUN
LAJTMOTIV I VEPRËS**

Nga Mikel Gojani

(fq. 8)


**SHËNIME PËR ROMANIN
“MJALT NË TEH” TË
ROMEO ÇOLLAKUT**

Nga Namir Lapardhaja

(fq. 9)

**RALPH WALDO
EMERSON
DASHURIA**

(fq. 21)



BIBLIOTEKË

Zdravka Eftimova

(fq. 20)

Dy tregime

Agha Shahid Ali

(fq. 12)

Poezi

Enxhi Naum

(fq. 15)

Bardh'

Vëllezërit Grim

(fq. 14)

Peshkatari dhe gruaja e tij

**ARBEN DEDJA
NË PËRKTHIM
DHE KRIJIM**

(fq. 16)

**PASAKTËSITË NË
PËRKTHIMIN E VËLLIMIT
TË PARË TË ROMANIT
“LUFTA DHE PAQJA”**

Nga Theodor Cico

(fq. 18)

Pas disa vëllimesh të njohura me poezi si “Vrima”, “Këtu poshtë këndohet live” etj., Rita Petro vjen për herë të parë me një roman, “Lindur së prapthi” botuar nëntorin e kaluar. Kjo bisedë me të lidhet pikërisht me këtë roman, por jo vetëm. Flitet edhe për lexuesin ideal, idealin e letërsisë apo dilema mes prozës dhe poezisë...

RITA PETRO:

NË ROMANIN TIM NUK DUA QË NJERËZIT TË LEXOJNË HISTORINË TIME, POR HISTORINË E VETES SË TYRE

Bisedoi Andreas Dushi

A.D.: Roman! Rita Petro vjen me një roman. Edhe vetë titull i tij, “Lindur së prapthi” duket si vijim logjik i krijimtarisë së saj: “së mbari” i lindin poezitë, ndaj romani me patjetër është i lindur ndryshe, mbrapsht. Çfarë është për një poete botimi i një libri në prozë?

R.P.: Surprizë për ju dhe surprizë edhe për vetë mua. Asnjëherë nuk e kisha menduar se do të shkruaja në prozë, se do të rrëfeja. Poezia ishte bërë pjesë e pandashme e krijimtarisë sime. Por, si duket, ishte një kalim i butë e i natyrshëm nga libri me poema “Vrima”, në të cilin iu shmanga lirikave që kisha shkruar deri atë kohë dhe kjo shmangie më erdhi pa sforcim. Ideja për të shkruar librin “Vrima” ishte mendimi filozofik se si lind jeta në tokën ku jetojmë sot, se si vijmë ne vetë në këtë jetë, se si ne lindim e rilindim, raporti kozmik me raportin e përditshmërisë. Dhe struktura e poemës sime rrëfen jetën e njeriut nga lindja në vdekje. Kaq mund të mbante një rrëfim në varg. Më mbetën jashtë kujtime të fëmijërisë e të rinisë që doja patjetër t’i rrëfeja. Dhe natyrshëm ato vinin në kokën time përmes rrëfimit në prozë, po sigurisht së prapthi, ndryshe nga rrëfimet ku ndihet roli i autorit. E “anashkalova” Ritën e rritur dhe i dhashë përparësi Ritës së vogël. Dhe Rita e vogël ia doli. Rita e rritur nuk mund “të fuste hundët” te mendimet e përjetimet e Ritës së vogël dhe t’i interpretonte ato sipas qejfit, duke u nisur nga këndvështrimi i sotëm. Kështu gjeta stilin. Stili më dhuroi romanin.

A.D.: Si hera jote e parë me prozën, a është “Lindur së prapthi” një përjetim i paharrueshëm, njëlloj si herët e para në gjithçka?

R.P.: Patjetër që po. Ashtu si dhe me poezitë apo poemat, kam përjetuar


një energji të jashtëzakonshme. Kam gërmuar brenda vetes aq shumë shtresa kujtimesh e mbresash. Hoqa dorë nga albumet fotografike, ditarët, kujtimet e shkruara. Doja gjithçka të më vinte bio në kokë. Kam përjetuar në tru e në trup ndjesi të asaj kohe. Ishte e habitshme... ndjeva të zvogëlohesha apo të rinohesha... shumë gëzime e dhimbje njëkohësisht. Ripërjetova fëmijërinë dhe rininë time. Dhe, kur romani shkoi në shtyp, ndjeva që kisha çliruar gjithë atë energji për ta transmetuar te lexuesi. Dhe vërtet kushdo që e ka lexuar romanin, më ka shprehur se është ndier pikërisht kështu.

A.D.: Për të shkruarin rreth vetes ka disa terma, nga autobiografi deri tek autofiksion. Me romanin tënd, ti çfarë bën, krijon fiksion të nxitur nga faktet reale apo ata fakte i paraqet ashtu sikurse janë, por duke përzgjedhur fjalët me kujdesin e poetes?



R.P.: Të them të drejtën nuk kam dashur që njerëzit të lexojnë historinë time, por historinë e vetes së tyre. Nuk kam dashur t’u jap prioritet fakteve, sesa ndjeshmërisë se si përjetoreshin ngjarjet që ndodhnin në kohën e komunizmit. Dhe veçanërisht ato ndjesi të errëta që shpesh i quajmë të turpshme. Fakti që sapo kanë mbaruar së lexuari romanin, shumë lexues kanë nisur të tregojnë për veten e tyre, tregojnë se ia kam arritur qëllimit. Dhe këtë provokim, më tepër se një histori personale autobiografike, mund ta bëjë vetëm arti, në këtë rast një roman.

A.D.: Është shkruar shumë për komunizmin nga shkrimtarët shqiptarë, duke u ndalur në aspekte nga më të ndryshmit, por ky i vështirimit të botës nga lart – poshtë, nga Zoti te skllavi, nga burri te gruaja, nga udhëheqësi tek i dënuari, nga heroi tek armiku vjen për herë të parë. Ka qenë i tillë përjetimi yt në atë kohë apo kështu do ta kujtosh atë në këtë kohë?



R.P.: Çdo fëmijë e sheh botën nga poshtë-lart, nuk e shpika unë, thjesht e shfrytëzova këtë detaj për romanin tim. Fëmija ka aq shumë imagjinatë dhe i bën gjërat ndryshe nga i rrituri, zvarritet, rrotullohet, futet poshtë tavolinës, flet me personazhet e përrallave që i tregojnë të rriturit, ka mënyrën e vet të përjetimit të ngjarjeve rreth e qark tij. Po të rriturit kujdesen vetëm sipërfaqësisht për fëmijët. P.sh., në roman personazhi kryesor ngatërron fytyrën e Zotit, për të cilin i ka folur gjyshja, me figurën e Udhëheqësit të Madh, por dhe me autoritetin e Babait në shtëpi. E kam shfrytëzuar këtë fakt. Apo brengën e largimit të shokut të ngushtë brenda natës, për shkak të internimeve në atë kohë.

A.D.: Jordan Peterson në një shqyrtim që i bën *Bukuroshes së Fjetur* te libri i tij “12 rregulla”, thotë se shpimi i gishtit të saj nga rrota tjerrëse në fakt personifikon humbjen e virgjërisë. M’u kujtua kjo, kur lexova te libri yt dialogun në vijim. Si mendon, ka hapësirë për një analogji në rrafsh metaforik?

[...]U fut brenda dhe solli një biçak.
- Hape pëllëmbën.
- Do më dhemb?
- Jo, pak fare.
- Do dalë shumë gjak?
- Jo, pak fare.
- Mos më bërtasin në shtëpi.
- Jo, pak fare.
- Mjaft, nuk dua.
- Oooo, mos bëj si llasticë tani...
- Mirë. Vetëm ngadalë.
- Po, ja vetëm majën po ngul.
- Jo aty, te ky vendi tjetër poshtë gishtit të madh.
- Mirë.
Ai e nguli. Vetëm majën.
- Ja gjaku! Të dhemb?
- Jo dhe aq.

R.P.: Po, nënteksti aludon atë që thoni ju. Është një situatë mes dy fëmijësh, një djalë dhe një vajzë, që janë miq të ngushtë dhe duan të bëhen vëllezër duke pirë nga gishti i shpuar gjak. Nga njëra anë, vajzën e josh të

qenit djalë, nga ana tjetër, sjellja e saj është e natyrshme femërore. Po kështu, mungesa e vëllait në familjen e saj e josh dhe e shtyn drejt shokut, që instinktivisht do që ta ketë edhe vëlla, edhe të dashur.

E keni kapur bukur.

Këtë lloj dialogu që nënkupton çastin e çvirgjërimit, e kam edhe në librin «Vrima» ku vajza zhgënjehet nga puthja e parë, pasi e edukuar me përralla, pret që nga puthja me «princin» të shpërthejnë xixa. Jeta i ofron të kundërtën: një çvirgjërim të dhunshëm.

Lojërat e çdo fëmije priren drejt provokimit. Ndjesia instinktive e çvirgjërimit i çon fëmijët pikërisht te këto lojëra. Në roman jepet dhe loja e dy shoqeve, njëra prej te cilave luan burrin dhe tjetra gruan. Ato flenë bashkë dhe të nesërmen në mëngjes përkundin kukullën që “lindi” ngaqë fjetën bashkë gjithë natën të përqafuara. Gjaku paraqitet edhe në skenën tek rrjedh nëpër këmbën e vajzës me ardhjen e menstruacioneve të para dhe që i sjell asaj një tronditje të madhe, pasi askush nuk i kishte treguar për këtë gjë, as në familje, as në shkollë. Dhe më vonë, kur vajza është më e rritur, gjaku paraqitet si një shenjë reale e çvirgjërimit.

A.D.: Një fushë e studimeve letrare merret me shtegtimin e subjektit të një autor. Për shembull Kadare e merr atë çka trajton te poezia “Laokonti” dhe e rikrijon te romani “Përbindëshi”. A e ke një poezi që, në raport me romanin mund të krijojë qasje të ngjashme?

R.P.: Po, është poezia “E dashura e babait”, kur zysha e letërsisë na kërkonte poezi për baballarët. Sigurisht ajo donte poezi për luftën e jo për “dashuriçka”; dhe poezia “Nëse natën vij”, të cilat personazhi kryesor e mbante bashkë me poezitë e tjera intime në sirtar. Jemi në një kohë kur intimitja në art ishte e ndaluar. Dashuri të vërteta quheshin ato kur lindnin në fshat nëpër ara apo në gjirin e klasës punëtore.

A.D.: Termi letërsi feministe dhe ai i kanonit femëror në letërsi krijojnë përherë debate, diskutime, madje edhe kundërshti kryekëput, duke u quajtur edhe si dy forma që nuk shprehin asgjë, boshe. Ti nga perspektiva jote e disafishtë (poete, shkrimtare, autore tekstesh shkollore, botuese...), si i sheh?

R.P.: Nuk i kam konsideruar asnjëherë. As krahun e atyre shkrimtareve që e kanë problem t’u bjerë në sy feminiteti dhe as krahun tjetër që e ka të hapur mesazhin feminist. Për vete nuk kam komplekse. Dua apo s’dua, jam femër dhe nuk e shmang dot këtë ndjeshmëri; është e natyrshme. Nga ana tjetër, feminizmin



nuk e kam pasur asnjëherë qëllim as në jetë dhe as në shkrime. Aq më tepër ta bërtas. Mendoj se kur bën art apo kur flet e jep mesazhe të qarta e të vërteta lirie, e ke kryer misionin shumë më tepër se të jesh feministe agresive.

A.D.: Ti je e vetmja që asnjëherë, asnjë takimi të organizuar nga unë apo nga të njohur, asnjë interviste, asnjë komunikimi a promovimi, pra asnjë ndërreagimi me lexuesit nuk i ke thënë jo. E kam thënë shumë herë, por është hera e parë që e shkruaj, kur isha një gazetar i ri shtatëmbëdhjetë vjeç dhe punoja në një portal, ti pate mirësinë e dashurinë të më jepje kënaqësinë e intervistës

së parë me një shkrimtare. Dhe ç’intervistë...! Kush është lexuesi për ty dhe, mendon se ai në fshehtësi, por edhe hapur e gjen veten te krijimtaria jote? E them këtë – ndjesë se e zgjata – sepse thuhet që ti je anapolla, ndryshe..., por ndoshta jo, ndoshta edhe të tjerët janë si ti me këto mendime, dëshira, përsiatje, dyshime, frikëra, veçse druajnë t’i thonë... Të thuhet kjo gjë nga lexuesit?

R.P.: Për lexuesin fola dhe pak më lart, që dua ta provokoj mos merret me mua, por me veten e tij. Lexuesit mendjehapur e lejojnë veten t’ju ndodhë katarsisi. Ata që janë mendjembyllur do merren me mua, me jetën time private, dhe provokimin

artistik do ta quajnë provokim vulgar. Por mua kjo s’më shqetëson aspak, pasi kur krijoj, harroj se shkruaj për lexuesin. Kur libri është drejt publikimit nuk e shoh me syrin e autocensurës, siç mund të bëjnë disa shkrimtarë.

A.D.: Ka mbaruar panairi dhe është i dyti me stendën e Albasit pa Latifin fizikisht. Në intervistën tonë të fundit (“ExLibris” nr. 109, 12 dhjetor 2020) më ke thënë: “Ende nuk e kam shkruar poezinë e mungesës”. Ende vijon mos ta kesh shkruar?


R.P.: Shkruaj përditë vargje mungese për të. I shkruaj me mendje. Doja që dhimbja mos ma impononte shkrimin. Tani që u mësova me dhimbjen, e kam më kollaj ta përballoj mungesën. Por me mallin për Latifin nuk do të mësohem kurrë. Dhe ky mall që është imi, vetëm imi, më nxit në vetminë time të krijoj poemën e mungesës në jetë dhe në letërsi.

A.D.: Dhe për çudinë e lexuesve, “Lindur së prapthi” nuk gjendej në stendën e Albasit në panair, por tek ajo e Onufrit, si pjesë e katalogut të kësaj shtëpie botuese në tridhjetëvjetorin e themelimit. Pse këtë herë zgjodhe të kishe një botues e mos ta botoje vetë romanin tënd?

R.P.: Është një lidhje e vjetër e bukur vlerësimi reciprok mes meje dhe botuesit Bujar Hudhri. Kam bërë zgjedhjen e duhur dhe ndihem autore e nderuar me logon Onufri dhe sigurisht e vlerësuar. Në Albas më ngatërrohej të qenit autore me botuesen.

A.D.: Është pyetje e pashmangshme! Rita Petro më ka shoqëruar çdo ditë në shkollë si autore e tekstit *Gjuhë shqipe dhe Letërsi*; më ka shoqëruar çdo pasdarke si botuese e disa prej shkrimtarëve të mi më të dashur; më ka shoqëruar çdo darkë për njëfarë kohe kur flitej ngado për poezinë e saj; tani shoqëron në raftet e bibliotekës romanet e mi nëpërmjet romanit të saj. Rita vetë ku dhe si ndihet më mirë: botuese, poete, autore tekstesh mësimore apo shkrimtare?

R.P.: Po të më vinin para dilemës që të zgjidhja profesionin apo artin, do të zgjidhja profesionin. I ka dhënë kuptim jetës sime. Qëndron në themel të gjithçkaje që kam ëndërruar në jetë. Më ka bërë të kem një kompani të suksesshme botimi, më ka ngritur lart shpirtërisht, profesionalisht dhe materialisht. Poezia është dashuri me shikim të parë. Romani kam përshtypjen se do të mbetet dashuria ime e fundit...



Prolog

- Ti ke lindur anapodha, - më thoshte gjyshja nga ana e babit.

- Ti ke lindur së prapthi, - më thoshte gjyshja nga ana e mamit.

- Të gjithë njerëzit, kur lindin, nxjerrin në fillim kokën, ti ke nxjerrë këmbët. Unë e di ç'kam hequr me ty, - thoshte mami.

Dhe aq shumë do ta kem dëgjuar këtë, sa, kur fillova të ecja, paskam vendosur duart në tokë dhe paskam ngritur këmbët lart. Të gjithë qenkan shqetësuar shumë, siç më kanë treguar. Më kanë çuar në kushedi sa doktorë. Por, sa m'i vinin këmbët në tokë, unë nuk hidhja as një hap më tej dhe kthehesha së prapthi. Mjekët u dorëzuan dhe u thanë prindërve, se kjo anomali do të më kalonte me rritjen. Edhe të shtëpisë u detyruan të më pranenin siç isha.

Kështu unë fillova të ecja me duar dhe kokëposhtë. Këmbët qëndronin të lira lart. Shikimi im ndaj botës ishte vertikal, nga poshtë-lart. Sa i bukur, i madh dhe i paanë ishte qielli për mua. Nëse moshatarët e mi ecnin duke parë tokën dhe duke lexuar ato pllakat, ku ishin gdhendur fjalët "Mos pështyni në tokë", unë isha fatlume. Asnjë pllakë me rregulla nuk lexoja. Se askush nuk mund të pështynte qiellin. Por, edhe sikur ta bënte këtë gjë, pështyma e tij do të binte sërish në tokë ose mbi kokën e tij. U mësova të numëroja retë dhe të ndiqja se si ndryshonte nga çasti në çast forma apo ngjyra e tyre. As i shihja njerëzit, të cilët kthenin kokën duke më parë të habitur. As ata që talleshin me mua nuk më interesonin. Mbase mami dhe babi, si dhe gjyshet, bëheshin keq për këtë anomali timen. Së vetmes që nuk i bënte përshtypje, ishte motra.

Tek rritesha e përsosja ecjen time me duar. Krahët m'u forcuin, ndërsa këmbët u mësuan të bëjnë figura nga më të ndryshmet në ajër. Isha më e mira për akrobaci. Me këmbët e mia u mësova të përqafoj njerëzit. Ata shpesh ma gudulisnin apo ma pickonin biçukun. Kjo gjë më bezdiste pa masë. Ndaj kur u rrita dhe pak, fillova të sillesha ndryshe. Këmbët e mia puqeshin aq fort, sa askush nuk mund t'i hapte ato, aq më tepër të fuste hundët aty. Më duhej të ndryshoja pozicion. Gjatë rritjes, doli fjala e mjekëve. Unë fillova të kombinoj ecjen me duar me ecjen me këmbë. Derisa, një ditë, i zbrita përfundimisht këmbët në tokë. E fillova me kërcim. Me muzikë. Këmbët hapeshin bashkë me palat e fustanit gjatë vallëzimit. Ishte koha e rritjes. Koha e hapjes.

- Mami, sa i bukur dukej gjyshi në arkivol, si Drakula, - më tha vajza një ditë pas ceremonisë mortore. Ngriva, se nuk gjeja dot lidhjen mes bukurisë dhe Drakulës, mes bukurisë dhe vdekjes, përveçse mes bukurisë dhe dashurisë për gjyshin. Çfarë e shtyu vajzën time dhjetë vjeçe të bëjë një krahasim të tillë?!

Ai vërtet ngjante madhështor, si një gjysmëperëndi e vdekur përkohësisht. Ky ishte perceptimi im për tim atë, kur e pashë në arkivolin me shandanët e lartë te koka dhe rrethuar me kurora e buqeta lulësh, ndërsa dëgjoheshin kambanat e kishës pranë nesh. Dhe në sy kam ende kravatën blu me pika të kuqe dhe manshetat me kartën e Asit me rombin e kuq në mes. Siç i donte.

LINDUR SË PRAPTHI

fragment nga romani i Rita Petros

Zoti jetonte në shtëpinë time

Zoti jetonte dikur në shtëpinë time. Apartamenti ynë ishte i vogël, aq i vogël, si ato shtëpitë e kukullave me të cilat luaja me Arianën. Dhe, në atë hapësirë aq të vogël, babi ngjante edhe më gjigant. Ai ishte zoti trupmadh, me sy të kaltër, cullufe flokësh të dendur, me onde.

Ai ishte aq zot, saqë, kur kalonte nga njëra dhomë te tjera, askush nuk mund t'i dilte përpara. Ne mbështeteshim te muret ose pas perdeve. Pasi babi zinte vend, atëherë lëviznim ne. E vetmja që përplasej herë pas here me babin, ishte mami. Ndërsa ne me mamin përplaseshim pothuaj gjithnjë mes dyerve të hapura.

Zotit tonë i dëgjonim çdo ditë pordhët, sido që të ishin, me zhurma të mbytura apo të forta. Pas zhurmës

prisnim menjëherë t'i nuhasnim erën dhe gëzoheshim aq shumë, kur ndodhte t'i kishte pa erë. Atëherë nuk hapeshin dritaret në mesin e të ftohtit të dimrit. Në verë ishte ndryshe. Të gjitha dritaret e shtëpisë rrinin të hapura.

Ndërsa kur fillonin stuhitë dhe binin rrufetë, unë, motra dhe mami ndiheshim të sigurt. Se ne jetonim nën të njëjtin kulm me zotin tonë rrufepritës.

Kur zoti ynë lëvizte nëpër shtëpi, me brekët e gjera prej cope të bardhë kambriku, unë përkulesha edhe më shumë dhe, ashtu kokëposhtë, shihja se çfarë varej poshtë tyre. Një toph i rrumbullakët mishi dallohej aty në hapësirën mes brekëve dhe qimeve të kofshës. Pjesën tjetër nuk e shihja. Sa herë zgjatesha për ta parë, dëgjoja zërin e gjyshes:

"Mjaft ndenje kokëposhtë... do të të bjerë gjaku në kokë!"

Vdekja e gjyshes

- Mirëmëngjesi, - tha nusja e xhaxhait, kur u fut në dhomën ku po flinim ne. - A fjetët rehat?

Atë natë unë dhe motra kishim fjetur te shtëpia e xhaxhait. Më pëlqente aq shumë atje. Dhe jo vetëm atje. Gjithçka më dukej aq interesante, kur shkoja në shtëpitë e të tjerëve për të fjetur. Secila shtëpi kishte magjinë e vet. Vetëm shtëpia jonë nuk kishte magji. Se unë e dija shumë mirë çfarë do të ndodhte nga mëngjesi deri në darkë. Çfarë më lejohej të bëja dhe çfarë e kisha të ndaluar të bëja. U desh të sëmurej nëna, që ne të shkonim atje për të fjetur. Xhaxhai kishte dy çuna dhe një vajzë. Dhe kjo e bënte akoma më interesante për mua. Për motrën aspak. Ajo rrinte tërë kohën me vajzën e xhaxhait çuçuçu-çuçuçu, ndërsa unë me kushërinjtë çuna. Ne luanim me top përjashta në oborr. Normal, lojëra çunash. Xhaxhain e doja shumë. Kur isha më e vogël, ai bënte një lojë që më shkrinte së qeshuri. "A do të rritesh shpejt, - më thoshte. - Eja të të fryj. Ai i vendoste buzët pas qafës sime dhe frynte fort. Pastaj bënte sikur vinte tapën aty. Të gjithë thoshin: "Uuuu sa e madhe u bërë". "Hajde të të bëj të vogël tani", thoshte xhaxhai dhe bënte sikur hiqte tapën. Dhe....pshshshshshshsh unë shfryhesha. Po, po, e ndieja vërtet trupin tim si topi i plazhit vija-vija, që shfryhej e fryhej me frymë. Mjafton t'i vije apo t'i hiqte tapën.

- Dua t'ju them diçka, - vazhdoi nusja e xhaxhait. Unë ia kisha ngulur sytë kalendarit jeshil që punonte me bateri, ku dukeshin dy si dritare të vogla, ku tregohej data, dita dhe muaji. Një nga arsyet që vija me qejf këtu ishte dhe ky kalendar, që, sipas mamit, xhaxhai e kishte sjellë kur ishte kthyer nga Italia. - Tani do të shkojmë te shtëpia juaj, por nëna është shumë e sëmure, - vazhdoi ajo, po unë nuk i hoqa sytë nga kalendar i jeshil që ishte te muri përballë shtratit tonë.

Ne e dinim këtë. Nuk është se ajo po na thoshte diçka të re. Nëna kishte një javë që nuk mund t'i hante dot më vezët e skuqura, që i pëlqente aq shumë. Vetëm flinte.

Kur arritëm atje, shtëpia ishte plot me njerëz. Mami e veshur me të zeza, babi me kostumin dhe kravatën e tij blu me pika të kuqe, që më pëlqente shumë se rrathët e vegjël më ngjanin me nusepashke. Babi ishte mjeshtër në lidhjen e kravatave. Gjithë burrat e pallatit vinin t'ua lidhte babi. Ai e lidhte me një shpejtësi të habitshme, e hidhte fillimisht pas qafës ashtu të gjatë, pastaj kapte pjesën e gjatë e bënte si nyje, pastaj me anën e ngushtë se si e rrotullonte te nyja, duke e pështjellë disa herë. Me këtë gjë, babi kishte fituar simpatinë e krejt grave të pallatit. Dhe disa nga burrat që ishin xhelozë nuk vinin më, por e mbanin kravatën të lidhur. Babi thoshte se kravata s'duhej mbajtur kurrë e lidhur, se krijon pluhura dhe copa prishet. Ndonëse i trishtuar, ai ngjante shumë i bukur. Mami me të zeza. Kur vdiq gjyshja nga ana e mamit, e pashë për herë të parë mamin me të zeza. Çdo ditë e pyesja se kur do ta vishte atë trikon e bukur ngjyrë qumështi, që ia dërguan tetot nga Amerika. Me kopsa me xixa dhe me mëngë treçerekëshe. Më lumturonte aq shumë. Jo vetëm se mami ngjante e bukur, por



Lindur së prapthi

RITA PETRO

OnufriRoman

kur e përqafoja dhe e mbështesja kokën në gjoksin e saj, më dukej sikur faqen ma guduliste një lepurush. Mami kur e kuptoi këtë, më tha: “Pas dyzet ditësh të premtoj që do t’i heq rrobat e zeza. Do ta bëj për ty dhe motrën, se gratë e tjera, kur u vdes mamaja, i mbajnë disa vite. Mbase për gjyshen nga ana e babit, mami mund t’i mbante edhe më pak ditë.

Në dhomën tjetër gjyshja e shtrirë. Ajo ishte dhoma ku çdo mëngjes dielli futej i gjithi brenda. Madje dhe kur binte shi, unë e ndieja se si dielli fshihej aty që të mos lagej. Rrezja e diellit kishte rënë mbi fytyrën e gjyshes duke e bërë atë më të verdhë, si e verdha e vezës që ajo e kish aq qejf.

Ah, mos ajo kishte vdekur, ngaqë unë ia dhashë të dielën ta hante të gjithë vezën time?! Do t’i kem hapur aq shumë sytë, sa mami më çoi menjëherë te dhoma tjetër dhe më tha:

- Mos u mërzit. Nëna kishte kohën. Ishte shumë e vjetër. E donim dhe na donte shumë. Po kështu është, gjyshërit ikin të parët.

- Po... mami... pra, nuk u sëmur?

Unë e dija nga mami dhe babi se vezët i bënin keq për shëndetin, por nuk e besoja. Mendoja se ata i ruanin vezët që t’i hanim ne, meqë ato ishin me racion. Nuk mund të kishim në shtëpi vezë sa të donim. As djathë. As mish. Mami e ziente mishin dhe i jepte vetëm lëngun gjyshes. Por, kur babi e skuqte mishin dhe e gjithë shtëpia mbante erë të mirë, nëna vinte protezën e dhëmbëve dhe ma bënte me shenjë t’i jepja pak nga copa ime. Unë ia jepja fshehurazi.

- Jo, vdiq nga pleqëria. E qetë, në gjumë. Ashtu siç dëshironte. Dëgjo tani. Shko te kinkaleria e vogël aty përballë dhe bli një shami. Me kujdes, ëëë!

Zbrita shkallët dhe i hipa me një frymë me shaminë e bardhë në dorë. Babi ia ngriti nënës lart pëllëmbën e dorës së djathtë dhe mes saj dhe pëllëmbës së majtë vuri shaminë.

E për çfarë do t’i duhej nënës shamia? Ajo nuk i lëvizte dhe as do t’i lëvizte dot duart dhe as këmbët. Asgjë. Madje as qante dot për veten. Neve po, neve na duhej shamia se bashkë me lotët na rridhnin dhe qurrat. Atë çast dëgjova motrën që filloi të bërtiste duke qarë:

- Dua nënën, dua nënën.

Nëna ia kish vënë emrin motrës. E donte shumë, se thoshte që i ngjante racës së tyre, ndërsa unë racës së mamit. Unë kisha qarë më shumë për nënën e mamit. Tani motra le të qante më shumë për nënën e babit. Mundohesha të mos i lejoja lotët të më rridhnin nëpër faqe. Ishte e vërtetë që nëna donte më shumë motrën sesa mua, por, ama, kohët e fundit, thoshte shpesh: “Sa zemërmirë e kemi këtë vajzë!” Më lavdëronte mua më shumë se motrën.

Njerëzit hynin e dilnin të rreshtuar nëpër shkallë: “U mërzite për gjyshen? Sa shumë ju donte! Mos e harroni kurrë, se ajo ju rriti. Ju usheqeu e kujdesej për ju! Edhe kur ishte e sëmurë, prapë mendjen e kishte te ju. Gjithë kohën ju mbante në gojë. Papritmas, mes këtij rrebeshi fjalësh, më lindi një shkrepzim. Unë do të mbaja çelësin në qafë...po, po. Motra ikte në mëngjes në shkollë dhe vinte në orën një të drekës. Unë kthehesha nga kopshti, që e kishim në anën tjetër të oborrit të pallatit, në orën 12. Atë orë do të prisja motrën dhe do të mbaja çelësin në qafë. Njëloj si Zana që bënte si më e rritur e na shiste mend.

Isha rritur dhe unë kaq papritur!

SI MË MBROJTËN TRIFON XHAGJIK A DHE STAVRI RAFAEL

nga Sadik Bejko



I. FALEMINDERIT TRIFON XHAGJIK A

Ndjem krenar, veçanërisht i vlerësuar, që (nga "Klubi i Poezisë") më nderuan të jem në fshatin Peshtan, dhe që munda të flas në ditën e inagurimit të memorialit të poetit të pushkatuar Trifon Xhagjika.

Ka një gjë që atje nuk e thashë në fjalën time. Një ide që peshon rëndë, ide që dje, sot e bluj, e bluj; rrah t’ia varros vetes dhe s’mundem, nuk ia arrij.

Këtë lëmshin që e kisha në grykë e nën gjuhë, gati ta them e nuk e thashë dot atje në Peshtan, më datën 23 Dhjetor 2018, po e zbraz, shmpleks tani:

Trifon Xhagjika, Stavri Rafael, Fadil Kokomani, Vangjel Lezhoja e pësuan, u burgosën, hoqën e vuajtën.... u vunë në litar, në plumb dhe vdiqën ... por ne, të pasmit... shpëtua. Për ne që erdhëm mbas, pësimi i tyre tragjik qe një mësim. Ata... na e zgjatën jetën.

U vranë për politikë, u vranë se nuk i donte shteti.

U vranë për ide, për poezi..

Vritet njeriu për politikë, vritet dikush nga që është kundërshtar politik? Që atëherë të ishe kundërshtar politik, kjo ishte baraz me vdekjen. Edhe më shumë sesa me vdekjen e personit: ishte baraz me shfarosjen totale, me zhdukjen jo vetëm politike si familje, si fis, por me flakjen e të gjithëve te të vdekurit.

Kur (si poetë të rinj) në ato vite shkruanim ndonjë poezi me zarar, ndonjë vag a një strofë politikisht me rrezik për kohën, shokët tanë më të moshuar, na

thoshin: mos. ..mos...grise poezinë, fshije vargun, shuaje strofen... mos se do ta pësosh, do të hash kokën, do të hash plumbin ballit, do të të varrosin pa varr si Trifon Xhagjikën.

Kjo ishte ajo gjëja që matesha ta them dhe nuk e thashë dot. Nuk e thashë atje në Peshtan.

Të thosha se ai Burri, ai Tifoni u vra edhe për ne.

Ne që erdhëm pas tij, u fshehëm, e ruajtëm, e ulëm kokën. U përlëm si ai që në vijën e zjarit ku fishkëllej në plumbat, e struk kokën mes supeve.

Jo të gjithë janë trima.

Ne mësuam nga fatkeqësia, nga vdekja. Disa nga ne sot duhet të thonë: falemderit, Trifon. Falemderit!

Ty të vranë, ti ike, por ne sivëllezërit e tu poetë që erdhëm mbas teje, nxorëm mësim nga mynxyra.

Na shpëtove, na zgjate jetën.

Jeta është e shtrenjta. Ti na ndihmove të mos vdesim para kohe.

26.12.2018

2.

Ja, se si ka ndodhur:

Ishte viti 1965. Në shtëpinë e Ahmet Golemit. Kisha shkruar një poezi "Letër nënës". I ndikuar nga poeti italian Salvatore Quasimodo, nobelist. Në shqip atëherë njihej vetëm një poezi me titull "Letër nënës", përkthim nga rusi i vetëvranë S. ESENIN.

Italiani S. Quasimodo e titullonte poezinë e tij "Mater dulcissima", me sa më kujtohet.

"Mater dulcissiman" e kisha lexuar

bashkë me një tufë poezish, një dorëshkrim ... përkthime shkruar me penë, me bojë mbi letra format A4. Mbase përkthimi i librit "Et subito sera" që atëherë në Tiranë në rrethe të ngushta qarkullonte dorë më dorë pa emrin e përkthyesit.

Në poezinë time "Letër Nënës", vjeshtë 1965, kishte një strofë me shumë helm, për kohën.

Aty thuhej se : në këtë vend, kjo botë, ka trumcakë të shumtë që shtypen nga ca pak elefantë.

Thuhej: ka të vdekur kjo botë që peshojnë aq rëndë, sa të gjallët i tërheqin thellë nën baltë.

Poezinë ia lexova Ahmet Golemit, boksier, poet, dhe Klito Fundos poet, bashkëstudentë. Me nga nj gotë verë përpara. Këta të dy ishin miq të mi me të cilët lexonin shkrimet tona. Me ta kisha lexuar Quasimodon, por dhe poezi të grekut nobelist Jorgo Seferis, nga një përkthim klandestin.

- Ku të shpje mushka, a ke mend në kokë...drejt në burg shkon më këtë poezi - , tha Ahmet Golemi.

Klito Fundua, korçari demoniak, nënqeshi.

- Mos e tremb djaln, tha. Do t’ia falin, e ka për herë të parë. E shumta, mund t’i presin bursën. Të mos i vazhdojë më studimet e larta.

- E pranoj të më presim bursën për studimet, u thashë . Babai im do të shesë lopën, delet...që të kem lekët për të vazhduar studimet.

Kjo që thashë, ishte gjëja më me pa mend që mund të thuhej. Isha dhe nën efektin e verës. Atëherë pija më turbullonte me një gotë. Ishte një përgjigje krejt naive. Se nuk e dija: i mbulonin a jo shpenzimet e studimeve të mia lopa dhe delet e atit tim. (Por vallë... a i shiste im atë bagëtitë për poezitë e mia?)

....nuk kishte asnjë gjë të sigurtë në atë deklaratën time patetike.

Ahmet Golemi dhe Klitua më duartrokitën. Ah, më thanë, sa e bukur. Djali bën poezi politikisht të dyshimta dhe lopët e delet e babait ndërhyjnë me bulurima e me blegërima për ta marrë në mbrojtje. Pa, pa, pa...

Kuptohej që po talleshin sheshit.

Gjysmë gote verë më kishte rënë në kokë.

Pa pritur me seriozitet ata më thanë :

- Hap sytë, Trifon Xhagjikën e vranë, Stavri Rafaelin këto ditë e mbyllën në hapsanë. Mos e krruaj kokën me shtetin, o i marrë...

Unë poezinë e kisha çuar për botim në redaksinë e gazetës "Drita". Duhet ta tërhiqja. Por...

Poezia ime një ditë më pas u botua në gazetë. Strofën me elefantë, që shtypin, me të vdekur të rëndësishëm, që të marrin më vete nën baltë, redaktorët, fare pa më pyetur mua, e kishin hequr, censuruar.

Por nuk munda ta harroj ankthin e frikën:

Klito Fundua dhe Ahmet Golemi më kishin paralajmëruar. Më patën thënë: ruaj kokën, mos e pëso si Trifon Xhagjika, si Stavri Rafael.



UDHA E DORËS: EPISODI I PESTË

HISTORIA DHE KOHA.

EVOKIMI I REALIZMIT

TË SHEK. XIX NË ROMANET

E ANILDA IBRAHIMIT.

Nga Dr. Fabio M. Rocchi



Veprat e Anilda Ibrahimit përfaqësojnë kulmin e asaj triade ideale shkrimtaresh – Dones, Vorpsi dhe, pikërisht, Ibrahim – që ka krijuar në panoramën italofone një univers njohës kompakt. Ky univers ka qenë koherent nën profilin e temave dhe karakteristikave të personazheve dhe situatave më të shpeshta të shfaqura në fabula. E pajisur me elegancë stilistike dhe një forcë të veçantë përshkruese, Ibrahim është një romanciere e kompletuar, në dialog të vazhdueshëm me disa paradigma klasike dhe të Shekullit të Nëntëmbëdhjetë, të cilat nuk ka reshtur kurrë së ripunuari në një çelës të përditësuar. Prej vitit 2008 e deri në ditët tona, gjithnjë për shtëpinë botuese Einaudi, Ibrahim ka ndërtuar, nëpërmjet pesë romaneve të saj (*Rosso come una sposa*, *L'amore e gli stracci del tempo*, *Non c'è dolcezza*, *Il tuo nome è una promessa*, *Volevo essere Madame Bovary*), një rrëfim në disa faza të një Shqipërie kulturore e historike, të rikuperuar nëpërmjet kujtesës dhe inteligjencës emotive të heroinave të saj. Pasurisë së vëzhgimit të personazheve femra – të zhytura në një komunitet kolektiv – i bashkohet, në planin formal, një menaxhim jashtëzakonisht i kujdesshëm i strukturës nga ana e figurës së rrëfimitarit të tipit klasik. Në këtë ndërthurje (e aftë të mbajë së bashku individin, shoqërinë dhe historinë në një gjest të vetëm) Ibrahim u ka dhënë jetë figurave pulsuese, vitale, të vendosura në situata të shënuara nga vlera të veçanta simbolike ku fati vetjak është takuar pothuajse gjithmonë me ngjarjet e rëndësishme të historisë bashkëkohore.

Regjia e gjithëdijshmërisë dhe influenza klasike e romanit familjar.

Krahasuar me rrëfimet e Dones dhe Vorpsit, zëri i Anilda Ibrahimit më duket ai më i përshtatshmi në zbatimin e skemës së romanit klasik, veçanërisht atij realist, dhe në ndërtimin e fabulës siç nënkuptohej në Shekullin e Nëntëmbëdhjetë. Vajtje-ardhjet mes së shkuarës dhe së tashmes, disponimi i rrafshëve kohore të ndërprera përmes përdorimit të gjerë të *flashback*-ëve dhe prolepsis, thellimi i personazheve dytësorë e plotësues, përshkrimet e hollësishme, prania e matur por e përpiktë e rrëfimitarit të gjithëdijshëm, koraliteti shpesh familjar i historive që shpërndahen në disa breza: janë të gjithë tregues që pohojnë këtë tezë.

Bëhet fjalë për fabula që mbështeten në një strukturë shumë të artikuluar: pjesëza që ndërthuren më njëra-tjetrën në një arkitekturë të krijuar për të mbajtur në ekuilibër seksionet e shumta narrative. Për sa i përket stilit, Ibrahim preferon brakilogjinë, kultin e thelbësorës, që zbulohet përmes hetimit të detajeve të veçanta ose nëpërmjet dialogjeve të shkurtër që përmbledhin shumë gjëra mes rreshtave. Gjendemi në prani të qelizave që mund të rinisin historinë vazhdimisht, në mënyrë të pashtershme. Në tërësinë e partiturave të orkestruara me këtë ndjenjë të madhe koherence, bien në sy detajet analoge, të afta për të krijuar referenca të shumta jo vetëm në brendësi të romanit, por edhe ndërtekstuale.

Në këtë kuadër, funksioni i rrëfimitarit është themelor. Nuk kemi të bëjmë veç me një regji të mirë-orkestruar: zëri i gjithëdijshmërisë, dhe rrjedhimisht i largpamësisë, merr një pozicion qëndror dhe rregullon rrjedhën e rrëfimit në mënyrë të tillë që e vërteta e fakteve të dalë gjithmonë në dritë. Ndërgjegjësimi për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen janë kushte thelbësore për shpërfaqjen dhe interpretimin e historisë. Fokusi, edhe kur është i brendshëm, i lejon lexuesit të fitojë një pozicion dominues dhe të asistojë gjithmonë në mënyrë të rregullt në zhvillimin e *plot-it*. Alternimi i kohës së shkuar dhe i së pakryerës me të tashmen historike – mënyra kohore e rrëfimit e preferuar nga Ibrahim – na i ekspozon ngjarjet sikur këto të ishin rikuperuar përmes vizioneve të qarta të personazheve dëshmitarë. Nëse refrenet dhe spirancat tekstuale (shfaqja obsesive e baladës që parashikon vdekjen në *L'amore e gli stracci del tempo*, mbërritja e ciganëve çdo pranverë në *Non c'è dolcezza* për të përmendur disa nga më të dukshmet) përforcojnë analogjinë midis romanit dhe strukturës, zgjedhja e së tashmes historike e pengon disi hapin e ngjarjeve narrative. Ndërkohë që rrëfen, Ibrahim ka tendencën të rivizitojë, të rikthehet me kujtesën në vendin e ngjarjes tani që skena është ftohur, pra nisur nga një distancë në të cilën shumë prej reflekteimeve e gjykimave janë formuluar tashmë, në optikën e një rindërtimi të mirëpërcaktuar e përfundimtar. Mund të thuhet se në këtë mënyrë rrëfimi mbizotëron gjykimi, i përcjellë përmes një këndvështrimi të fortë dhe të pakapërcyeshëm: atë të zërit të gjithëdijës. Në ekuilibrin që krijohet mes vetëdijës totale të këtij të fundit dhe koralitetit të personazheve të Ibrahimit, të përhapur në disa epoka, dallohet kodi stilistik i romaneve të saj: një rrëfim polimorfik dhe shumë brezash, i dominuar nga femrat, i cili lejon individualitete të ndryshme të spikasin, në afreske në të cilat marrëdhënia midis historisë dhe Historisë është gjithmonë vendimtare.

Përdorimi i pamjeve regresive që rrisin

thellësinë e personazhit dhe e bëjnë atë të besueshëm, lejohet mbi të gjitha nga struktura e hapur që ofron romani familjar. Le të shqyrtojmë rastin e *Rosso come una sposa*. Ibrahim, me zgjedhjen e një zinxhiri të gjatë dëshmitarësh që rrëfihen përgjatë brezave, jo vetëm e kapërcen kohën, por i jep një vlerë njohëse pasurisë së sistemit të vet narrativ. Kemi përpara një mozaik figurash që shfrytëzon plotësisht potencialin e zhanrit. Protagonizmi bëhet koral, ndërsa policentriciteti i fabulës, bazuar në copëzimin e përvojave, mbahet i bashkuar nga disa personazhe të konsideruar si themelorë (Saba në pjesën e parë, Dora në të dytën). Pasoja është eklipsi progresiv i një individualiteti centralizues; ekskluzivitetit rrëfimitar të familjes i korrispondon një humbje e pavarësisë së individit.

Nëse është e vërtetë që që prej fundshekullit të kaluar lulëzimi i *family novel* në letërsinë amerikane shënon fundin e postmodernizmit, duke risjellë rrëfimet e mëdha në qendër të skenës në vitet Zero të Mijëvjeçarit të ri, Ibrahim nuk bën tjetër veçse ripërshkon një rrugë të rrahur nga romane jashtëzakonisht domethënëse, duke përdorur atë proporcion përzierjeje mes traditës dhe letërsisë së kohëve të fundit që i përshtatet për të prodhuar histori. Më vjen në mendje Franzen me *Correzioni* dhe *Pastorale Americane* e Roth, por edhe disa rrëfime me prejardhje italiane (Piperno - *Con le peggiori intenzioni*, Tuena - *Le variazioni Reinach*, cikli i *L'amica geniale* e Ferrante), vepra të cilat do të konfirmonin një rikthim vendimtar në të shkuarën dhe një koncept të fortë të arkitekturës së narracionit, arkitekturë të cilës shkrimtarja i ka qëndruar besnike deri më sot. Karakteristikat e kësaj forme specifike romani në bashkëkohësinë perëndimore, amerikane por edhe europiane (Ian McEwan, Annie Ernaux) lidhen me një plurivocitet dominues që shndërrohet në mjet tematik.

Mes *pattern*-ave të ndryshme që i atribuohen konstanteve të zhanrit – mosmarrëveshjet trashëgimore, determinizmi gjenetik, ceremonitë private,

kujtimet e dorëzuara – Ibrahim duket veçanërisht e dhënë pas motivit të familjes në tavolinë, një topos i vërtetë i romanit familjar në momentin në të cilin narracioni feston marrëdhëniet midis anëtarëve dhe klaneve, duke i zhytur rrënjët në një arketip të aftë për të ndërthurur të shenjtën me profanen. Pothuajse në të gjitha romanet e saj, megjithatë, arsyeja paraqitet gjithmonë me një konotacion negativ apo edhe dramatik. Nëse nga njëra anë përsërit aderimin e saj në zhanrin e romanit familjar, duke arritur të kompakttojë strukturën edhe në sajë të një përsëritjeje ndërtekstuale, nga ana tjetër i transferon tregimit vlera shtesë që thërrasin në ndihmë figurën e rrëfimitarit. Në atë përzierje të veçantë të tonit diturak dhe largpamësisë në fabul, aq tipike për Ibrahimin, prerja formale e skenës realizon atë ideal të plotësisë së kuptimit të qenësishëm në skemat narrative të para Shekullit të Njëzetë, skema ndaj të cilave autorja konfirmon të jetë e magjepsur.

Para dhe mbropa në kohë.

Ibrahim luan më mënyrë të vetëdijshme me kohën, duke i veshur këtij variabli vlera njohëse dhe antropologjike, dhe, njëkohësisht, duke i bërë të ndryshme levizjet e tregimit pikërisht sepse kanë aftësinë e veçantë për t'u spostuar përgjatë vijës së Historisë. Vendndodhja e ndërprerë dhe ardhjet e shkuarjet midis së shkuarës dhe së tashmes, edhe kur ato janë thjesht një pretekst për t'u lënë vend segmenteve të reja narrative që pasurojnë strukturën qendrore të romaneve, i lejojnë rrëfimitarit një zhvendosje të jashtëzakonshme kohore. Në të njëjtën kohë, identiteti i disa personazheve të rikuperuar nga e kaluara – ose nga e ardhmja, konsideruar prirjen e Ibrahimit për prolepsis – sjell në fokus skenarë të rinj dhe përvijon, edhe nga pikëpamja e introspeksionit, atë individualitet tipologjik kaq të përsëritur në këtë shkrimtare. Ja cili është identikiti i tij: një grua e re e cila i përshtatet botës, e vështron nga jashtë fillimisht pa marrë pjesë, duke vuajtur kufizimet, e mbledhur në një pozicion meditim intim çka bëhet premisë e emancipimit të saj. Në një pikë të caktuar, në fakt, shpërthen progresioni që sanksionon maturimin e këtij akti; personazhi femër fillon merr hapësirë dhe kryen arritje që e vënë në dukje, duke i dhënë jetë çlirimit të saj dhe duke gjetur një ekuilibër ekzistencial midis unit të vjetër dhe atij të ri. Ky proces çlirimi, i konceptuar në kontrast me shoqërinë dhe vendimtar në momentin kur prish lidhjet tradicionale ose konvencionale, ndonjëherë është rezultat i një procesi që përfshin disa breza. Në një lloj zinxhiri të kohës që bashkon figurat matriarkale të gjysheve me mbestat, duke kaluar nëpër përvojat shpesh sakrifikuese dhe të dhimbshme të nënave, Ibrahim organizon, në një hark kohor gjithmonë të mirëpërcaktuar nga përdorimi i datave, procesionet e personazheve të saj dhe koralitetin e një universi që shtohet dhe përpigjet t'u mbijetojë ngjarjeve. Në këtë këndvështrim, baulja e Sabas përfaqëson një trashëgimi të spikatur, që kapërcen



kohët dhe lidh, në ndërrimin ndër breza të fateve të një “fisi të madh”, plot katër cikle dëshimtarësh.

Fillojmë sërish me *Rosso come una sposa*. Në një trajektore që zë mbi njëqind vjet, pasazhet që pasojnë njëra-tjetrën në roman mbulojnë të gjithë Shekullin e Njëzetë. Fillohet me Melihan dhe Saban në fillim të Shekullit të Njëzetë dhe përfundohet me ditarin e Dorës, me shumë mundësi vite mbrapa atij shkurti 2003, në të cilin matriarkja e vjetër ndërroi jetë. Shqipëria para-moderne e rurale i lë vendin pranisë italiane fashiste, dominimit nazist dhe instaurimit të figurës së Enver Hoxhës, e destinuar të zgjasë mbi dyzetë vjet duke kushtëzuar në këtë mënyrë gjysmën e dytë të Shekullit të Njëzetë shqiptar. Edhe shembja e regjimit – e përshkruar me nota humorit të lehtë në ditarin e së resë Dora, me kujtimin, për shembull, të makinave që u përplasën me muret e Ambasadës Gjermane në Rugën e Elbasanit me qëllimin për të hyrë dhe për të kërkuar azil politik – dhe ardhja e politikës liberale të Sali Berishës, janë momente të së shkuarës së afërt të Shqipërisë që gjejnë një vendndodhje të saktë. Fija e kuqe që përshkon këto ngjarje kaq të largëta mes tyre është koraliteti familjar. Universi i shpërthyer i personazheve të Ibrahimit, i ngrohtë, pulsues, i pasur me variacione dhe nuanca, zgjerohet në një rrjet kohor të shpërbërë, në të cilin një fakt i viteve 1960 mund të zëvendësohet lehtësisht me një të viteve 1940 pa asnjë tranzicion. Sekreti i mbijetesës qëndron në aftësinë e protagonistëve për të mbajtur një distancë të sigurt nga qendra reale e skenës. Saba, e plakur shpejt dhe e prirë nga mençuria e gjeneratave të mëparshme, manifeston një sentencë ku kondenson në pak pasazhe sjelljen që duhet adoptuar për të rezistuar:

«Nella vita bisogna imparare due cose: non mettersi mai davanti al più forte né dietro all'asino, perché entrambi non ragionano e ti prendono a calci in faccia».

[“Në jetë është e nevojshme të mësosh dy gjëra: të mos vendosesh kurrë para më të fortit apo pas gomarit, sepse asnjëri nga të dy nuk arsyeton dhe të shkelmojnë në fytyrë”.]

Në këtë mënyrë, përveçse tregon një mënyrë për të mbijetuar, Saba ofron edhe një *specimen* në mënyrë që marrëdhënia ndonjëherë kontroverse midis faktit të vogël privat dhe trazirave të mëdha publike, e lidhur me ndryshime epokale si vdekja e diktatorit Hoxha apo rënia e Muri i Berlinit, të mund të interpretohet nga individ duke nxjerrë mësim.

Variabli i kohës, i kuptuar si disponimi i segmentit rrëfimtari në raport me korrespondencën e tij me Historinë, i jep formë fatit të personazhit e madje arrin edhe ta modifikojë atë; ndan lidhjet natyrore dhe shkakton trauma që ngelen të pashërueshme. 1 janar 1999, i vetmi moment bashkimi fizik mes Ajkunës dhe Zlatanit, bëhet, në *Lamore e gli stracci del tempo*, një datë ndarëse për një popull të tërë në prag të shpërthimit të konfliktit etnik mes shqiptarëve të Kosovës dhe nacionalistëve serbë të udhëhequr nga Slobodan Milošević. Prej atij momenti, me një regji narrative që synon të rikuperojë në mënyrë progresive të pathënat e dhunës fizike dhe seksuale të ushtruar mbi të renë Ajkuna nga torturuesit e saj, dy të rinjtë ndahen nga historia dhe flaken në vende të ndryshme. Hierarkia dramatike e një fabule të luajtur tërësisht mes kujtimeve të së shkuarës dhe së tashmes ndjek format e kushtëzimit kohor, duke gjetur një homologe në makrofiguralitetin e lidhjes së ndërprerë.

Edhe për motrat hebreje, Abigaille dhe Eshter, fati rezervon një ndarje të ngjashme, për shkak të dëbimit nazist të cilit Abigaille e vogël nuk mundet t'i shpëtojë. Në fakt, në *Il tuo nome è una promessa*, Ibrahim arrin majën e zhvendosjes dhe fragmentimit të perspektivës së planeve të *plot*-it: midis viteve 1938 dhe 1940 skena zhvendoset nga Gjermania në plazhet e Adriatikut të Durrësit, me familjen Rosen në arrati nga persekutimet e Hitlerit dhe në kërkim të strehimit në Shqipërinë tolerante të Mbretit



Zog. Ama, rrëfimtari e hap historinë në vitet 2000 të shekullit të ri, në një Tiranë që tashmë ka ndryshuar fytyrë dhe ka mirëpritur joshjen e kapitalizmit të vonë.

Tensioni narrativ që krijohet midis së shkuarës dhe së tashmes është i dukshëm, në një arkitekturë në të cilën një episod rrëfen të sotmen dhe ai pasardhës rimerr të djeshmen, në një dialog të largët që nuk tregon thyerje dhe që ka një teleologji të jashtëzakonshme. Në këtë roman, ndërthurja e brezave është veçanërisht e suksesshme dhe ndërton një urë ndërmjet tre momenteve të mirëpërcaktuara në histori: nazizmit, siç u përmend më sipër, Shqipërisë së perëndimimit të egër dhe, në mes, intervalit të gjatë të regjimit të Hoxhës, i ringjallur përmes poshtërimeve dhe vështirësive kulturore, të cilave Abigaille, e shndërruar ndërkohë në Besa, i duhej t'i nënshtrohej.

Në atë lloj depresioni shpëtimtar dhe në të njëjtën kohë shtypës të përfaqësuar nga Republika Popullore e Shqipërisë, përvoja e privimit dhe e vuajtjes e Abigaille-Besa arrin të dialogojë, ndonëse në distancë, me dy momente qendrore të kronikës botërore: Luftën e Dytë Botërore nga njëra anë dhe mbërritjen e shoqërive teknologjike dhe jomateriale nga ana tjetër. Është domethënëse që kjo ndodh falë punës së rikompozimit të brezave të rinj, të mishëruar nga personazhet e Ruth-it dhe Joanna-s, të cilët mbyllin një rreth me përqafimin e tyre simbolik në fund të romanit. Edhe në këtë rast, rrëfimi i Ibrahimit i ka qëndruar besnik synimit për të kapërcyer pragje të shumta, përmes një segmentimi të vijës kohore të aftë për të mbajtur së bashku mbi shtatëdhjetë vjet lidhesh ekzistenciale. Pra, edhe zgjedhjet e fajteve të kronikës dhe përdorimi i tyre nga ana e Ibrahimit demonstrojnë një tërheqje drejt skemave të Shekullit të Nëntëmbëdhjetë, në një farë mënyre ende larg klimës moderniste që karakterizonte universin e romanit në fillim të Shekullit të Njëzetë. Në informimin e vazhdueshëm të lexuesit për fakte, origjina dhe zhvillimi i të cilave ende nuk njihen, rrëfimtari i gjithëdijshëm i Ibrahimit i cakton vetes një funksion të plotë, ai për të cilin e gjithë bota e ekspozuar rikupërohet përmes ndihmës së tregimit përmbledhës. Nëse përkohësia në romanin klasik konceptohet si një marrëdhënie harmonike midis skenës dhe përmbledhjes, modaliteti i një rrëfimi të sjellë nga jashtë, në dëm të dialogut – i pranishëm, por jo i përhapur dhe shpesh sporadik – duket se është habitat natyror në të cilin Ibrahim i kthehet gjithmonë për të përshkruar ngjarjet në romanet e saj, duke mos u deleguar thuasë asnjëherë një këndvështrim të brendshëm heroinave të veta. Bastisja mes poleve strumbullare brenda të cilave delimitohet historia, me lëvizjen e vazhdueshme përpara e prapa në kohë që sapo përshkrova, bëhet një ecuri logjike në drejtim të përcaktimit të një morali. Një vizion i jetës i dominuar nga fatalizmi dhe vëzhgimi i kthjellët i realitetit, në të cilin rutina e përditshme arrin të gjejë herë pas here një pikë poetike kontakti me një botë magjike tashmë të perënduar: është ky mesazhi më i qëndrueshëm që na

sjellin romanet e Ibrahimit, nëpërmjet një galerie figurash femërore të paharrueshme: Saba, Dora, Ajkuna, Lili, Elena, Klara, Abigaille-Besa, Rebeka. Ritmi i shënuar nga rikompozimi i një kornize kohore, fillimisht të shpërthyer rregullon zhvillimin e personazheve-guida të ndryshëm, së bashku me kuptimet që ato mbartin. Një investim i fortë njohës mbi ngjarjet grumbullohet nga faqja në faqe, i destinuar të zgjidhë nyjet e tij në momentin përfundimtar të tregimit, pra në atë në të cilin bëhen llogaritë dhe rrëfimtari lë, përmes një imazhi, sintezën më kristalore të qëllimit të komunikimit të tij.

Hera Merkuri nuk është Emma Rouault, e martuar Bovary.

Në fund pranverën e këtij 2022 doli në botim në Itali *Volevo essere Madame Bovary*, romani i pestë dhe i shumëpritur i Anilda Ibrahimit, mbërritur pas pesë viteve heshtje, prej publikimit në vitin 2017 të *Il tuo nome è una promessa*.

Në qendër të kësaj historie gjendet një proces maturimi që mund të identifikohet si simbolik për një brez të tërë: atë të grave të lindura në Shqipëri mes viteve Gjashtëdhjetë dhe Shtatëdhjetë të shekullit të kaluar. Hera Merkuri është protagonistja, rrëfimtaria që ripërshkon disa faza vendimtare të fëmijërisë dhe rinisë së vet duke kujtuar dashuritë e kaluara dhe duke reflektuar mbi gjendjen e saj, e cila e sheh mbi të gjitha të angazhuar në rolin e dashnores. Ibrahim përvetëson sërish këndvështrimin femëror për të treguar një histori këtë herë të ndarë mes Shqipërisë dhe Italisë, një vend në të cilin Hera tashmë është ambientuar në mënyrë perfekte, duke u zhytur në një mentalitet perëndimor që ka bërë të vetin. Edhe një herë, Ibrahim na dhuron një personazh të besueshëm, të arrirë, që flet për shumë gjëra, duke kryqëzuar në dimensionin e kujtesës fakte private dhe ngjarje me rëndësi historike.

Hera është mbi të gjitha – në bilancet e veta të kthjellëta – ajo që do të kishte dashur të ishte por nuk arriti të bëhej. Me këtë ton – atë të një humorit të zhgënjyer që shpesh arrin deri në sarkazëm – duhet lexuar proza e Ibrahimit, e cila ndërton shumë mirë, përmes disa imazheve metaforike, një klime nostalgjie dhe mungese realizimi, e gjitha në përputhje të plotë me natyrën e personazhit që sheh dhe tregon. Hera është një artiste, një videomaker gati e suksesshme, por nuk duket se e jeton artin e saj me pasion. Nuk e do bashkëshortin, me të cilin ka dy fëmijë. I dashuri i saj, Skerdi, nuk është hero, përkundrazi; banaliteti dhe konformiteti i tij vihen në dukje gradualisht në rrjedhën e ngjarjeve. Dashuria e vërtetë – ajo prej romani të Shekullit të Nëntëmbëdhjetë që Hera po kërkonte – ndoshta i kaloi pranë pikërisht kur ajo, për dy herë, nuk arriti ta njihte.

Por Hera nuk është aspak Emma Rouault, e martuar me të mërzitshmin Charles Bovary dhe e zënë në kurth nga vetvetja, sipas romanit të Flaubert të vitit 1856. Mërzi, tradhti bashkëshortore, pakënaqësi e përhershme, epilog tragjik: një

komplot melodramatik që pati, në sistemin e tregimeve të kohës, jehonë të madhe por të drejtë ekzistence të shkurtër. Hera nuk merr për model atë lloj heroine, shembull të një mitologjie tashmë të zbehur. Përpjekjet e përhershme dhe shpirti rebel i lejojnë të përballojë një avancim të vazhdueshëm drejt emancipimit, duke u çliruar nga modeli shtypës i nënës dhe duke u angazhuar në marrëdhënie konfliktuale me burrat që takon përgjatë rrugës. Rezulton fitimtare do të thosha, pikërisht falë aftësisë për të lexuar përtej paragjyimeve të mentalitetit mashkullor, duke përmbysur automatizmat e tij dhe në të njëjtën kohë duke zbutur ndjenjën e tragjedisë aq arketipale për ata që vijnë nga viset e saj; Hera arrin, në këtë formë, të krijojë një identitet krejtësisht të ri për veten.

Finalja e bën koherent këtë lloj leximi. Hera e braktis tokën e saj, me gjasë përgjithmonë. Romani rikthehet në skenën hapëse – atë ku qielli i huaj i Tiranës në aeroport pret dhe përshëndet ata që janë kthyer për t'u larguar sërish më pas – dhe mbyll rrethin e vet argumentues. Hera është gati për sfida të tjera. Më në fund është çliruar nga një trashëgimi kulturore dhe matriarkale që e ka kushtëzuar jo pak herë. Është çliruar gjithashtu edhe nga ato mite letrare të rreme, të cilat, kur ishte ende adoleshente, i ishin dukur e vetmja rrugëdalje nga një botë e dominuar nga shtypja dhe rregullat absurde të sjelljes.

Hera, si personazh, e ka ezauruar revolucionin e saj. Por, shpresoj që ky përfundim të jetë simbolik edhe për Ibrahimin. Shpresoj që, mbërritur në këtë pikë pjekurie, ajo të arrijë të ndahet nga temat shqiptare, duke zgjeruar mundësitë shprehëse të zërit të saj për të kërkuar tani një rrugë narrative dhe një imagjinar të mëtejshëm.

Përktheu nga italishtja Kriselda Beqaj

Veprat e Anilda Ibrahimit

Rosso come una sposa, Einaudi, Torino 2008.
L'amore e gli stracci del tempo, Einaudi, Torino 2009.
Non c'è dolcezza, Einaudi, Torino 2012.
Il tuo nome è una promessa, Einaudi, Torino 2017.
Volevo essere Madame Bovary, Einaudi, Torino 2022.

Bibliografia Kritike

CAMILLOTTI Silvia, *Tra fughe e ritorni. La scrittura di Anilda Ibrahim*, in Av. Vv., *Tra due rive. Autrici del Novecento europeo sul confino e sull'esilio*, a cura di GANGEMI Rosanna e DEL ZOPPO Paola, Aracne Editrice, Roma 2020, pp. 205-216.
CARMINA Claudia, *Monete false. Le contraddizioni del capitalismo occidentale nella narrativa di Elvira Dones e Anilda Ibrahim*, in «Narrativa», n. 42, 2020, pp. 141-152.
CAROTENUTO Carla, *Figure di donna in "Rosso come una sposa" e "Non c'è dolcezza" di Anilda Ibrahim*, in Aa. Vv., *Tra innovazione e tradizione. Un itinerario possibile: Esperienze e proposte in ambito linguistico-letterario e storico-culturale per la didattica dell'italiano oltre frontiera*, a cura di CALDOGNETTO Maria Luisa e CAMPANALE Laura, Edizioni Convivium, Luxembourg 2014, pp. 283-297.
FEDERICI Anna, *Autopsia dell'animo: la migrazione nei romanzi di Elvira Dones, Ornella Vorpsi e Anilda Ibrahim*, in «Linea@editoriale» 3, 2011, pp. 79-94
KARP Karol, *Esistere, ossia viaggiare. La visione metaforica della vita in "Non c'è dolcezza" di Anilda Ibrahim*, in «Incontri» 30, 2015, pp. 85-93.
KARP Karol, *Pensare e vivere all'albanese. Il concetto di cultura ne "Il paese dove non si muore mai" di Ornella Vorpsi e "Rosso come una sposa" di Anilda Ibrahim*, in «Études Romanes de Brno», n. 36, 2015, pp. 207-218.
KARP Karol, *Trauma e Viaggio. "L'amore e gli stracci del tempo" di Anilda Ibrahim*, in «Kwartalnik Neofilologiczny», n. LXII, 3/2015, pp. 453-463.
KARP Karol, *Il viaggio in Albania. "Il tuo nome è una promessa" di Anilda Ibrahim*, in «Italica Belgradensia», n. 1, 2018, pp. 99-111.
MOLL Nora, *La rielaborazione della guerra nella nuova narrativa italiana: i Balcani di Tamara Jadrečić, Sara Zuhra Lukanić e Anilda Ibrahim*, in *Letteratura italo-fona transculturale*, a cura di KLEINHANS Martha e SCHWADERER Richard, Königshausen & Neumann, Würzburg 2013, pp. 291-308.
PELLEGRINI Franca, *Traslazioni narrative: strategie di mediazione in "Vergine giurata" di Elvira Dones e in "Rosso come una sposa" di Anilda Ibrahim*, in *Il confine liquido*, a cura di BOND Emma e COMBERIATI Daniele, Besa Editrice, Nardò Lecce 2013, pp. 149-166.
RADI Lidia, *Anilda Ibrahim*, in «The Literary Encyclopedia», vol. 1.6.1, Aprile 2021 [https://www.literaryencyclopedia.com/php/people.php?rec=true&UID=14624] (ultimo accesso in data 6 dicembre 2022).
TADDEO Raffaele, *Letteratura nascente*, Raccolto Edizioni, Milano 2019, pp. 235-241.

Kujtim M. Shala, shkrimtar dhe studiues i letërsisë kohë më parë botoi librin me titull: *Zbulimi i Zef Pllumit*, me ç'rast protretizon figurën e ndritur dhe veprën letrare të Zef Pllumit, shkrimtar dhe misionar i denjë i rregullit françeskan, i cili për idealet e tij u sakrifikua gati për tre dekada nga ideologjia e kaluar ekstreme komuniste. Kujtim M. Shala është poet lirik, studiues letrar, profesor i letërsisë në Universitetin e Prishtinës. Një prej studiuesve letrarë bashkëkohor më të njohur, me një prej veprave studimore më të gjera të historisë së studimeve letrare shqipe. Si prolog të këtij libri, autori Shala e prezanton një thënie mesazhiste dhe tepër kuptimplote të Zef Pllumi: "Do vjet kam pasë pa andrra të hatashme, tash nuk mundem me pa. (Atë Zef Pllumi). Zef Pllumi në letërsinë tonë është bërë i njohur me librin me titull: "Rrni vetëm me tregue, botuar më 1995, Tiranë, Hylli i Dritës, me parathënie të Aurel Plasait; Shkodër, Botime Françeskane, 2015, që është nga veprat e rralla që zgjojnë kureshtjen jo vetëm të lexuesve të rëndomtë, por edhe interesimin e madh të shkrimtarëve dhe të studiuesve më të shquar të letërsisë. Këtë vepër përpos shumë figurave të shquara të botës sonë letrare dhe studimore, vlerat e këtij libri i ngrehu lart edhe shkrimtari më eminent i letrave shqipe dhe të letërsisë botërore, Ismail Kadare dhe veprën e Plumit duke e radhitur nga veprat më të mira të botuara gjatë sekullit të kaluar dhe në kohën e epokës së re të shekullit 21.

Një vepër si kjo e Pllumit lexohet për mësimin e madh

Askush nuk mund ta shpalos lajtmotivin që shpalos kjo vepër për vetë autori Shala. Shala në parathënien e tij shprehet se "libri Zbulimi i Zef Pllumit e portretizon Zef Pllumin shkrimtar, d.m.th. poet e tregimtar, madje skenarist, pasi që ai është kurorëzuar si figura më e madhe dëshmuese e shekullit tonë, një figurë e madhe morale e një misionar i pashoq. Zef Pllumi shkrimtar është një zbulim letrar, ndërsa ky zbulim së pari provohet me poezinë e tij, mbretëreshën e letërsisë, pastaj me prozën fikionale, sidomos me veprën e pashoq Frati i Pashallarëve Bushtali të Shkodrës (2004). Kështu, pohon në vijim studiuesi Shala, "shkrimtari bën faqen tjetër të misionarit, të veprimtarit e të moralizuesit të madh shqiptar, një faqe të ndryshme e të ngjashme; të ndryshme, meqë kemi të bëjmë ne një vepër të ontos-it fikional, të ngjashme, meqë kemi të bëjmë me veprën e një mësuesi të madh. Ndërsa, leximi i veprës së tillë shoqërohet nga vetëdija se letërsia lidhet në ide, në ideologji, madje thuret si utopi dhe, siç tipike është për historinë letrare, kthehet në mësim shenjues, çfarë mësimi letrar është. Këto shenja lënë të kuptohet se, këtu, vepra letrare e Pllumit analizohet, përshkruhet dhe interpretohet, më parë se të takojë diskursin aksiologjik të kritikut. Një vepër si kjo e Pllumit lexohet për mësimin e madh, pastaj dhe për diskursin e bukur të saj", është shprehur ndër të tjera studiuesi Shala.

Pllumi si shkrimtar u njoh në fund të shekullit njëzet

Libri, *Zbulimi i Zef Pllumit* i Kujtim M. Shalës është i konceptuar në gjashtë pjesë tematike që konceptohen si një tërësi e unifikuar përmbajtjesore. Pjesa e parë, Zbulimi i Ze Pllumit; Pjesa e dytë, Tregimi i vërtetë; Pjesa e tretë, Frati i pashallarëve; Pjesa e katërt, Para një mijë vjetëve; Pjesa e pestë, Zef Pllumi sipas Zef Pllumit dhe pjesa e gjashtë, Komentuesi i fundit. Sipas autorit Shala, Pllumi shkroi gjatë gjithë jetës së tij të rëndë, mirëpo se shkrimtar u njoh në fund të shekullit njëzet, ndërsa si poet u njoh në fillim të shekullit të ri.

Prandej un e due at andrrën e mirë: që njëzjt dikur, pa hir o pa hir,

Refleksion rreth veprës *Zbulimi i Zef Pllumit* të autorit Kujtim M. Shala, botoi Onufri, Tiranë 2021

DASHURIA PËR NJERIUN DHE PËR DHEUN LAJTMOTIV I VEPRËS

Nga Mikel Gojani

do rrxojnë e përmbysin kultin e dhunës, instinktet shtasore t'mënisë e furtunës, dhe n'vandin e tyne do t'vihet Mirsia

Mendja njerëzore zemra e dashni!

(Lis Mali/ Zef Pllumi: Andrra ime, f. 17). Sipas autorit Shala, vepra e vetme poetike që Llumi shkroi me pseudonimin Lis Mali me titull: "Antipoezi për shekullin njëzetë", botoi për të gjallë të tij më 2001, një vepër e vogël për nga sasia, mirëpo me vlerë të madhe për nga cilësia por me vlera e sajuar me ideologji, që për bazë shpreh dashurinë njerëzore dhe falje, si mësim moral për jetën e njeriut. Ndërsa vepra tjetër poetike e pabotuar, e cila është shkruar në kushte dhe rrethana tepër të rënda gjatë kohës kur Pllumi dergjej burgjeve të errëta dhe llogorove të punës së detyrueshme nëpër vend të ndryshme të Shqipërisë. Vëllimi poetik prej 100 faqesh i titulluar Poezi dhe Antipoezi është shkruar në dekadën 1950-1960, e cila ruhet në Bibliotekën "At Gjergj Fishta" të Kuvendit të Shën Françeskut, Gjuhadoll, Shkodër, ku gjendet bashkë me disa dorëshkrime të tjera të Pllumit. Autori Shala sqaron se Lis Mali është pseudonim i At Zef Pllumit që e shoqëron

librin e tij Antipoezi për shekullin njëzetë, veprën e vetme poetike të botuar deri me tani. Vepra është mesazhi autentik i veprës së autorit Pllumi. Emërtimi Mal identifikon Malësinë, ndërsa Lisi është shenjë e trashëgimisë dhe e qëndrueshmërisë, e njeriut të qëndrueshëm dhe stoik, Lisi po ashtu e identifikon autorin si malësor. Pllumi përmes vargjeve të tij përçon mesazhin se tirania e rrënon jetën e njeriut, pastaj sipas tij, njeriu që ka vuajtur shumë dhe pafund, dhuron dashuri, sepse dashuria është ideologji e tij e "shpëtimit të njeriut dhe e lidhjes së shqiptarëve në jetën e tyre të përbashkët. Poezitë e Pllumit janë shkruar gjatë viteve ndërsa ai dergjej në burg dhe janë nxjerrë fshehtas jashtë burgut me ndihmën e shokëve të tij. "Dashuria për njeriun dhe e për dheun bëhet lajtmotiv i veprës, që klon në sprovimet mbinjerëzore". (Sabri Hamiti, At Zef Pllumi, "Botime Françeskane", Shkodër 2018, f. 102-103). Ndërkaq, poezia e gjashtë e Pllumit, në formë balade, *Ushitari i jetës*, është një poezi me një lirikë të thellë dhe ndjeshmëri poetike, që shpreh dashurinë humane dhe luftën kundër shkatërrimeve. Dhe sipas autorit "dashuria është amza e jetës" dhe kjo ndjenjë sugjeron

autori Pllumi duhet të merret si ideologji e jetës. "Heqja dorë nga luftërat e shkatërrimet është zgjidhja që *ushtarin e vdekjes* e kthen në *ushtar të jetës*", shprehet studiuesi Shala. Sipas studiuesit Shala, Pllumi është zbulim letrar e kulturor, meqë Pllumi njihet me lirë e tij të kujtime edhe të dëshmive, për novelat dhe për skenarët, për mësimin e thurur me durim e dashuri, si trashëgimi të jetës së tij të lënë shqiptarëve. "Pllumi është autor etik, i shkollës dhe i trashëgimisë etike shqiptare, i kulturës diskursive françeskane, si trashëgimitë jetës së tij lënë shqiptarëve". (Kujtim M. Shala: Zbulimi i Zef Pllumit, f. 53).

O tokë e shterpet, tokë rrenimqare gjithshkafen shkatërrrorem dogje sterfare, që njezit e mirë pa ndertue prapë un ty t'due...

E t'due me shpirt, un t'due si nanen teme, për kotecat plot, per vathë e pleme, per beshkë e male, per fushat lavrue: Ty popull t'due!

Popull shqipar, un t'due se nder mjerime n'robni dhe terr t:shkoi jeta nder vajtime...

(Poezia, Une të due toka ime, f. 68)

Ndërkaq në poezinë, *Burgu*, Pllumi i përshkruan vuajtjet e tij dhe shumë të shumë të përvuajturve të tjerë shqiptarë si viktimë e ideologjisë komuniste. Vargjet e shkruara nga Pllumi pasqyrojnë më së miri ato vuajtje në qelitë e sketerrshme që është shumë vështirë të përshkruhen, mirëpo mendja e Pllumit i pasqyron me mprehtësinë më të thellë.

Kje natë e vështirë.

E dit e net shumë erdhën pas asaj:

pa kurrnji t'mirë,

pa kurrnji shpresë mbi tokë,

por vetëm, kuk, pa miq, pa shokë.

(Poezia, Burgu, f. 69).

Pjesa e dytë e librit "*Tregimi i vërtetë*", autori Shala shpalosh botën tregimtare të Pllumit. Do të thotë që përpos poezisë së gjini letrare Pllumi ka shkruar edhe tregime, që pasurojnë veprimtarinë e tij letrare. Në tregimet e tij Pllumi tregon ngjarje siç kanë ngjarë, ashtu siç ia kanë rrëfyer, domethënë zhvillohen ngjarje siç kanë mundur të ndodhin më të vërtetë. Brenda këtij koncepti të kapitullit hynë tregimet, si Tregim i vërtetë, Njerëzit, Mësimi fisnik (etj). Në këto tregime hasim dëshmitë e autorit për ngjarjet që do t'i rrëfejë, të cilat i njeh si dëshmitë jetës së shqiptarëve nën tiraninë komuniste. Kështu që tregimet e Pllumit janë prova të jetës së vështirë të cilat prova për jetën e tyre i shprehin vetë protagonistët privues të atij realiteti të trishtë me esencat e saja tragjike. "*E kush nuk kaloi një jetë të vështirë gjatë sundimit tiranik komunist?*", - shprehet Plumi.

Shkodra e Pashallarëve të Bushatlive simbol i shqiptarëve të bashkuar

Te kapitulli vijues, *Frati i pashallarëve*, autori Pllumi pasqyron jetën në Shkodër në kohën e Pashallarëve Bushatli të Shkodrës, të cilën faqe të historisë së këtij qyteti të lashtë dhe me tradita të begata të traditës, historike, arsimore, turistike, kulturore etj., është më e ndritur dhe sa kurdoherë, me harmoni dhe dashuri vëllazërore në aspektin ndërkonfesional. Kështu Shkodra e Bushatlive të autorit bëhet simbol i shqiptarëve të bashkuar, për përfshirë dallimet mes tyre. Vepra të lexohet si një kronikë rrëfimi., këtë formë të leximit e ka dëshiruar vetë autori Pllumi. Kapitulli i pestë, sipas Zef Pllumit, është boshti kurrizor i lajtmotivit të veprës, ku autori kapërthen jetën e tij dhe të tjerëve ashtu siç i kujtohet. Vepra është një tregim autobiografik, ku autori rrëfen vetë, nëpërmjet shkrimit për veten, ku frekuentojnë edhe protagonist të tjerë, si Pashko Toma (Baba i gjithë robnisë), Baba, Nana, Ndou, Frati etj. Autori përshkruan jetën e tij nga fëmijëria, në Kolegj, Kuvend, prapë në Malësi, burgje e kampe të punës. Interes të veçantë paraqet kapitulli



me temën bosht, *Komentuesi i fundit*, të cilën pjesë mund ta shprehim veçori karakteristikash që ngërthejnë vlera të jashtëzakonshme. Të kjo pjesë e veprës autori ka konceptuar baladën për Lule Frangun, me ç’ rast Zef Pllumi flet për këtë kryepersonazhin të kësaj balade tepër interesante. Krahastudimit Pllumi e analizon vetë baladën për Lule Frangun nga “perspektiva e kritikës folkloristike dhe të asaj historike, si dhe shënon interpretimin e tij mbi këtë baladë. Letra e Pllumit e shkruar më 20 nëntor 1964 nga Shoshi drejtuar studiuesit Kolë Luka, në të cilin jep mendimin e tij për studimin në dorëshkrim të Lukës mbi këtë baladë. Letra e Pllumit ka 24 faqe, në dorëshkrim dhe deri më sot ka mbetur e panjohur për publikun. Letra ndodhet në koleksionet e Bibliotekës “Atë Gjeegj Fishta” të Kuvendit të Shën Françeskut të Gjuhadollit në Shkodër. Letra është shkruar në kohën kur Pllumi ishte famullitar në Shosh, në një kohë dhe rrethana mjaft të ndjeshme kur feja në Shqipëri nën diktatin e komunistëve, mezi mbijetonte, dhe ishin rrethanat para se feja të ndalohej plotësisht dhe ishte nisma kur ideologjisë komuniste synonte t’i rrënojë objektet e shenjtë të fesë. Si udhëzim na vije nga autori që është e udhës që baladën për Lule Frangun të merret variant i Palajt, variant i kënduar nga Marash Nika i Pecaj të Shalës, që është varianti, që analizon Pllumi në rrafsh analitik të tekstit autentik. Balada e Lule Fragut bëhet një lloj udhëzuesi për t’i lexuar këngët e kreshnikëve legjendarë në tërësi metodën që propozon Pllumi.

*Lum për ty, o i Lumi Zot,
Qì s’jem kenë e Zoti n aka dhanë!
Kur ka kenun një Turk e Kaurr,
Dikur motit trimat kishin kenë
Ago Aga Turkut i ki’n thanë,
Lule Frangu Kaurrit i ki’n thanë;
Mbrëndë në Shkodër trimat ishin xanë:
- Ditë e bukur, Ago, ka qillue;
- A i lodroj na gjogat e mejdanit?
“Po i lodrojm na gjogat mejdanit;
Po un e kam një vraçin te mirin,
Kurrkund shoqin nuk e ka
Dielli tokës ka’i bjen, qaj rrushulku!”*
(Lule Frangu – variant i Palajt, f. 183).

Zef Pllumi: Gjergj Fishta shkëmb mbi të cilin është ndërtuar e gjithë letërsia shqipe

Ndërkaq, të pjesa, *Komentuesi i fundit*, Pllumi përshkruan relacionet Pllumi Fishta si tejet interesante dhe me vlera që i jetojnë kohës. Në parathënieën e tij të njohur, At Zef Pllumi është komentuesi i fundit i shquar, njëri prej ish nxënësve të At Gjergj Fishtës, ishte njohës i madh, komentues dhe ligjërues i drejtpërdrejtë i veprës së At Gjergj Fishtës. Ekzistojnë shumë fakte që lidhin Pllumin me At Gjergj Fishtën dhe Lahutën e Malcis, botuar më 1905, ndërsa vepra është kryer më 1937. Pllumi e portretizon Fishtën poet, analizon strukturën e veprës dhe e vë përballë historisë. “Ndërsa. Lahuta e Malcis tanimë është vepër qindvjeçare, një vepër e shpirtit shqiptar, që do ruajtur si testament e do marrë si mësim nacional (F. 130). Sipas autorit Pllumi e njeh Lahutën e Malcis si “Shkëmb të popullit shqiptar”, duke e vlerësuar Fishtën si shkëmb mbi të cilin është ndërtuar e gjithë letërsia shqipe apo si majë të letërsisë shqipe. Lahuta e Malcis, sipas vlerësimit të Pllumit është vepra më madhore e letërsisë. “Na sot mund ta dallojmë në te epikën, lirikën, satirën e gjykimin njerëzor me të gjithë fantazinë e pakufishme të popullit dhe të poetit. Deri sot mbetet libri i shenjtë i popullit shqiptar”, pohon Pllumi. (f. 139).

Kështu në përfundim lirisht mund të konstatojmë se libri me titull: *Zbulimi i Zef Pllumit*, i Akademik Kujtim M. Shalës është një vepër me vlera të rëndësishme në aspektin letrar po ashtu edhe dokumentar, i cili me mjeshtërinë e shkrimit të tij e vë në horizonte figurën e ndritur dhe veprën madhore të At Zef Pllumit.

Dhjetor 2022

SHËNIME PËR ROMANIN “MJALT NË TEH”

Nga Namir Lapardhaja

Ngjarjet e romanit “Mjalt në teh” të shkrimtarit Romeo Çollaku zhvillohen në një fshat të paidentifikuar të Shqipërisë së Jugut. Ato rrjedhin natyrshëm dhe përshkruajnë muajt e fundit të luftës në vendin tonë deri në ndalimin e fesë, në vitin 1967. Udhëheqësi i fshatit për një kohë të gjatë është Papateoja, një prift ortodoks që kujdeset për grigjën e tij, por që, njëkohësisht, njerëzit ia kanë pranuar, për shkak të autoritetit, edhe gjuhën e ashpër, edhe natyrën e sertë, shpeshherë edhe inatçore. Fshati, që kufizohet me Gjirokastrën, Delvinën dhe Sarandën, është një ishull i veçuar që nuk lihet të depërtojë asnjë gjë e re. Aty jetojnë së bashku dhe në harmoni të plotë shqiptarë dhe italianë të mbetur nga lufta. Leksiku i personazheve ndërtohet mbi dialektin jugor dhe është një gjuhë arkaike, e larmishme dhe që mbart koloritin krahinor të zonës për të cilën flet.

Romani është ndërtuar mbi një grusht të paktë personazhesh, të cilët mbartin veçori dhe karakteristika që ndërtohen e zhvillohen gjatë faqeve të tij dhe që disa prej tyre ndryshojnë në varësi të kohërave të reja. Nëse më parë autoriteti më i lartë shpirtëror është prifti, që u lexon Ungjillin, dhe Kisha si institucion, që i mbledh për t’i falur mëkatet, pas ’45-tës gjithçka nis e ndryshon. I gjithë problemi i personazheve shfaqet tek gjuha, tek të folurit. I pari që ndryshon të folurin është Gogoj, i cili është larguar për disa kohë në Veri në aksion; i dyti dhëndërr i Papateos, i cili në mënyrë të menjëhershme ndërpret të folurën, pa asnjë sëmundje apo paralajmërim të mëparshëm; Stilloja ëndërron të bëhet shkrimtar i madh dhe mendon se do të arrijë famë të jashtëzakonshme. Mbyll në një zarf të madh 4 libra në dorëshkrime dhe i adreson në shtëpinë botues, por, në vend të famës, pas një viti shfaqen në fshat dy policë dhe një civil, të cilët e arrestojnë përpara fëmijëve në momentin që është duke u dhënë mësim. E arrestojnë pikërisht në emër të popullit, të atij populli që nuk e njihje fare Stillon dhe nuk do ta njihje kurrë, përderisa botimi i librave të tij nuk ishte realizuar. Edhe Zahoja, kryetari i sapozgjedhur i këshillit të fshatit, shfaq “probleme” me gjuhën. Ai, tanimë, flet si një udhëheqës i lartë i pushtetit. Ndërsa Qesari ka zbritur një ditë në Sarandë, kur ka qëlluar vizita e Nikita Hrushovit dhe Enver Hoxhës. Pasi ka blerë pasta që t’ua shpinte nipërve në mbrëmje, në mes së rrëmujës dhe duartrokitjeve e brohoritjeve ka zgjatur kokën dhe ka parë nga afër dy udhëheqësat e mëdhenj dhe, ndryshe nga ajo që kishte parë nëpër foto të gazetave, ka kapsallitur sytë, duke thënë: “*E paska plëncin sa një bic.*” Më pas është zgërdhirë së qeshuri me vete. Pas dhjetë minutash është gjendur në hetuesi dhe pas tri ditësh në sallën e gjyqit. E dënojnë.

Të gjithë personazhet e romanit mezi e kanë pritur përfundimin e luftës, mirëpo, me mbarimin e saj, nuk dinë çfarë të bëjnë, janë ligështuar dhe janë mpirë të gjithë. Për komunistët e sapo ardhur në pushtet qarkullojnë lloj-lloj fjalësh. Si për të mos mjaftuar të gjitha këto, një ditë humbet në fshat Mëhillengjëlli. Të gjithë mblidhen për ta kërkuar, por nuk e gjejnë dot. Kthehet pas shumë vitesh në fshat. E dërgon udhëheqja për të ndaluar Fjalën e Perëndisë. Në kryeqytet është bërë i madh, drejtues dikasteri. Madje, nuk e thërrasin më Mëhillengjëlli, por Milo, shoku Milo. Ka një bashkëbisedim mjaft të bukur në faqet e fundit të romanit mes shokut

Milo dhe Zahos, të cilin e ka kushëri të afërt, ku shpërfaqet karakteri i këtij personazhi tip të periudhës së diktaturës.

“Të tëra lajmet më vinin. Çish duken ata të di? Për Stillon e për Qesarin e kam llafin. Vunë mend në burg? Kanë ardhur në shtek të drejtë? I zbatojnë porositë e partisë?”

“E ç’ke me të shkretët? Janë njerëz të urtë, nuk kanë gjë në zëmër, shikojnë punën e tyre në derë e brënda.”- ia kthente Zahoja me bezdi.

“Po ai Miçua, Dhimitër Jeshili, flet më me vete ai? Pse mermërin Miçua nën zë? Mos ka ndonjë pakënaqësi nga jeta jonë socialiste? Mos ka nevojë për ndonjë mësim të mirë edhe ai?”

“E ç’thua, a derëzi! Po ai ka mermëritur tej e tëhu, që në kohën e Zogut, të taljanit e të jermanit. E ka zakon, nuk ka ndonjë pakënaqësi nga jeta socialiste.”

“Po Arqilea...”

“Edhe Arqilea i tillë ka qënë ngahera. Harrove? Qëkur u kthie nga Austria, ia nxirrim llafin me grep. Nuk do ndrihojë nashinë në pleqëri. Nuk ka gjë me partinë. Biles, vetë partia i ka besuar detirën me përgjegjësi të doktorit.”

“Po taljanin ç’e gjeti që i ka ikur goja? Ç’bluan në kokë e nuk e thotë? Mos i duhen hedhur prangat sa s’është vonë?”

“Atë lëre e mos e nga, është i sëmurë. More kusho i dashuar, foli mëndes! Ti edhe ata të tjerët atje lart. Ç’e katranosët këtë punë kështu? Keq të flasë njeriu, se bie në burg si Stilla e si Qesari, e keq të rrijë pa folur, se prapë rreizonet! Dhe




qishën, ta dish, nëni gabim që e prishni! Këtë kodër e këta njerëz ajo qishë i mbajt me frimë e me umith! Vajte i the plakut të Perëndisë të rruajë mjekrën! Ju qofshi, çish nuk kini frikë! Megjithatë, veten tuaj paçi në qafë. U e kam dashur partinë që në dizet e pesën, po jam me një këmë në gropë nashinë, nuk ndihmoj dot. Nuk e marr dot përsipër mbilljen e qishës.”

Mëhillengjëlli rrudhi buzë e vetulla.

“Edhe mua më vjen keq, - tha, po është direktivë nga udhëheqja. Do prishen të tëra, qisha e xhamira, se janë pengesë në edukimin e masave. Lu futa kësaj valleje dhe duhet ta shpie ngjer në fund...”

Është e kuptueshme se gjithçka në fshat ka ndryshuar, pasi pushteti i ri ka krijuar një ideologji dhe një udhëheqësi të re. Asaj shpirtërore ia ka zënë vendin ajo politike dhe partiake.

Romani “Mjalt në teh” i shkrimtarit Romeo Çollaku nuk merret me politik. Ai nuk mbron një ideologji të caktuar. Ngjarjet dhe personazhet e tij rrjedhin natyrshëm. Ata qëndrojnë mbi veçoritë dhe karakteristikat që gjithsecili mbart dhe gjuha e tyre i portretizon më së miri. Notat e ironisë së lehtë dhe humorit të hollë i përshkruajnë të gjitha faqet e romanit që përpihen me një frymë si të ishin hoje me mjaltë, të ngjashme me personazhin qendror të romanit, Papateon, i cili “merrte thikën e bukës, e zhyste në një kavanoz me mjaltë dhe e lëpinte me kujdes”.



1. Balada si krijim epiko-lirik

Gjatë krejt rrjedhës historike, tradita popullore është frymëzuar nga motivet biblike. Është shumë interesant fakti se duke marrë shkas pothuajse nga i njëjti motiv biblik, siç është motivi i ringjalljes, për shembull, apo ai i fjalës së dhënë, poashtu prej shumë ngjarjeve tronditëse që e kanë përshkruar jetën e tyre, popujt gjithandej kanë krijuar legjenda të ndryshme të cilat me fanatizëm janë ruajtur dhe përcjellë deri në ditët tona, secila në formën e vet qoftë edhe për nga mënyra e shpjegimit të tyre pa e cënau asnjëherë thelbin e saj. Baladat janë krijime folklorike **epiko-lirike** në vargje dhe kanë natyrë tregimtare. Në tematikën e baladave shqiptare vendin kryesor e zë një dukuri e mbinatyrshme, për shembull, sakrifikimi i njeriut në ndërtimin e **kështjellës, urës, kishës** etj.

Në traditën folklorike shqiptare hasim edhe variante të tjera të baladës, e cila në rrjedhë të shekujve ka pësuar ndryshime të thella. Ato pasqyrojnë në njëfarë mënyre ndryshimet fetare dhe kulturore të vetë shoqërisë shqiptare. Si do që të jetë, sa më shumë që thellohem tek shfletojmë dhe studiojmë brendinë a thelbin e legjendave, mësojmë se, sikurse edhe në përrallat e moçme ato janë të përhapura nga një qytetërim në tjetrin, brenda një rajoni të caktuar siç është Ballkani me kulturat e përafërta të tyre. Megjithatë sipas shumë autorëve dhe studiuesve të kritikës dhe letërsisë, një gjë është më së e sigurtë; kjo legjendë ka si atdhe Ballkanin.

E njëra ndër to është edhe legjenda *Kënga e Kostandinit* e cila ndoshta qindra apo mijëra vjet nga thurja e baladës, mbeti frymëzim i përhershëm i krijimeve të veprave të reja nga autorë të ndryshëm, e që ne sot kemi mundësinë jo vetëm t'i lexojmë ato, por edhe t'i studiojmë duke hedhur dritë në kujtesën historike të njerëzimit në përgjithësi dhe shqiptarëve në veçanti, njëjtë siç bëri shkrimtari ynë i madh, Ismail Kadare, me romanin *Kush e solli Doruntinën*. Prania e elementeve folklorike dhe kanunore në këtë roman, tek lexuesi shton kërshtërinë dhe vendosmërinë për studim më të detajuar. *Balada "Kostandini dhe Doruntina"* si njëra ndër krijimet më të vjetra folklorike shqiptare, para së gjithash është një legjendë përmes së cilës i këndohen lavde besës shqiptare, zotimit apo fjalës së dhënë, të cilën as dhe nuk e qas dot. Ismail Kadare e merr këtë legjendë dhe e ndërton me të njëjtit triller tërheqës, duke filluar nga kalërimi misterioz i vëllait me motrën e tij. Udhëtimi i Doruntinës, sipër kalit të të vëllait Kostandinit është motivi kryesor jo vetëm i romanit *Kush e solli Doruntinën*, por edhe vet enigma e ardhjes nga Bohemia, për zgjidhjen e së cilës, Kadare e ka ngarkuar kapiten Stresin. Dhe, vetëm në qoftë se për një moment i referohemi mitologjisë, Kostandini dhe Doruntina (vëlla e motër), sikur paraqiten me ca elemente incentuoz, të cilat autori përmes hetuesit plot pushtet i zhvlerëson ato, duke e orientuar lexuesin që "fajtorin" e kthimit së Doruntinës me të vëllain ta kërkojë diku gjetkë. Edhe Francesco Altimari në parathëniën e romanit *Kush e solli Doruntinën*, thotë: *njerëzit e zakonshëm instiktivisht rreken ta shpjegojnë enigmën me një mister, ndërsa hetuesve u bie barra e vështirë t'i japin asaj një zgjidhje racionale*¹. Për më tepër, Altimari vazhdon me mëdyshjet e përsëritura të Stresit për zgjidhjen e enigmës së ardhjes, kur shpjegon se: "Botës mund t'i lejohet të dyshojë, por jo neve, thotë me bindje dhe koherencë Stresi, i cili "së vërtetës" së baladës (shprehja "shkon i vdekuri me të gjallën", me anë të së cilës zogu, ky ndërlihdës mediatik mes botës reale dhe asaj irreale, paralajmëron Doruntinën gjatë udhëtimit nëpër natë), i kundërvë, siç ka vënë në dukje Ali Aliu në teoremën e tij aprioristike,

¹ Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, Onufri, Tiranë, 2014, f. 14.

ExLibris - sponsor medial i konferencës shkencore ndërkombëtare, "ÇËSHTJE TË GJUHËS, LETËRSISË DHE PËRKTHIMIT LETRAR".

Fakulteti i Filologjisë i Universitetit "Fehmi Agani", Gjakovë

INTERTEKSTUALITETI NË ROMANIN "KUSH E SOLLI DORUNTINËN" TË KADARESË

Nga *Islam Haxhiu*
Gazetar në RTK

"i gjalli ka kalëruar me të gjallën!, teoremë që nuki ia del dot ta vërtetojë, me gjithë hetimin e kujdesshëm dhe këmbëngulës, shoqëruar me një aftësi të madhe psikologjike".

2. Miti dhe rikthimi i tij te Kadareja

Mit quajmë një tregim fantastik i thurur rreth ndonjë dukurie të natyrës ose të jetës shoqërore, i hasur pothuajse tek të gjithë popujt e vjetër, bazuar dhe i shprehur sidomos në gojëdhëna si rezultat i të cilave lindi edhe mitologjia. Kur ne flasim për mitin menjëherë mendja na shkon tek legjendat e vjetra, përrallat, baladat, tregimet e moçme, për mite të caktuara brenda tyre e që janë hera – herës të pavërteta, pra të shpikura, që bazohen kryesisht në fantazinë e njeriut, apo rrëfimtari që i sjellë ato.

² Po aty.

Edhe pse, që në shikim të parë na duken të tillë, të pavërteta e të trilluara, mitet edhe sot e gjithë ditën vazhdojnë të kenë rol dhe ndikim të pazëvendësueshëm në letërsi. Prandaj miti mund të quhet edhe bashkëkrijues i letërsisë moderne pa të cilin vështirë se do të mbijetonte letërsia që ne e shkruajmë dhe e kultivojmë.

Sikurse në të gjitha letërsitë e botës, edhe në letërsinë shqiptare, sipas burimeve të qarkulluara nëpër dekada e shekuj deri në ditët tona, miti, krahas identitetit që përmban por edhe narrativës tregimtare letrare, ka tiparet kryesore të tij të degëzuara në rite e besime popullore siç janë: miti i Ringjalljes, miti i Zanës, miti i Bletës dhe mite si : Bajlozi, E bukura e dheut, E bukura e detit, Zjarri, Shtojzovallet etj.

Burimet dhe të dhënat e shumta në fushën e mitologjisë, na tregojnë se gjatë gjithë historisë njerëzore të shkruar e të përcjellur në letërsi, deri më sot, vetëm tre njerëz janë ngritur nga

varri: Jezu Krishti, Lazari dhe Kostandini³. Sipas besimit të krishterë vetëm Krishti, nuk ishte i detyruar të vdes. "*Vetëm vdekja e tij nga të gjitha vdekjet njerëzore, ishte përsosmërisht vullnetare*". (Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, 2019).

Ai erdhi që të vdiste dhe me anë të vdekjes së tij t'i çlironte ata që mbaheshin robër nga pushteti i vdekjes me besimin në ringjallje"(Gjoni 11:25 – 26). Sepse sipas këtij shpjegimi ai do të ringjallet për të shpëtuar pastaj njerëzimin...

Njëjtë siç do ta shpëton "*besën e dhënë*", Kostandini pas aktit të ringjalljes. Për të krishterët, ashtu edhe për mbarë njerëzit, vdekja mbetet një tragjedi. Kur përballen me vdekjen, të njëjtat duhet t'i shndërrojnë në akte jete. Ata duhet ta përballojnë tragjedinë me besimin në ringjallje. "*Unë jam ngjallja dhe jeta; ai që beson në mua edhe sikur të duhej të vdesë, do të jetojë. Dhe ai që jeton e beson në mua nuk do të vdesë kurrë përjetë*" (Gjoni 11:25-26).

Po ta studiojmë mirë e mirë ngjarjen, në këndvështrimin religjioz do të shohim se ajo ka ndikim të drejtpërdrejtë nga feja e krishterë.

Poashtu, mund të themi se dialogëzon me biblën apo ngjarjet nga bibla. Pra, dialogëzimi është i dyanshëm sepse aty gjejmë shumësinë e dialogëzimit pasi ajo bëhet edhe me librin e shenjtë, Biblën, edhe me baladën shqiptare përkrah saj edhe me baladat ballkanike që komunikojnë njëra me tjetrën.

Dita e Pashkëve është dita kur Jezu Krishti është ringjallur dhe pikërisht *Ditë Pashkësh* ishte dita edhe kur nëna e Kostandinit shkon te varri i tij dhe e mallkon atë për mospërbushje të premtimit, apo për shkelje të besës siç thotë Kadareja në romanin, *Kush e solli Doruntinën*.

Por në aspektin fetar kjo përmbajtje bëhet edhe më e natyrshme, sepse Dita e Pashkëve përkon edhe me stinën e bukur të pranverës, stinë gjatë së cilës; çdo bimë dhe çdo gjë tjetër në natyrë ringjallet, pra natyra ringjallet, shpirti ringjallet dhe çdo gjë tjetër rilindë, e pse jo në stinën më të bukur të vitit ringjallet edhe njeriu.

Në stinën e pranverës, historikisht, janë ringjallur dhe kanë marrë formë edhe idetë për rilindje të reja deri në përmasa të kryengritjeve për çlirim, pothuajse në të gjitha epokat.


Në mars të vitit 1981 në Prishtinë, ndodhi pranvera'81, filloi ringjallja (lëvizja) që ndryshoi rrjedhat e një shekulli, sidomos në Kosovë, e njohur si pranvera shqiptare. Në mars të vitit 1998, kulmoi poashtu me ringjalljen e madhe që sot e quajmë pranvera kryengritëse, pranvera e lirisë, ringjallje kjo që rilindi legjendën e kohës sonë, Adem Jasharin, i cili u shëndrrua në mit të përjetshëm duke u bërë motiv kryesor dhe frymëzim për bashkëluftëtarë në luftën për liri dhe besimin në fitore.

3. Rimarrja e mitit (si intertekst) nga Kadareja

Tashmë është e vërtetuar se e gjithë letërsia botërore rrjedh nga miti (burimi) dhe të burimi (miti) kthehet. Ndaj, nuk kishte s'i të ndodhte ndryshe as në veprën e shkrimtarit tonë, Ismail Kadare. Me një përsosshmëri të rrallë artistike e letrare Kadareja, pra, e rimerr mitin, për të ndërtuar letërsinë e tij, në mënyrën e tij, për të dëshmuar kështu një individualitet të rrallë krijimi në artin e letërsisë. Si njohës i shkëlqyeshëm i antikës, sidomos i veprave të Homerit, Euripidit, Eskilit, Virgjilit etj., Kadare në veprën e tij ndërlihd pjesë të miteve por që kanë një origjinalitet dhe dallojnë në themel.

Pra në asnjë mënyrë nuk mund të themi që nga kjo marrje të kemi një kopjim të drejtpërdrejtë siç edhe ndodhë shpesh në

³ <https://sq.wikipedia.org>



letërsi, por një vazhdimësi të traditës ku mitologjia shqiptare është e baraspeshuar me letërsi tjera, siç është mitologjina greke e romake. Rrëfimet tjera në romanet e shkruara pas viteve 90-të, të Ismail Kadaresë, krijojnë mundësinë e një interpretimi të mirëfilltë të një poetike letrare, një poetike të vendlindjes, një poetike të udhëtimit, si dhe një poetike me intertekst mitik, por assesi një poetike komuniste.

Lidhur me këtë studiuesi dhe kritiku letrar, Shaban Sinani thotë: “*Shkrimtari që kishte guxuar të kërkonte frymën e Evropës në botën e shkëlqimtë arbërore të mesjetës, me Kush e solli Doruntinën, Prillin e thyer, Urën me tri harqe, në vend të pasaportës së asaj epoqe, statuteve dhe rregulloreve evropiane, zgjodhi të drejtën kanunore, për të përveçuar njeriun shqiptar*”⁴. Është folur shumë për rrezatimin e grekëve në letërsinë botërore, tek; *Eskili, ky humbës i madh, duke nisur nga latinët, Dantja, Shekspiri, Gëteja e gjer te Holderlini, Hauptmani, O. Neili, T. Elioti, Sartri etj. Është hamendësuar me të drejtë, se a do të kishte ferr të Dantes, dhe nëse do të kishte, si do të ishte shestuar ai, pa gjedhet e dikurshme greke. Si do të ishin Hamleti pa Orestin, vallet e magjstricave, njollat e gjakut mbi duart e Ledi Makbethit pa ato të Klitemnestrës, ndërgjegjet e shqetësuara, gjumi i prishur ose plot ëndrra turbulluese, shandanet e natës nëpër mesoret e pallateve-kështjella, ku krimi është duke u përjetuar ose porsa ka ndodhur etj*⁵.

Mirëpo kësaj radhe studimi ynë ka për synim romanin “*Kush e solli Doruntinën*” të Kadaresë, rreth të cilit do të bëjmë përpjekje të flasim e të trajtojmë sidomos në aspektin e mitit dhe interteksualitetit të tij.

Sikurse edhe në vepra tjera të mëdha Ismail Kadare edhe në romanin për të cilin ne po flasim, me një elekuencë të jashtëzakonshme ka bërë që miti të ligjërojë gjatë gjithë narracionit të ndërtuar prej tij. Fakti se mitet janë krijuar nga njeriu – popull, flet më së miri për rëndësinë e madhe që kanë. Pra, miti në bashkëjetesë me artin letrar modern, del se përveç që mundëson krijimin e veprave tërheqëse, është edhe frytdhënës. Për të dëshmuar këtë, mjafton që t’i hedhim një sy letërsisë greke, shtratin ku janë ngritur letërsitë e popujve evropian, sepse “*arti antik*”, sidomos ai grek, ka qenë i lidhur ngushtë me mitologjinë greke, madje edhe i pandarë nga ajo.

Është e pamundur që lexuesi i sotëm t’i kuptojë veprat e Homerit pa pasur njohuri mbi mitologjinë antike greke, meqë pothuajse gjysma e veprimit në “*Iliadën*” dhe “*Odisenë*” e tij zhvillohet në botën e Zotërave.

Prandaj, mund të themi se mitologjia greke paraqet materialin, brumin, truallin e artit antik grek, ashtu siç miti shqiptar paraqet brumin e letërsisë shqiptare në përgjithësi, dhe në veprën e Kadaresë në veçanti. Në *vështrim të parë Kadareja shkruan kryekëput vetëm për Shqipërinë. Por ato ngjarje, që s’ia vlen të hedhesh sytë në anë të botës, ai i shndërron në letërsi botërore, shkruan kritikja gjermane* e njohur për studimet letrare Anjez Hyfner⁶.

4. Intertekstualiteti në romanin Kush e solli Doruntinën dhe miti si intertekst

Në fushën e gjërë të krijimtarisë letrare botërore dhe në ngritjen e pothuajse të të gjithë krijuesve të letërsisë, ndikim të madh ka pasur edhe mitologjia. Duke qenë kështu, studiues të mëdhenj kanë dhënë përkufizime të çmuara, por gjithnjë sipas vlerësimeve të tyre ato kanë qenë e mbesin të pamjaftueshme për t’i dhënë vulë këtij

nocioni, i cili edhe sot e gjithë ditën, krahas frymëzimit që sjell, vazhdon të mbetet i mjaft i ndërlikuar, sidomos në përkufizimin e çështjeve thelbësore që rëndojnë mbi të.

Duke e lexuar me kujdes veprën e Ismail Kadaresë, e sidomos romanin *Kush e solli Doruntinën*, vërejmë se tekstet e tij janë të formuara në atë mënyrë sa që gjatë interpretimit dalin të ndryshuara gati në mënyrë të pabesueshme, nga tekstet tjera të mëparshme, duke e bërë kështu një transformim të përkryer. Në veprën e tij, Kadare nuk nguron që të mbështetet në elemente të letërsisë popullore duke e njohur lexuesin për një lidhje intertekstuale, të mundshme. Si aspekt të intertekstualitetit mund të parashihet edhe vetë fakti që këto burime legjendash e baladash kishin për bazë jo vetëm Shqipërinë dhe trojet e Arbërit, mirëpo këto burime i krahasoi edhe me format apo mënyrat tjera të interpretimit, sidomos nga arbëreshet e Italisë dhe popujt tjerë fqinjë. Teksti parësor për të cilën nuk nguron të fut në poemat e tij, është letërsia greke. Lexuesit i referohet paradigma e ndërtekstorisë, ndërsa si gjetiu të çdo autor, këto paradigma e respektojnë në mënyrë të plotë intertekstualitetin dhe të gjitha parimet mbi të cilat ai është ndërtuar.

Sepse: ***në esencë intertekst kemi që në fillim, pra tek ideja e shkrimit e pastaj vet titullit i romanit, Kush e solli Doruntinën.***

*Intertekstualiteti do të ishte atëherë, ndoshta fare i thjeshtë dhe në mënyrë të rëndomtë, fakti që çdo shkrim gjendet gjithmonë midis veprave që e paraпрin atë, dhe fakti që nuk është asnjëherë e mundur për ta fshirë letërsinë*⁷.

“*Kush e solli Doruntinën*” e autorit Ismail Kadare nuk mund të kuptohet jashtë kontekstit të këngës *Konstantini e Garentina*; ashtu siç nuk mund të kuptohet *Komedia Hyjnore* jashtë kontekstit biblik; apo *Emri i trëndafil*it jashtë kontekstit të *Poetikës së Aristotelit* dhe krijimit të kulturës krishtere e kështu me radhë. Prandaj, mendojmë se kjo vlerë e përbashkët e letërsisë evropiane, është shumë më e begatë me temën e mitikës nga letërsia e vjetër greke. Apo nga ana tjetër, si do të kuptoheshin më mirë kodet kanunore shqiptare nga Kanuni i Lekë Dukagjinit pa veprën, *Prilli i thyer* ose sa na ka ndihmuar romani *Kush e solli Doruntinën* për të kuptuar më mirë sfondin historik të mundshëm të një prej vlerave më të larta etno-sociale të shqiptarëve, besën. Me një fjalë, këtu kemi të bëjmë me intertekstualitetin si pikë kyçe e studimit të temës sonë në romanin enigmatik të Kadaresë, e që orientim kryesor ka ringjalljen e Kostandinit për të mbajtur besën e dhënë, për t’ia sjellë nënës Doruntinën sa herë që ajo do të kishte nevojë.

Prandaj për të arritur qëllimin, pra, për të përçuar mesazhin e nevojshëm për lexuesin shqiptar, Kadare përmes romanit *Kush e solli Doruntinën*, e vendos në te ritualin e vjetër nga motivi i ringjalljes duke e zbërthyer gati në çdo detaj të mundshëm ngjarjen e mbingarkuar nga pesha e madhe e enigmës ku zgjidhja në të shumtën dukej e pashpresë. “*Rituali i moçëm i të vdekurit që ringjallet pësoi një përshtatje të pashmangshme gjatë kalimit nga paganizmi në krishterim. Për këtë kalim është i vetëdijshëm edhe Stresi, që jo më kot në mesazhin që do të na japë në fund të romanit, duke folur për për fatin e Shqipërisë, pranon se ai mit “do të shfjtyrohet për t’iu përshtatur maskave të kohës*”⁸.

Sipas Francesko Altmarit: “*Enigma e “Doruntinës”, që është vendosur haptas në një kontekst narrativ gotik, zhvillohet brenda në Shqipërinë mesjetare, të dhënat historike dhe gjeografike të së cilës paraqesin kufij tejet të labërguar*”⁹. Tema trajton forcën e kodit moral, të besës, i cili e mund edhe kodin natyror mes jetës e vdekjes. Kadare

e ka marrë këtë mit dhe e ka shndërruar në tematikë të romanit *Kush e solli Doruntinën*, dhe nga ky aspekt vepra është ndërtuar si interpretim personal i një miti mijëra vjeçar, apo më saktë, teskti është interpretim i një teksti tjetër. Ndërsa, origjinaliteti i kësaj vepre, apo i vetë autorit të saj Ismail Kadare, qëndron që nga mënyra interpretuese e mitit e deri te gjuha e përsosur që e përdor. Temë kjo e bazuar në legjendat dhe baladat shqiptare dhe jo vetëm, e sidomos në këngën e vjetër Kostandini dhe Garentina. Mirëpo ky intertekst është fare i padukshëm në tekstin që e krijon Kadare në romanin e tij, *Kush e solli Doruntinën*.

Pra nga *Eposi legjendar shqiptar*, balada ***Kënga e Konstantinit dhe Garentines. Këtu në fakt në titullin e romanit kemi intertekstin e parë, i ndikuar nga vetë balada*** . Dhe, jo rastësisht e shënuam *intertekstin e parë* që e hasim te Kadareja në romanin Kush e solli Dorintinën, sespe; të përvijosh udhën drejt zanafillës së intertekstualitetit, kjo është të tregosh se kundër çfarë formash leximi kritik është ngritur ai. Po ashtu nëse intertekstualiteti mbulon praktika po aq të vjetra sa dhe ndërtuese të letërsisë, ai pretendon të thyhet me mendimin e përcjelljes dhe të traditës letrare. Titullin e Legjendës e gjejmë në dhjetëra variante të tjera, si psh tek arbereshët e Italisë nga i madhi De Rada, ku herojnt e saj janë ***Kostandini dhe Juredina***. Pastaj e hasim edhe si *Kënga e Dhoqinës*: Balada që në vargun e parë Ditën e Pashkës në drekë flet për një rrefim tjetër nga ai që autori Kadare e paraqet në romanin e tij, por që interteksti është paksa i mbyllur. Sikundër e gjejmë fare të lehtë dallimin si te vargjet: *Ditën e Pashkes së madhe/ Dhoqina na hidhej valle*. Balada e cila mbetet ***mit*** që ecën nëpër kohë, në rastin e “*Kush e solli Doruntinën*” te Kadareja, përveç tjerash është arenë në të cilën trajtohet misteri *vdekje-jetë*. *Subjekti i kësaj balade duket shumë i thjeshtë, por sa më shumë hyn në brendi të saj, krijohet përshtypja se aq më shumë ndërlikohet, sepse çdo rilexim zbulon një fshehtësi, nxjerr në pah një pikëpyetje tjetër. “Ish një mëm shumë e mirë, kisht nëntë djem të hijshëm, e të dhjetën kish një vajzë, që e quanin Garentë*”¹⁰

Ndërsa në anën tjetër, kënga, “ Besa e Kostandinit nisë me vargjet:

Ish një mëmë shumë e mirë e na kish nëntë djelmë bujarë të dhjetën një vashë

Kurse te kënga e Halil Garrisë, vjersha fillon me këto vargje:

Zot ç’ka than Halil Garrija be mbi Zotin trimi bani pse nant vllazen ne qe jemi veç nje motër tjetër skemi.

Gjatë krijimit të romanit Kadareja është mbështetur kryesisht mbi motivin e baladës popullore ballkanike, përkatësisht nga jugu i Shqipërisë nga vjen edhe vet.

Ngjarja është e periudhës së fundme bizantine, ku, në sfond është një martesë e largët “**nëntë male kaptuar**”, apo një krushqi si forcim aleancash ku vajza e vetme e familjes Vranaj, Doruntina, duhet të flijohet për interesat e Arbërisë. Pakënaqësi të madhe lidhur me këtë martesë shfaq sidomos e ëma dhe djemtë e saj, përveç Kostandinit, e mos të flasim për Doruntinën të cilës nuk i pëlqente aspak por që s’kishte ç’të bënte, pasi për fatin e saj vendosnin të tjerët. Këtë e dëshmojnë vargjet si më poshtë: ***“Pa m’nigjoni vllaznit e mi, sall ni motër tjetër spat, si u kujtuat n’Krajli mem tret?***

Të jesh motër e nëntë vëllezërve, apo bijë e një fisi të madh, të jetosh në kohën e kanunit do të thotë të mbyllësh gojën, sepse vetëm në këtë mënyrë ruhet botëkuptimi i vjetër patriarkal. Përkundër të gjitha sjelljeve, motra zakonisht nuk mbante mëri me vëllezërit e saj.

10 Demush Shala, *Letërsia popullore, Rilindja, Prishtinë, 2002*, f. 189.

Nuk ua kthen fjalën atyre dhe ka besim të madh kur ata i premtojnë diçka. Tragjedia familjare fillon me vrasjen e nëntë vëllezërve në luftë:

“Erdh një vit shumë i prapë, e i korri asaj zonje, nëntë bijtë në një shesh lufte.”¹¹.

Kush e solli Doruntinën shfaqet edhe si pasyrim ndërtekstsor i një rrjeti më të gjërë, që duke e bërë emblematike mënyrën kadareane të konceptimit të letërsisë, e përvijon atë brenda një universi në shtrirje të vazhdueshme e të pafundme.

PËRFUNDIMI

I skalitur nga një lirikë magjepsëse, sidomos në përmbyllje të tij, dhe i përshkuar nga hipoteza e dilema të mëdha, romani “Kush e solli Doruntinën”, mbetet gjithësesi i përmbushur, i përkryer qoftë për kah narracioni, përshkrimi, personazhet, veprimi dhe gjithçka tjetër që lidhet me të. Një roman i cili të krijon mundësinë e studimit të tij në shumë fusha si në ato të mitit, intertekstualitetit, mundësinë e trajtimit të inçestit brenda romanit, siç është kërkimi këmbëngulës i hetuesit kryesor, Stresit, për fundin e enigmës dhe zbardhjen e të vërtetës.

Në këtë punim, përveç tjerash, jemi përpjekur të nxjerrim në pah të shkuarën mitologjike dhe historike të shqiptarëve te vepra “Kush e solli Doruntinën”, pasi që edhe *sipas vetë shkrimtarit Kadare, pikërisht në mjedisin ballkanik, shqiptar, e sidomos atë arbëresh ajo ruan një nga format më të bukura, më origjinale dhe më të lashta, shprehje edhe e vendit qendror që zë koncepti i besës në identitetin dhe kujtesën kolektive të arbëreshëve të Italisë*.

Në të vërtetë qasjet e vazhdueshme të autorëve të ndryshëm gjithandej, ndaj çështjes së ndërtimit të narrativës mbi baladën e vjetër apo legjendës së lashtë, asnjëherë nuk kanë pushuar. Njëjtë siç nuk ka rreshtur kurrë, as shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare, sidomos me veprën që ishte bosht për trajtimin e temës sonë.

Prandaj konsideroj se gjatë këtij punimi, detyrë parësore e jona nuk ka qenë hedhja dritë mbi figurën e shkrimtari Ismail Kadare, por synimi kryesor ishte përpjekja për të thënë diçka më shumë rreth krijimtarisë së tij voluminoze, e në mënyrë të posaçme, rreth dukurisë së ndërtesktorisë në romani *Kush e solli Doruntinën* duke filluar nga ideja dhe titulli i tij.

Për aq sa kam arritur të analizoj këtë vepër letrare, mendoj se *Kush e solli Doruntinën* mbetet një roman misterioz që në përmbajtjen e vet ngërthen shumë polemika, një roman që flet për Doruntinën e legjendave hipur mbi kalin e të vëllait të ringjallur për të përmbushur besën.

Apo, për Doruntinën e vendosur në mes dyshimeve të medha; e solli fjala e dhënë, apo besa shqiptare, siç këmbëngulin moralistët, apo, atë e solli pengu i inçestit, sipas psiko – kritikëve.

Nëse në krejt këto pohime ka diçka nga e vërteta, a mund të themi se, ***Doruntinën*** e solli rebelimi i mendjes së ndritur të epokës sonë për t’i dhënë legjendës kuptim sublim, ndërsa lexuesit thjeshtësinë e kërkuar me ngulm duke i dhuruar një realizim të përkryer.

- | |
|--|
| Bibliografia |
| 1. Haxhihasani, Qemail, <i>Kenget popullore legjendare, Mihal Duri</i> , Tiranë 1955. |
| 2. Kadare, Ismail, <i>Kush e solli Doruntinën, Onufri</i> , Tiranë 2014. |
| 3. Piegay – Gros, Nathalie “ <i>Poetika e Intertekstualitetit</i> ” <i>Parnas</i> , Prishtinë, 2011. |
| 4. Sinani, Shaban, <i>Për prozën e Kadaresë, Naimi</i> , Tiranë 2009. |
| 5. Shala, Demush, <i>Letërsia popullore, Rilindja, Prishtinë, 2002</i> . |
| 6. Çausi, Tefik, <i>Universi i Kadaresë</i> , 2001. |
| 7. Isufaj, Viola, <i>Miti te Kadareja, Oufri</i> , Tiranë, 2013. |
| 8. Kuçuku, Bashkim, <i>Kadare në gjuhët e botës, Onufri</i> , Tiranë, 2015. |
| 9. https:// sq.wikipedia.org/wiki/Miti |
| 11 Po aty. |

4 Shaban Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit 20-të, Naim Frashëri*, Tiranë, f. 224.

5 Viola Isufaj, *Miti te Kadareja, Onufri*, Tiranë, 2013, f. 31.

6 Bashkim Kuçuku, *Kadare në gjuhët e botë, Onufri*, Tiranë, 2015, f. 195.

7 Nathalie Gros –Piegay, *Poetika e intertekstualitetit, Parnas*, Prishtinë, f. 35.

8 Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinën, Onufri*, Tiranë, 2014, f. 11.

9 Po aty.

Unë Kilin e shoh në pasqyrë të makinës

Kjo ëndër uji—Ç'mban në limann?
Unë shoh Argjentinën dhe Paraguain
Nën shtetrrethim xhami, ngjyrat e tyre,
Rrjedhin si vaj. Nata në Uruguai

Është kripë e zezë. Unë jam nisur për Jutah,
Dhe tërë hemisferën e kam në sy—
Kolumbia është alle, Brazili serë e kalter,
Ca vende janë të shplara fare; Peru-

-ja në të bardhë titaniumi. Si përherë oqeanet
Kukamçefthin në pasqyra, kur brigjet e pjerrët
Presin baticat, a kur portet e botës
S'pranojnë më anije. Ja *Sedona, Nogales*¹

Mbetën mbrapa. Njëherë unë hyra në pasqyrë—
Prej andej bota m'u duk e paprekur, i ngjante
Vetëm vetvetes. Kur dola ja grisa
Lëkurën xhamit. Deti s'e mbante

Më vulën e territ, anijet mbyteshin në bregun
E një republike-plagë... s'po më lënë te shoh mirë
Tanket në Santiago, ja nje kalë i bardhe
Galopon, pa kalorës, i ndjekur nga ushtarë të pirë,

Në xhipa; ata po shtijnë drejt hënës
Teksa grah shkretëtirës, ndiej vërshtëllima plumbi,
Një burrë po vrapon t'arrije urbanin e fundit. Pasag-
jerët
Zgjaten peranash...por ai e humbi.

Turravrap përsëri, gjysëmehena çeliku,
Bien nga qielli. Këndeje shkëmbenjtë,
Humbin nën mjegull, bredhat janë tempuj,
Era në *Sedona* ka gdhendur shumë shenjtë—

Çdo hije, një ndjekës i tyre. Sirena
Santiagon e zbraz; ai burrë po shikon
—nga një heshtje dritaresh—ca burra sylidhur
Brenda furgonesh që faksin. Kali u tret

Si në ëndër. Unë parakaloj figurina
Skeletike, gdhendur 700 vjet para Krishtit.
Kushdo që deshifron këto mure kanionesh
Mbetet i braktisur, me historinë e vetëm,

Pa liman për ëndrat. Dhe tani çfarë tjetër,
Do t'mendojë kjo pasqyrë, përplot me ujë?
Peruja pa shi, Brazili
Pa pyje—këtu në Jutah, tani një kamë


Rrezesh diellore, ndan verën mëdyshas
Soltik—zemër kuarci je e një spirali.
Ta kene ditur Anasazet² më të erttën pergjigje,
Që jep kontinenti në pasqyra kristali?

Aty poshtë tani bie *Soltik* dimëror,
Dy drita makine po shpojnë një dritare
Dhe zbulojnë funerale në sytë e atij burrit.
Në stadiumin plot me prozhektorë të Santiagos,

Kjo është dita më e shkurter e vitit. Aty e çuan.
Ata që presin të vdesin po shohin nga ai,
Sytë e tij janë gurrë varri për tërë të zhdukurit.
Ç'i mbetet pasqyrës të provojë më tani?

Udhëtoj drejt veriut, i ndjekur nga ky vend,
Me dysheme akulli, me qytetarë *Lovesick*
Trualli—krejt xham—aty, i çdo qyteti,
Keq është plasaritur, kërkojnë republikën

Sërish t'jua kthejne si bizhu plot përrndritje
Gërmojnë gjer në ag por zbulojnë veç kufoma.



AGHA SHAHID ALI (1949-2001)

Perktheu nga anglishtja Gëzim Basha

Poet Amerikan me origjinë nga Kashmiri. Në moshë fare të re emigroi në SHBA ku kreu studimet pasuniversitare për letërsi dhe shkrim kreativ, fillimisht në Universitetin e Pensilvanisë, dhe më pas në Universitetin e Arizonës. Agha Shahid Ali ju bashkua levizjes letrare Formalizmi i Ri, një prirje me mjaft ndikim në poezinë Amerikane të dy dekadave të fundit të shekullit të 20të. *Rijjuvenalizimi* i teknikave formale te poezisë tradicionale Islame—veçanërisht Gazelit—përmes një adaptimi elegant në Anglisht, e bën atë një nga zërat më të përvetshëm të Formalizmit të Ri. Agha Shahid Ali, ngjashëm me Joseph Brodsky apo Mahmoud Darwish, mbetet poet i egzilit, por për të ekzili, më shumë se mërgim prej vendlindjes, është premisë dhe disponim për vetmi meditative. Ashtu si Emily Dickenson, Ali besonte se njeriu mund ta jetojë ekzilin edhe pa arratisje prej vendlindjes, edhe brenda shtëpisë prindërore, madje edhe brenda një dhome të saj.

Ai burrë tek kjo ëndër kerkon eshtrat e veta.
Ujrat u errën. Kontinenti më s'duket.

e vetme, nën tre lisa!
A s'mund ta përlaja vite më parë?!

Pasthënia e ujkut për përrallën e kësulkuqes

Së pari, ma njihni një sens historie:
gjithçka unë e bëra për brezat që vijnë,
Për edukatoret e kopshteve
Dhe moralin e përkorë:
Vogëlushet nuk duhet ta lënë kurrë shtëpinë
Në kërkim lulesh të panjohura,
As duhet të flasin me të panjohurit.

Kuptomani, ju lutem, më mirë intrigën:
A s'mundesha unë ta kapërdija
Mu aty, në xhungel?
Perse e pyeta ku rronte gjyshja?
A thua se unë, banor i pyllit,
S'e paskështa ditur ku binte kasollja
e plakës që rronte aty fill

Ju mund të më thirrni, "i Madhi Ujk-Keqi"
Tani për tani, i vetmi nam i imi.
Por unë nuk kam qenë ngacmues femijësh
Edhe pse, pajtohem, ajo ish aq e bukur.

Sa për gjuetarin:
Vërtet flija unë kur ai me gersherë,
Ma priste gëzofin e trashe e të zi,
Dhe barkun me mbushte me kandra dhe gurë?
Unë vrapova dhe u rrëzova
Thjesht për t'i bërë fëmijët të qeshnin
Me zhurmën e gurrëve që prej barkut më ranë.
Me kandrat që u shperndanë...

Unë shfaqja një sens perfekt të kohës
Mu në atë pikë kur perralla
Duhej me doemos të mbaronte.

¹ Emra shkretëtirash në Arizona

² Paraardhesit e fisit indigjen Pueblo

Madje dhe shiu

E çmbetet nga një lidhje dashurie veç shiut?!
Lloto e zisë kush blen, ka blerë madje dhe shiun.

Lustra, fjalët dhe bota, “ a sjell ndërmend, ndokënd?”
Kur kujtonim, poetët, gdhendin madje dhe shiun.

Ne vdiqëm—ajo qe—Zoti na la në t’errët,
Teksa terrin haronim, haruam madje dhe shiun.

Thatësira e pat...Ku isha...Pijet prisnin në dhomë,
Për perzjerje, e dashur, shtjer madje dhe shiun.

Portokallin oval ti shtydhe për aromë,
Nxir vermuth prej qitrosh, madje prej shiut.

Si te deshi ty hasmi...Me dheun, ajrin dhe zjarrin,
Të dilte jek e jek, mbajti madje dhe shiun.

Zoti kërkon truall për një sallë te re dënimesh,
Betohu mbi Bibel, Despot, betohu madje para shiut.

Çmbeti te parathem përveç Fundit të Botes ?
Nje shtyllë për sheshin e vetmuar, madje dhe shiun.

Pas eshtrave, ca lule, ja çgjetëm në urnë ;
Lumin e humbur, shkrumbin e shkallëve, madje dhe shiun.

Si u pezmuar ajri, dheun kalli ne flakë,
Shtëpine të ma djegë, zjarri thiri madje shiun.

Malet desh t’i rrafshonte dhe dallgët t’i shtronte,
Pezmin epik t’a zbuste, ju desh madje dhe shiu.

Nju Jorku në ag me përket mua, vetem mua
Për këtë pretendim kujtesa pruri madje shiun.

U gjend thika që të vrau, të kujt janë ato gjurmë ?
Duar kaq të vogla, Shahid, s’ka as shiu !

Qerbelaja; Një Rrëfim nga Shtëpia e Zisë

Në një kohë e klimë më të largët, skena tragjike e
vdekjes së Imam Hysenit do të zgjojë edhe simpatinë e
lexuesit më të ftohtë.

—Edward Gibbons—

I.

Jezu Krishti dhe dishepujt e tij ecnin permes fushës së
Qerbelasë, kur befas hasen një tufë gazelesh që qanin
të mbledhura kokë më kokë. Dishepujt panë të habitur
nga Zoti i tyre.
Ai u tha: “këtu, tek ky vend, një ditë do të vritet nipi
i Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të.)” Dhe Jezusi
qau. “Ti kisha kryet ujë dhe sytë e mi kroje të vajtoja të
rënin,” tha me ngasherim.
1400 vjet më vonë, sikur sapo ta kishin marë lajmin
për atë që ra në Qerbela në vitin 680, besimtarët ende
mbajnë zi për Hysenin, nipin e Profetit, djalin e Aliut
(Atit të Baltës) dhe Fatimes, të vetmes pasardhëse të
Profetit.
Ashtu si Jezusi që shkoi në Jeruzalem të vdiste në kryq,
edhe Hyseni shkoi në Qerbela të pranonte me pasion
çfarë qe shkruar për të qysh në krye të herës.

II.

Vajtimi i Zejnepid në Damask

Mbi binatë e Hysenit ç’natë paska rënë?

O popull i Shamit, shikomëni mua, e vetmja mbesë
e mbetur nga Profeti, e vetmja fëmijë prej fëmijës së tij!

Mbi binatë e përgjakta të tim vëllai ra agu — sa
shtrenjtë e paguam!

Vajtoni tani, ju që nga qejfi s’bëtë kurrë holokaust, unë
vet i pashë foshnjat e therrura, qanin për ujë.

Dëgjomëni mua, kujtoni Hysenin, ç’dha në Qerbela,
me zemër të prerë-vetë zemra e Profetit, kullonte gjak,
i pavarrosur.

Damask i shurdhër, në bims të Kalifit ata po tallen me
gjak të Profetit. Unë mbeta jetime, e motra e Hysenit,
rrobinjë tirani.

O At i Baltës, klithi kur ra, falmë! Siria fitoi, fëmijët e tu
mbetën jetimë. Lamtumirë!

Pastaj mbështjellë me velin e fjalëve, na la përjetë.

Parajsë pagojëse! Mbi tim vëlla ç’natë paska rënë?!

U shurdhofshin odat qiellore dhe ëngjëjt nga klithma
ime, klithmë e pa zë në pallat të Kalifit!

Sirianë, dëgjomëni:

Mbi shtëpitë e Hysenit ç’natë ka rënë

unë rroj të rrefej hatanë e tim vëllai

Ç’diell po feks mbi trupin e tij?

Qaj, o botë, tim vëlla, qaje Hysenin.

Prej Dritës

Ne ag ti ikën. Lumi vesh lëkurën prej drite.
Unë e rigjej dashurinë tek origjina e dritës.

“kapërdij lamtumirat që s’do t’i them më.”
Ti ma bën me dore, vrik, nga triçikël i dritës.

U dogj libri im? Nisma hirin që të them:
Feniksin ma dërguan në arkëmortin e dritës.

Nga lotët e historisë mëso prej një fytyre
prerë nga i gjakut buletin prej dritës.

Mendim i përkohshëm. E po mirë, ja u zhduk.
A do t’a bëjë Prometeu mëkatin mortal prej dritës?

Ajo tha, “Emri im është heje akulli varur nga...”
E kam lënë unë, diku, në margjinat e dritës?

Kur unë dal i vetëm, si të mbaj vesh Zotin,
S’paskam ç’perfitoj, absolutisht, prej dritës.

Ju dorëzuam fantazisë, madje një xhind
zhveshi nga gjithcka edhe Aladinin e dritës.

A do ta shohim Manhatanin, nuse me diadema,
Me turp t’ja kujtojmë dhëndrin, Bruklinin e ëmbël prej
dritës?

“Një mollëz, / harkun e vetullës, / Qepallën e zbehtë
Dhe synë e zi që unë putha me gjithçka brenda dritës.

O e huaj, kur lumi vaiset nga boshi,
A se braktis, pash terrin tim, gjithçka të dritës.



Na ishte një peshktar me gruan e tij. Ata jetonin diku pranë detit në një kolibe të vjetër e të lyrosur. Çdo ditë peshkatari dilte në breg dhe hidhte grepin në ujë. Me atë punë ai ishte marrë vite me radhë.

Njëherë në mëngjes po rrinte e po vështronte valët e qeta vaj. Befas filli i grepit u tendos dhe po zhytej me shpejtësi në ujë. Peshkatari u ngrit në këmbë, e tërhoqi mbrapsht dhe vuri re se në gremçat e grepit, kishte ngecur një peshk i madh, i panjohur në ato ujëra. Peshku duke u përpëlitur, për çudi foli me zë njeriu:

- Të lutem, o njeri i mirë, lermë të jetoj! Në të vërtetë nuk jam peshk. Dikur kam qenë princ, por një shtrigë mizore me magjitë e saj më ktheu në llojin që sheh. Të lutem, më lësho në det, me shpresë që një ditë të kthehem te njerëzit e mi!

- Jo, mos m'u lut! - i tha peshktari. - Një peshk që flet, do ta liroj që tani! - Dhe ashtu bëri. E lëshoi sakaq në ujë. Princi - peshk brofi mbi valë e u largua, duke lënë prapa një vijëz të kuqe gjaku.

Ndërkohë, njeriu i mirë peshkatar mori udhën për në koliben e tij. Sapo hyri, i kallzoi gruas për princin - peshk. Se si e kishte kapur me grep dhe e paskësh lëshuar në det, meqë ai i qe lutur ta linte të lirë. Më pas shtoi se princi qenkësh shndërruar në peshk nga magjistricat.

- Princ, the? E ti s'i kërrove asgjë? - i bërtiti gruaja.

- Jo, e çfarë t'i kërkoja!?

- Ah, more burrë! Ç'na bëre! Pse në këtë kolibe si stallë derrash do të jetojmë ne gjithmonë? Ik, nisu, që tani dhe kërkoj të paktën një shtëpi të vogël, por të re!

I shoqi, deshi - s'deshi, i zënë ngushtë nga e shoqja, u nis për në breg. Deti ishte i qetë, i verdhë në jeshil. Eci bregut pranë valëve, ndaloj dhe thirri:

- O princ! O princ! Dil e dëgjomë pak, të marrsha të keqen!

E nuk vonoi e princi - peshk u duk mbi ujë e, duke notuar, iu qas bregut dhe pyeti:

- Ç'të ka ndodhur, o njeri i mirë?

- Kjo kokë e ka fajin! Vajta e ia tregova gruas të gjitha fije e për pe se ç'më ndodhi me ty! - iu përgjigj ai. - Sapo mori vesh që kisha zënë një princ - peshk dhe më pas e lirova, nisi nga grindjet, nga ankesat e kërkesat. Nuk e durova dot, ndaj erdha këtu.

- Mirë, mirë, por më thuaj ç'kërkon nga ti ajo?

- Është mërzhitur se rrojmë te një kolibe e vjetër. Më shtyn të të them se dua nga ti një shtëpi të vogël, por të re.

- Vetëm kaq!? Atëherë, shko, o njeri i mirë, se shtëpia e re po të pret!

Peshkatari, sa i dëgjoj ato fjalë, mezi u mbush me frymë dhe u kthye pas me nxitim. Përpara portës së shtëpisë gjeti gruan, Nëpër oborrin me pus, endej rrotull kaposhi me pendët lara-lara, duke çukitur shpejt e shpejt kokrrat e misrit tok me pulat, zogjtë, rosat e bibat. Kurse në kopshtin me gardh gjelbëronin plot pemë e perime.

- Shko brenda! - i tha gruaja.

Burri hyri i gëzuar, pa vatrën në dhomën e zjarrit e pak më tej - dhomën e pritjes e atë të gjumit.

- Ah! - thirri. - Tani e tutje do ta kemi jetën tonë të lumtur!

- Qysh jo! - ia priti gruaja. Por, sidoqoftë, me të parë e me të bërë!

Pa kaluar as dy javë, ajo i tha burrit:

- Dëgjo mua! Kjo shtëpi, që thua ti, po më duket shumë e ngushtë. Edhe oborri po ashtu. Edhe kopshti. Unë dua

PESHKATARI DHE GRUAJA E TIJ

nga Vëllezërit Grim



të jetojë si zonjë e madhe në pallat, brenda kështjellës. Shko dhe thuaja princit - peshk të gjitha llafet e mia!

- Ah, moj grua! Ç'është kjo kështu! - ia ktheu burri. - S'janë mbushur as dy javë nga dita, kur u bëmë me tërë këto të mira! Nuk shkoj! Nuk kthehem te princi sikur ta di se më bie pika!

- Do të shkosh që ç'ke me të! Ik, mos humb kohën kot, por shko e fol me të!

Atëherë peshkatari doli nga shtëpia i tronditur dhe shkoi në breg.

Deti kishte ndryshuar pamjen, pati marrë një ngjyrë hiri në bruz, ndërsa valet venin e vinin të qeta. Eh, ç'e kishte gjetur me gruan të gjorin peshkatar! Mori frymë thellë ai dhe thirri:

- O princ! O princ! Dil e më dëgjo, t'u bëfsha kurban!

Princi - peshk u duk sakaq mbi valë e i tha:

- Hë, o njeri i mire! Si i ke punët me gruan?

- Mos pyet, aman! Keq e mos më keq i kam! Tani ajo sheh ëndrra me sytë hapur. Kërkon gjëra të çuditshme, marrëzira!

- Thuaj, pra, çfarë do këtë herë?

- I ka shkrepur të jetojë si zonjë e madhe, në pallat brenda kështjellës!

- Të mora vesh. Kthehu tani, o njeri i mirë, se zonja po të pret te pallati në kështjellë!

Peshkatari shqeu sytë, u kthye e u nis për në shtëpi. Po ç'të shihte! Gruaja e vet po rrinte te një pallat i madh!

- Shiko, o burri im i dashur, - i tha ajo, - sa bukur është këtu!

Ai u hutua e i buzëqeshi. Ajo iu afrua, e zuri për krahu, ecën të dy dhe kaluan pragun e portës së pallatit. Shërbëtoret e veshura në të bardha po punonin atje në heshtje. Pastërti e shkëlqim dukej kudo nëpër dhomat me karrige e tryeza të praruara. Prapa kështjellës bleronin kopshti e, sidomos, parku që shtrihej thuajse gjysmë milje larg me kapronj, ketra e lepuj. Po atje shihej edhe stalla e kuajve.

- Ah, - i tha peshkatari gruas i lumtur, - në këtë pallat kaq të bukur me tërë këto të mira do të kënaqemi, apo jo?

- Të shohim, - iu përgjigj gruaja, - po eja tani të ikim, se më flihet!

E kështu, ecën më tej, dalëngadalë për në dhomën e gjumit.

Të nesërmen, pa zbardhur mirë dita, ajo firaune grua, u ngrit e i ra burrit me bërryl në brinjë:

- Çohu, or burrë, - i thirri, - se tani ti duhet të bëhesh mbret e unë mbretëreshë!

- Mos të lanë gjë trutë, moj grua! Ç'flet kështu! Ç'na duhet ne mbretëria? Nuk dua të jem mbret!

- Mirë, atëherë. Dua unë të bëhem mbretëreshë!

- O po, a je në vete!? Ç'është kjo marrëzi që të ra në kokë qysh në pikë të sabahut!? A e di se princi - peshk mund të zemërohet me mua nga ky idiotizmi yt?

- Hajt, hajt, mjaft folë! Ik, shko e ia thuaj, dëgjon? Unë patjetër dua të bëhem mbretëreshë!

Peshkatari nuk foli më, doli e pas ca, mbërriti në breg. Deti ishte turbulluar, kishte marrë një ngjyrë plumbi në të zi. Në sipërfaqe vlonin ujërat e thellësive. Ai ndaloj dhe thirri:

- O princ! O pinc!

Përmes zhaurimës së dallgëve u dëgjua zëri i njohur i princit:

- Hë, o njeri i mirë! Fol, pse më thirrë prapë?

- Ime shoqe, o shpirt, ka shkalluar! Flet e flet, grindet me mua e ç'nuk më thotë! Kërkon diçka që s'e merr maja e kalemit!

- Më thuaj, pra, ç'kërkon këtë herë ajo!?

- Ç'të të them i mjeri unë! Do fronin e mbretëreshë!

- Eh, po kjo s'është kushedi çfarë! Shko, o njeri i mirë, shko, se tashmë jot' shoqe është mbretëreshë!

Peshkatari nuk u besoi veshëve. Megjithatë, u nis për tek e shoqja. Kur arriti te kështjella, pa i habitur se brenda në pallat ishin një rresht i gjatë ushtarësh

me trumbeta e borije. Gruaja mbretëreshë rrinte ulur lart në fronin e pruar. Në krye mbante kurorën e artë mbretërore. Përbri saj rrinin në radhë gjashtë dama. Rreth e rrotull vërehej një pamje feste plot ngjyra.

Pasi e soditi gojëhapur tërë atë pamje, iu afrua bashkëshortes dhe i foli:

- Ah, sa bukur qenka këtu, moj grua!

T'u plotësua edhe kjo dëshirë, hë? Tani je bërë mbretëreshë! Çudi e madhe!

- Ç'thua, burri im! - ia ktheu ajo buzëvarur. - Më mërzhitkan tërë këto! S'duroj dot, kur më thonë mbretëreshë! Dua të bëhem imperatore!

- Prapë qenke e pangopur!? Prapë nuk qenke e kënaqur!? A e merr vesh ti ç'do të thotë imperator? A nuk e di se princi s'e ka në dorë të caktojë imperatorët!?

E shoqja u vrenjt e i bërtiti:

- Mjaft me të tilla! Mos u merr me fjalë të kota! Je përpara mbretëreshës, kupton? Nisu tani dhe fol menjëherë me peshkun - princ! Dua të jem imperatore, të thashë! Nisu, de! Hajt!

Burri uli kokën dhe u nis. Duke ecur udhës, i heshtur e i mërzhitur, mendohej: "Nuk bën, jo, gruaja ime, nuk bën aspak për imperatore! Do të tallen bota me ne! Më në fund, edhe princi - peshk do të lodhet nga këto teka qesharake." E kështu, me këto mendime, ai doli në breg. Deti nxinte, era frynte me furi, ngrinte e shtynte dallgët tutje - tëhu. Peshkatari, edhe pse çapitej me zor kundër erës, thirri:

- O Princ! O Princ!

Peshku i magjepsur çau përmes dallgëve e iu afrua.

- Hë, o njeri i mirë, pse erdhe prapë?

- Ah, princ, princ! Shoqja ime, si përherë, flet e flet dhe këmbëngul si mushka! Tani kërkon të bëhet imperatore!

- E po, mirë e paska! Shko, o njeri i mirë, se ajo në këto çaste imperatore është bërë!

Prapë peshkatari u largua gojëkçur e, sapo mbërriti tek donte, pa se gruaja po rrinte ulur tek froni i lartë, i tëri prej floriri. Mbi krye mbante kurorën e madhe prej ari të imperatores. Përbri saj rrinin alabardierët, njëri më i vogël se tjetri, viganët e xhuxhët. Përballë nëpër kolltukë kadife, qenë ulur mbretër, princë e kontë.

Burri, kaloi para tyre, iu afrua gruas e i tha:

- A je imperatore tani?

- Po, ç'kujton ti se nuk jam!? - ia ktheu ajo rëndë - rëndë.

Ai e soditi i mahnitur.

- Ah, moj grua, - mermëriti, - sa bukur e sa madhështore dukesh!

- Ashtu, ashtu, por tashti dua të jem Papë!

- Je në vete?! Si është e mundur kjo, kur kristianizmi e ka papën. Dy s'ka patur kurrë!

- Ik, or burrë, shko e i thuaj peshkut - princ, se qysh sot dua të jem papë! Dëgjove, apo je shurdhuar? - Jo, moj gruaja ime, princi nuk ka forcë ta bëjë këtë!

- Flet broçkulla ti! Ik shpejt, dëgjon, dhe mos u merr me fjalë boshe!

Burri i gJORë iku. Udhës u përball me erën e fuqishme, që frynte pa pushim. Ai mezi mbahej në këmbë. Gjunjët i dridheshin, ndaj lëkundej, sa djathtas - majtas. Kur arriti në breg të detit, era përplasej furishëm në velat e anijeve, që kërcenin mbi dallgë. E, megjithatë, qielli ishte ende pak i kaltër në qendër, ndërsa nga skajet çohesh një ngjyrë e zezë, siç ndodh para shtrëngatës në det.

Atëherë peshkatari i tronditur u ndal e thirri:

- O princ! O princ! Eja e dëgjo, të lutem,

se tekat e gruas sime të çmendur s’paskan të mbaruar!

- Ç’kërkon tjetër ajo, o njeri i mirë? - e pyeti *princi* - *peshk*, me të nxjerrë kokën nga uji.

- Ah, unë i ziu, o princ! Shtriga, gruaja ime e krisur, kërkon të jetë papë!

- E po, o njeri i mirë, mos u mërzit! Punë për të se ç’do! Shko tek nga erdhe, se tani ajo papë është!

Peshkatarit i erdhi koka vërdallë. Deshi - s’deshi, u kthye pas. Sapo mbërriti, nuk u besoi syve, kur e pa gruan të ulur në fronin e lartë të papës me tri kurora të mëdha në krye, të rrethuar nga shumë kardinalë. Përbri saj ndrinin dy vargje me qirinj nga më i gjati te më i vogli.

- Grua, - i tha ai, duke e vështruar drejt në sy, - a je papë vërtet tashti?

- Ç’pyet, mos nuk shikon mirë nga sytë!? - iu përgjigj ajo.

- Ah, sa bukur! Por, nuk më thua, më në fund, a je e kënaqur?!

- Të shohim! Të kaloj pak kohë, pa të përgjigjem!

Në darkë vonë ata vajtën të flinin. Por, lakmia e egër për lavdi e la gruan pa gjumë. Gjithë natën ajo vrau mendjen se ç’mund të bënte me tej. Kur përmes dritares pa diellin tek ngrihej lart, mendo:

“Pse, a s’jam e zonja edhe unë ta ngre diellin çdo mëngjes në qiell?”

Dhe në kulmin e zemërimit e goditi burrin me bërryl në brinjë dhe i bërtiti në vesh:

- Çohu dhe shko shpejt te peshku - princ dhe thuaji se dua të jem si Zoti i Madh!

Burri ende përgjumshëm e i trembur, sa e dëgjoi, ra nga shtrati. Kur u përmend, thirri:

- Moj grua, u çmënde!? Gëzohu që u bërë papë dhe pikë!

- Jo! - Lëshoi një klithmë ajo, i kapi këmishën, ia shqepi dhe ia grisi. - Nuk jam e qetë! - tha. - Nuk e sheh se s’po duroj dot, kur shoh diellin e hënë. Edhe unë jam e zonja t’i lëviz lart e poshtë ata! Shko te peshku - princ! Dua të jem si Zoti i Madh i thuaj!

- Gruaja ime e dashur, - i foli ai me zë të butë, - princi - peshk mundi të caktonte edhe imperatorin e papën, ndërsa këtë kërkesë të frikshme s’ta plotëson dot!

Ajo i hodhi një vështrim të tmerrshëm dhe e goditi me grusht në kokë.

- Dua të jem si Zoti i Madh! - ulëriu. - Shko shpejt te peshku - princ!

Burri i tmerruar u nis duke qarë për në breg. Tufani me shi - rrebesh nga deti, u ishte sulur fushave me furi, duke thyer, rrëzuar e shkatërruar ç’gjente përpara: bimët, pemët, drurët e gardhet. Në qiellin sterrë e mbi dallgët e zeza e të shkumëzuara, të ngritura mal, shkreptinin vetëtima të zjarra e më pas buçisnin bubullimat me jehona deri larg.

Ilagur gjer në palcë, ai arriti i tronditur e, në kulm të dëshpërimit, thirri me zë të ngjirur:

- O princ! O princ! Gruaja ime u çmend, kërkon, të pamundurën, flet përçart. S’di seç thotë! Oh, tmerr!

- Qetësohu, o njeri i mirë dhe thuamë ç’do tani ajo?

- Tmerr, o princ! Kërkon të jetë si Zoti i Madh!


- Ik, pra! Dhe jepi prej meje porosinë që të kthehet tek ishte në fillim, se tani do ta gjejë koliben e lyrosur! - thirri princi - peshk dhe u zhyt menjëherë në det.

Thonë se gruaja me peshkatarin jetojnë ende tek jetonin së pari.

Përkthim nga Agim Xh. Dëshnica

BARDH’

Poezi nga Enxhi Naum



Bardh’

Si bora e parë në pranverë.
Kështu,
Marr frymë këtu,
Mes mureve të një spitali
të panjohur
Ku më dërgove me duart
E tua të mëdha.
Të bukura as si kristali.

Si më the,
Të kujtohet ?
“Merri këto krahët dhe,
Shko këndo me arinjtë polarë,
Ndonjë ninullë për veten.
Për mua a ndonjë shallvare.”

Sa bujare zemra jote;
Nje kontinent të tërë më dhurove,
Akullnajash.
Që shpresova të ishin prej letre,
Për paqen time,
Për paqen tënde.
Të të tuve,
Të të mive...

Infermieret sot më thanë
Të pi kokainë,
Me verë jo të kuqe .
Se vec kështu shpëlahet;
Mëkati i virgjërisë
Së shthurrur
Të shtrirë mbi carcafët
E pastër.
Paqe!

Edhe ashtu po bëj.
Megjithëse;
Paqen time e gjej.
Ndër varreza që festojnë
Çdo herë që vesh
Këmishën e mbrëmjeve.
Dhe atëherë
kur me shkumës ndërtoj
Tryezën e rumbullëket
Të shoqërisë që më bën
Xhan-xhan...
Xhan-xhan...
Xhan-xhan...
(Përgjithmonë xhan)
E përsëri me verë jo të kuqe;

Bëjmë thashetheme,
Mbi nje spermë te shenjtë,
Që lulëzoi
nën petkun e ngasjes.

Nderkohe retë;
Shkundin nga gjiri i tyre,
Pak sheqer .
Si per të na ëmbëlsuar.
Cfarë fytyre që bëjnë,
Cfarë fytyre!!!
(Vetëm t’i shikosh çfarë fytyre)

Infermieret,
Vdesin nga xhelozia.
E dinë që
Nëse i dedikoj
meshë kokainës,
Do marr mendtë e të cmendurit,
E do bëj shfaqje
në dyert e kishës.
Edhe ato ,
Aq duan,
kënaqin sytë pastaj.
Po sy ka kush ka !
(Sa te bukur që i ke)

Megjithatë
mua më thanë retë
Që mermeri më jep
Hijeshi.
Se kur jam aty,
Nuk bëj ndonje çmenduri.
Të thashë ,thjesht rri.

Tani më qahet ;
S’di kujt t’ia prish
E kujt t’ia ndreq.

Meqë më pyete çfarë kam bërë:
“Kam krijuar
Një kontinent timin.
Atë tëndin nuk e dua .
Mbaje!
Jepja ndonjë infermiereje!
Mos ki merak ,
Se i them unë
Është platin.
Është platin.
Hej, ai kontinent është platin.
Platin është apo jo?

Flokëtorja

Po,
Eshtë e vërtetë;
njerëzit e shëmtuar,
s’mund të jenë kurrë njerëz
Të mirë.
Dhe fati im i keq!
Që une isha gjithmonë,
Njeriu i bukur!
Njoha shume bukuroshë,
që m’i ndanë gjymtyrët
Në copa.
Por mami më tha
që s’jam shëmtuar.
Kështu ua lashë atyre
Të jenë te pabukurit.
Se unë asaj i besoj më tepër.
Po,
Kam filluar të ha mushkonja,
qëkur rezultova me anemi.
Nuk e di gjakun e kujt kanë pirë!
Ama në venat e mia,
Rrjedh larmi;
gjithmonë kam dashur të jem
Vampir.
Por më zë gjaku.
Kështu ha çdo natë mushkonja
të ziera
Po,
Dje ishte hera e fundit,
që bëra diçka për herë të parë.
Dhe sot më detyruan
të bëj për herë të fundit,
Diçka që ndodhi për herë të parë
Por fundi është i pafundëm apo jo?

Rruga e qumështit

A u jep jetë
Fantazmave
Te shtëpisë së vjetër?
Dje,
Pashë një vajzë
Me peliçe leopardi,
Kurse sot,
Dëgjova
Që kishte ndërruar jetë
Leopardi i fundit.

Ç’marrëzi
Unë vazhdoj
Fantazmat
T’i ushqej me gji...

Hapat e mureve

Dhe unë do të të pyes,
-A i bien breshkat
Murit me kokë?
E ti do më përgjigjesh,
-Jo, sepse Muri i një shtëpie
nuk e vret
Murin e një shtëpie tjetër.
Dhe unë do të të them,
-Jo,
sepse ato ecin ngadalë
Dhe rrugës
Harrojnë për çfarë të pendohen.

Konfliktet e konfliktit

E hoqi burri me kapele rozë
Lajmërimin e vdekjes në shtyllë
Të gjyshit tim veteran,
Dhe i ra bilbilit.

i ra bilbilit,
- dëshmitarë donte
- dëshmitarët panë,
Askush nuk erdhi në varrim.

Unë, e kam më të lehtë të fus një bilbil
Në kafaz,
Se sa t’i bie bilbilit.

Nga “Biblioteka futuriste” (Arben Dedja, Pika pa sipërfaqe, 2022)

1- Sotir Deludhi, *Delet e fshatit tim, studim + 50 fotografi delesh (me ngjyra)*

Përveç titullit, ky libër nuk ka asgjë buklike. Autori, siç e pohon edhe vetë, u ul dhe e shkroi nga dashuria për gjuhën shqipe, aq të keqtrajtuar e të masakruar tash së fundi. Shqipja gjuhë e varfër, e shkruar vonë, në rrezik? Aspak!

Thotë Profesor Deludhi:

Pa t'i trajtojmë njëherë pa doreza pasuritë e saj të thella, leksikun e pasur që gjyshërit tanë, barinj të rrafshnaltave epike përdornin, për shembull, për të dalluar delet e kopesë! Numri i këtyre fjalëve – ndonëse mbërritur i gjymtë – është aq i pasur e i larmishëm sa do të mjaftonte, i vetëm, për ta shtuar leksikun tonë të mrrudhur nga dyndjet e huaja me disa mijëra fjalë autoktone më shumë. Balë, bejkë, briçe, çalë, groshare, hutë, kaçë, kërrutë, larë, lavaçe, leke, lepe, llashkë, llajë, mazhë, miskë, qerbë, skuqe, syskë, sykuqe, sharkë, shytë, thinjë, zekë... etj., etj., nuk janë fjalëshpejtëza, por gurë të rëndë në themelet e gjuhës sënë.

Vazhdon autori:

Nganjëherë dallimet midis deleve janë të holla, gati të padukshme për ne, dystabanët: por shpirti piktorik i të parëve nuk lë rast pa na mrekulluar: syskë, është një dele e bardhë me rrathë të zinj rrotull syve, kurse sykuqe, pavarësisht nga emri, është prapë një dele e bardhë, por kësaj radhe me njolla kafe rrotull syve. Nganjëherë një emër krejt i thukët mban përbrenda, si ideogramë, një përshkrim që do të desh përndryshe dhjetra fjalë (për shembull: leke = dele këmbëshkurter me pulla të vogla të verdha poshtë syve dhe me nga një njollë kafe në të dy faqet).

A i memorizuat ndoca këto fjalë? – pyet më poshtë autori në kapitullin mbi sinonimitë. – E pra, kjo listë mund të dublohet kollaj në qyen tjetër të të njëjtit mal. Përse bariu fqinjë duhet të përdorë po atë “terminologji” për delet e veta? Fantazia dhe kreativiteti i njeriut shqiptar, i lirë në trojet e veta alpine, ishte pa cak. Delen që i pari e quan briçe, ky e thërret koçe (të mos ngatërrohet me kaçë, që është krejt tjetër dele), pa miskën e quan sormë, syskën kaleshe, zekën galë e me radhë. [...]

Në këtë pikë autori u propozon gjuhëtarëve me profesion t'i përdorin njëfarësoj këto fjalë, t'i specializojnë edhe më, duke ua shtuar nuancat qimeve gjedhore dhe, si pasojë, thesaret shqipes. Ai, ama, është i vetëdijshëm që nuk mjafton që fjala të qëmtohet fjalorëve e të vihet në dukje në një libër të vetëm. Fjala jeton në komunikim. Po nuk u përdor (medet!) ajo vyshket, vdes. Si i bëhet, pra, për ta mbajtur ndezur traditën e bukur, tani që barinjtë vërtet të apasionuar kanë emigruar prej vitesh në Zvicër qoftë, a në Sardenjë, dhe të mbeturit strallevë shqiptare e kanë orientuar inteligjencën dhe formimin e tyre drejt kultivimeve bimore me jehonë ndërkombëtare? Si i bëhet fjalës *llashkë*, për shembull? Apo fjalës *sharkë*? Në njëfarë mënyre ato duhet të integrohen në indin e modernitetit shqiptar. Po qysh?

Këtë e mësojmë në kapitullin e fundit të librit. Arsjetimi është i hollë, i katërçiptë, ka gjallërinë e zhivës. Vetëm se nuk jemi të sigurt: autori e ka me tërë mend apo po lot me ne një rrurëz qeshjeplotë? Dakord, sugjeron që në realitetin urban të Shqipërisë riciklimi i këtyre termave të bëhet duke u dhënë atyre një ngjyresë figurative, duke i përdorur si trope/metafora (nuk mund të mendohet më që delet, dora vetë, të ecin serbes nëpër Bulevardin Zogu I).

Heroi e vrau birin e Makut;

Pati stuhi shpatash dhe haje korbash.

Dy tregime nga libri i fundit i Arben Dedjas “Biblioteka futuriste” dhe dy të tjerë nga libri i përkthyer prej tij “Sinagoga e ikonathyesve”. Duket sikur këto libra përkrijnë njëri me tjetrin në frymë, imazh e mirazhe të krijuara, ndaj edhe po botohen pranë e pranë në këtë numër të ExLibris.

ARBEN DEDJA NË PËRKTHIM DHE KRIJIM

Janë vargje nga Saga islandeze e Grettir-it, shkruar aty rreth vitit 1000, siç na rrëfen Borges-i. Vargu i dytë këtu, me anë të metaforave (me kalimin e kohës ato u bënë pjesë e pandarë e gjuhës sa askush nuk i vinte më re) do të thotë që pati një betejë (*stuhi shpatash*) me të vdekur (*haje korbash*). Kështu duhet proceduar edhe me emërtimet e deleve shqiptare. Dhe vendi më i mirë, sugjeron autori, ku këto fjalë do të ngjisin vërtet në matricën e gjuhës është po qe se përdoren, ashtu të tëra, nga janë e nga s'janë, për të identifikuar diçka të përhershme e aktive. Për shembull: **parlamentarët**. Njëqind e dyzet parlamentarë: jo më njëqind e dyzet germa *twitter*-i për t'u klikuar (për të cilat, meqë ra fjala, pulqerët e tyre me manikyr, por edhe me dhë e graso brenda thonjve, janë të hajthëm fort), por njëqind e dyzet lloje delesh për ta dalluar njëherë e përgjithmonë njërin parlamentar nga tjetri, për ta fiksuar atë mirë në ndërgjegjen e thellë popullore dhe për ta pasur të

përbashkët kopenë që qen pastorë e ruajnë vëngër. Kryetari i Parlamentit bën sikur nuk e dëgjon deputetin e opozitës që kërkon fjalën, që propozon diçka të arsyeshme? Ok, po sikur ta thërrasim, për shembull: *hutë*, që është një dele me veshë shumë të vegjël. Një parlamentar propozon një ligj jashtë faze, e mbi të gjitha, të papërpunuar juridikisht? Po sikur t'i themi: *llashkë* (kështu quhet delja që pjell para kohe)? Dyshimi për një shaka djallëzore mbetet, por kënaqësia e të lexuarit është edhe më e madhe.

Së fundi, si recensues i parë i këtij teksti, shpreh një peng: për arsye banale, rënduar nga pandemia Covid, ky studim nuk arriti të dalë në kohë për Panairin e 24-t të Librit “Tirana 2021”. Disa fotografi me ngjyra delesh, që autori desh me çmos t'i përfshinte, e ngadalësuan në mënyrë fatale shtypshkrimin. I kam ndër duar, por nuk po i nxjerr këtu se druaj mos ndesheni në ndonjë fytyrë të njohur.

Lexim të mbarë!




2- Dhoksan Pano, *Një teori e përkthimit letrar (prolegomenë e metafizikës dhe e fizikës së përkthimit), studim*

Kush i ka shkruar i pari *Rubairat*? Omar Khajami apo Edward Fitzgerald-i? E Fan Noli, a nuk ka qenë ai më i pari fare? Pyetjet, në vetvete të fandaksura, nuk mbeten të këtilla pasi të keni lexuar *Një teori e përkthimit letrar...*, të Dhoksan Panos, i njohur për publikun si i ashtuquajtur “përkthyesi alpin” (jeton dhe punon në një kullë të alpeve shqiptare, 1.950 metra mbi nivelin e detit), me disa kryevepra shqipëruar qysh në rininë e hershme, por më vonë, kur si autoritet i letrave anglofone mori tagrin që meritonte, i përmendur për dhënien në shqip të disa autorëve pak ose aspak të njohur, nganjëherë enigmatikë, pse gjurmët e tyre nuk gjenden gjëkund, as në internet. Kurse tani, në prag të moshës së tretë, vjen para botës intelektuale me këtë studim të mirëfilltë mbi natyrën e përkthimit dhe raportin midis tekstit të përkthyer dhe “originalit”.

Ç’kuturisje lavdimadhe! I mbudhur nga teoritë e Platonit mbi idetë, por edhe nga teoritë më moderne të fizikës mbi relativitetin e kohës, studiuesi Pano na shpalos këtu të vërteta të paimagjinueshme mbi përkthimin. Nga ky sinkretizëm i papritur lind një teori revolucionare që autori ynë jo vetëm e ka përqafuar në sferat e larta të mendimit, por edhe e ka kthyer në formë jete. Pa dashur të bëjmë ndonjë *spoiler*, thelbi i teorisë fillon të marrë trajtë me konceptin e ideve të Platonit, që i quan ato, idetë, pra, banore të një bote sipërane, të fiksuara në amshim; kurse ne merremi vetëm me një pasqyrim të zbehtë të tyre në mendjen tonë, në jetën tonë. Kështu, pohon Pano, ndodh edhe me tekstet letrare që, tekefundit, mbartin ide: përpara se të shkruhen ato ekzistojnë në botën sipërane.

Çdo libër, pra (flasim për kryeveprat), sipas studiuesit – më mirë të themi “mendimtarit” Pano – është shkruar prej kohësh e ndodhet tashmë në dorëzim në Republikën e Ideve të Platonit, ku pret të kapet nga një dorë e sigurt dhe e padukshme, që të shfletohet para syve të lëbyrur të botës. Meqë, sipas Panos, ndryshimi i vetëm mes një veprë “origjinale” dhe po të njëjtës, por të “përkthyer”, është të qenit e sfazuar në kohë dhe vetëm kaq – akti krijues, vllaga e frymëzimit, përfytyrimit e gjithë të tjerat janë njëlloj – mbetet thjesht të përcaktohet kush e ka vënë dorën i pari në raftin e ideve. E sikur të provohet që Fan Noli ta ketë bërë përpara Khajamit? Për këtë, Pano është i sigurt. Dhe pikërisht këtu fut në lojë konceptin e kohës. Koha është relative. Dhe fizika e mijëvjeçarit të ri tashmë e ka provuar: kur je lart, koha lëviz më shpejt. Ndaj edhe Dhoksan Pano jeton majave të alpeve shqiptare që, duke e pasur kohën e tij që kalon më shpejt, t’u paraprijë – siç ka bërë – autorëve, atyre autorë të gjuhës angleze që mëton t’i ketë përkthyer këta vitet e fundit: autorë që, me gjasë, nuk janë bërë ende të tillë, ndonjëri syresh është ende në kopsht, ndaj dhe nuk ia gjejmë emrin nëpër internet a kudo qoftë, por që më vonë, me siguri, do të shpërthejnë, me veprën që Dhoksan Pano e ka përkthyer ndërkohë në shqip, veprë që autorët do ta nxjerrin me përdëllesë, me përtësën që u jep koha, nga rafti i ideve, si “origjinale”.



Nga “Sinagoga e ikonathyesve” (J. Rodolfo Wilcock, përktheu Arben Dedja, Pika pa sipërfaqe, 2019)

1- A. De Paniagua

Dishepull i Elisée Reclus-it dhe mik i Onésime Reclus-it, A. De Paniagua shkroi *Qytetërimi neolitik* për të treguar që raca frënge është e zezë në origjinë dhe rrjedh nga India jugore, çka nuk përjashton që në kohë edhe më të lashta francezët të kenë ardhur nga Australia, duke pasur parasysh lidhjet gjuhësore që, sipas Trombetti-it, afronin gjuhët dravidike¹ me australishten primitive. Këta të zinj lëshoheshin nëpër shtegtime pafund; totemi i tyre parak ishte qeni, siç e tregon rrënja “kur”, prandaj edhe quheshin “kuretë”². Duke qenë se s’linin vend pa udhëtuar, gati në të gjitha viset e botës gjendet rrënja “kur”: Kurlandia, Courmayeur, Kurdistan, Courbevoie, Courcinga e Kalabrisë, Kurbini dhe ishujt Kujrile. Totemi i tyre i dytë ishte gjeli, siç e tregon rrënja “kor”, prandaj edhe quheshin “koribantë”. Emra visesh që fillonin me “kor” ose “cor” – Korea, Kordova, Kordofan, Cortina, Korça, Corato, Korfuzi, Corleone, Kork, Cornwall dhe Cornigliano Ligure – gjenden pak a shumë në gjithë botën, kudo ku kanë kaluar paraardhësit e francezëve.

Një pasion i tillë shtegtues shpjegohet pjesërisht me faktin, me sa duket të vërtetuar, që në çdo vis ku mbërrinin kuretë dhe koribantë, qoftë ajo Skithia apo Skocia (me sa duket e njëjta fjalë), Japonia apo Amerika, ata bëheshin të bardhë; me raste, të verdhë. Francezët e hershëm ndaheshin në dy grupe të mëdha: kur-ët që ishin qentë e mirëfilltë dhe kor-ët që ishin gjelat. Këta të fundit ngatërrohen shpesh nga etnologët me qentë: prirja thjeshtëzuese çon (medet!) drejt varfërimit të historisë, vëren Paniagua.

Qen dhe gjela përshkajnë stepat e Azisë Qendrore, Saharanë, Pyllin e Zi, Irlandën. Janë shamataxhinj, gazmorë, inteligjentë, janë francezë. Dy shtysa të mëdha kozmike bëjnë që kuretët dhe koribantët t’u japin këmbëve fort: shtysa e të shkuarit për të parë ku lind dielli dhe ajo e të shkuarit për të parë ku dielli falet. Të udhëhequr nga këta dy impulse të kundërt dhe të pandalshëm, bëjnë pa e kuptuar një udhëtim rreth botës.

Drejt lindjes largohen duke dëfryer e duke ngulur rrugës menhirë³. Mbërrijnë në ishujt Kujrile; edhe një hap e hidhen në Amerikë. Për ta vërtetuar këtë, mjaft të gjejmë një emër vendi të rëndësishëm që fillon me “Kur”. Afërmendsh, kemi Groenlandën, emri i saj i vërtetë, shpjegon Paniagua, duhej të qe Kurelandë. Gabim do të ish, pra, të mendohej që “Groenlandë” domethënë tokë e gjelbër, për sa kohë që Groenlanda është e bardhë, ngado ta shohësh; por letra e fortë në dorën e etnologut është një fotografi me dy eskimezë, shkrepur ndoshta gjatë perëndimit të pafund polar: ç’është e vërteta, janë skrop të zinj.

Të tjerë kuretë dhe koribantë, edhe ata duke kërcyer, edhe ata tebdilë si qen dhe si gjel, nisen drejt perëndimit. Ngjiten përgjatë Isterit (sot Danub), të shtyrë nga një ideal revolucionar; në gjakun e errët të racës ndiejnë nxitjen ngazëlluese për të themeluar Francën. Sa i përket lëkurës, me të kaluar Ballkanin bëhen të bardhë, leshverdhë bile. Kësisoj vendosin të marrin emrin zulmëmadh të keltëve, për t’u dalluar

nga zezot e mbetur pas. Autori shpjegon që keltë domethënë “adhurues qiellorë të zjarrit”, nga “kel”, qiell (kalimi nga velar në palatal, etimologji e drejtpërdrejtë) dhe “të” (zjarr në dravidisht, etimologji e tërthortë).

Ndërkohë që të bardhët-sefte i ngjiten përpjetë Danubit, Paniagua lëvdon durimin dhe trimërinë e tyre: shumë mund, shumë lumenj e male për t’u kapërcyer, për të shkuar e vënë gurët e parë të një ndërtese drite e farfurish, ku qëndron i paluajtshëm shpirti i thellë i Francës.

Teksa çapiten, keltët dërgojnë poshtë e lart misione eksplorues që themelojnë ngulime që më vonë u bënë të famshme; për shembull, Venecia (emri origjinal frëng, Venise) nga dravidishtja “ven”, i bardhë, dhe nga keltishtja “is”, poshtë. Vështirë të gjesh etimologji më të saktë, komenton Paniagua. Një tjetër shmangie shtegtuese, dhe tirolezët shkëputen nga dega kryesore për t’u vendosur në mënyrë të qëndrueshme në brigjet e Tirrenit, siç na e rrëfen rrënja Tir.

Një degëzim edhe më radhëngjeshur, durimhumbur ngaqë Zvicra nuk i lë të kalojnë, zbret përgjatë lumit Po dhe themelon Italinë (emri origjinal frëng, Italie). Etimologjia është goxha intuitive edhe me këtë rast; “ita” vjen nga latinishtja “ire”, udhëtoj, dhe “li” nga sanskritishtja “lih”, lëpij. Kjo do të thotë që qentë kuretë jo vetëm lehin, por edhe lëpijnë; Itali pra domethënë “vendi i qenve endacakë lëpirës”. Çka del edhe më në pah po të mendosh ligurët, atë popull misterioz: li-kuri, ose më mirë qentë lëpirës në kulm.

La Civilisation Néolitique (1923) është botim i shtëpisë Paul Catin; blej të tjerë të së njëjtit gjerdan janë *Artiljeri im*, i kolonelit Labrousse-Fonbelle, dhe *Hellas, Hélas!* (kujtime pikante të Selanikut në kohë lufte), i Antoine Scheikevitch-it.

2- Henry Bucher

Në moshën 59 vjeçare, belgu Henry Bucher në të vërtetë ishte vetëm 42. Arsytet e kësaj tkurrjeje kohore jepen në parathënien e librit të tij me kujtime, *Souvenirs d’un chroniqueur de chroniques* (Liezh, 1932): “Me t’u diplomuar dhe përdhur me tërë vllugun e viteve të mia më të gjelbërta kah studimi ëndjeplotë i historisë, shpejt kuptova që detyra e gjetjes, përkthimit dhe komentimit të korpusit të plotë të kronistëve mesjetarë – pararendësit obskurë të Froissart-it dhe Joinville-it, të të madhit Villehardouin dhe të Commynes-it – për të cilën i isha zotuar vetes ta kryej, katërçiptazi dhe spikatshëm, i kalonte caqet kohore të parashikuara: nuk do të më mjaftonte, ndoshta, një jetë për ta përmbushur. Duke lënë mënjane punën hulumtuese të teksteve të humbura, më së shumti të kryer – dhe kryer për mrekulli – nga mësuesi im i nderuar Hébéard De la Boulerie, vetëm përkthimi nga latinishtja në frëngjisht (nga një latinishte jo rrallë e bastarduar në frëngjishten sqimatare të ditëve të sotme) do të më hante tërë harkun e viteve që, sipas gjasës, më kishin taksur Parkat; po t’i shtohen kësaj shënimit, gjetjen e përputhjeve – por në rastin në fjalë shumë më e drejtë do të ish t’i quaje shpërputhje – daktilografimin, po dhe detyrimet e ndryshme që kanë të bëjnë me çuarjen për shtyp, korrigjimin e bocave, esetë hyrëse, zhvillimet polemike, letërkëmbimin me Akademitë e të tjera, plus gjëra të paparashikuara, lexuesi do ta kuptojë me ç’siklet dhe ndërdyshje ai djaloshi që isha atëbotë, në prag të të njëzetepesave, iu desh të merrte në shqyrtim mundin e hatashëm që po i fanepsej dhe nevojën urgjente për një plan të mirëmenduar pune.


“Tërësia e kronikave historike për t’u përkthyer dhe pajisur me shënime, hiq

zbulime të reja tashmë të pagjasa, ndonëse gjithnjë të mundshme, qe e njohur dhe e stërnjohur nga ana ime; sidoqë, i kisha vënë vetes një cak të mëtejshëm, atë të të marrurit vetëm me vepra hartuar në shekujt nga i nënti te i njëmbëdhjetë. Të dymbëdhjetin e kish uzurpuar, ca si tepër shkëlqyeshëm, kolegu Hennekin nga Strasburgu; nga i teti, Kisha ruante koprracisht në katakombet të veta (*dans ses caves*) perlat më premtuese. Edhe kësisoj, ata tre shekuj të shkretë lypnin – duke i rumbullakosur hesapet mangët – të paktën tridhjetë vite përkthime; shto punët e mbetura, nuk do të mundja dot ta kurorëzoja veprën time përpara të tetëdhjetave. Për një djalosh ambicioz dhe të paduruar, gjendja statike e një tetëdhjetëvjeçari mund të duket nganjëherë, po themi pa ndonjë motiv të arsyeshëm, pak tërheqëse, dhe pa lavdi dafinat që pashmangësisht – por jo gjithmonë – e stolisin. Kështu m’u duk atëbotë; ndaj sajova një mënyrë, në mos për ta mundur, të paktën për ta ndalur kohën.

“Me mprehtësi kisha vëzhguar ndërkohë që një personi tejet aktiv nuk i del java për të plotësuar detyrimet e një jave; punët e shtyra grumbullohen (t’u përgjigjesh letrave, të vësh rregull në dorëshkrimet dhe çorapet e tua, të rishohësh shkrimet për shtypin makut, pa harruar udhëtimet, dasmat, vakitë, revolucionet, luftërat dhe bjerraditje të këtij lloji) aq sa në njëfarë pike lipset ta ndalësh të tatëpjetën e ditëve, për t’iu kushtuar siç duhet detyrimeve të lëna pas dore. Paskëtaj do të qe e lehtë ta rivije në lëvizje kohën, të çliruar nga punët e prapambetura: të lirshme, të rilindura, të shkrydhëta, pa zvarrisje.

“Dhe kështu bëra, me ndihmën e kalendarit tim personal: një ditë çfarëdo, po themi 17 korrik, mbaroja, për shembull, së përkthyeri Librin e Tretë të Otonit të Trevirit. Ndaloja datën; *ipso facto*⁴ isha i lirë të shtypja me makinë dorëshkrimin, të korrigjoja bocat e Librit të Parë, të merrja pjesë personalisht në Kuvendin e Historisë së Triestes, të përpiloja Shënimet e Librit të Dytë, të hidhesha pak andej nga Sorbona për të demaskuar një Apokrif, të përditësoja letërkëmbimin, të shtyhesha deri në Ostendë me biçikletë; dhe kjo e gjitha duke e ruajtur gjithnjë fikse datën 17 korrik. Dikur, pa pësuar më detyrime a shtrëngesa, merrja në duar Librin e Pestë dhe i futesha përsëri punës. Për të tjerët, kishin kaluar gati dy muaj, po ia niste vjeshta; kurse për mua ishte ende korrik, tamam-tamam 18 korrik.

“Pak e nga pak pata ndjesinë e qartë, të përforcuar edhe nga faktet, e të mbeturit prapa në kohë. Kur prusianët pushtuan trojet tona të dashura, duke prerë gjinjë e grave shtatzëna dhe, ç’ish më e keqja, telat e korrentit, isha ende i ngecur më 1905-ën; lufta e ’14-ës mbaroi për mua qysh më 1908. Sot, që më në fund arrita ’14-ën, atdheu im i gjorë ka mbërritur më 1931 dhe po kalon, me aq sa thonë, një krizë të rëndë ekonomike; besa, kam vënë re që, sa herë ndaloj kalendarin, çmimi i letrës pëson rritje të madhe. Nejse, falë kësaj kohe të fituar, nuk jam lodhur; ndihem i ri, bile jam i ri; historianët vërsnikë janë tashmë te të gjashtëdhjetat, unë sapo kam kapërcyer prapun e të dyzetave. Ky marifeti im i thjeshtë u tregua dyfish efikas; edhe dhjetë, dymbëdhjetë vite të tjera dhe do ta kem përmbyllur veprën, botimin e plotë në frëngjishte të rrjedhshme moderne, me komente po aq të rrjedhshme, të 127 kronikave të tre shekujve; në vërsën vetëm dyzetepesëvjeçare do të njoh, në mos lavdinë, pataksjen admiruuese të kolegëve dhe, pse jo?, të zonjave”.



4 Shprehje latine (fjalë për fjalë “mbi vetë faktin”). – 1. Përdoret (shpesh me ton shpotitës) në kuptimin “menjëherë, aty për aty, pa kohë tjetër midis”. 2. Për vetë faktin, automatikisht. Këtë kuptim e kemi veçanërisht në kodin e së drejtës kanonike, për të treguar që vetë fakti që ke shkelur një ligj bën të pësosh automatikisht dënimin përkatës.

Këtë analizë po ia kushtoj përkthimit në shqip të vëllimit të parë të romanit të Tolstojt “Lufta dhe paqja”, i cili është romani më i famshëm ndër romanet rusë të të gjitha kohëve dhe një nga veprat më të rëndësishme të letërsisë klasike botërore, që nuk vjetrohet kurrë e që i ruan në shekuj, si vargjet e Homerit e të Dantes, forcën dhe freskinë.

Përkthimi i këtij vëllimi të parë të romanit është bërë nga Sotir Caci, është redaktuar nga Loredan Bubani dhe është botim i tretë i Shtëpisë Botuese “OMSCA-1”.

Qysh në krye të herës duhet thënë se përkthimi tregon se kemi të bëjmë me një njohës shumë të mirë të gjuhës shqipe deri në imtësitë më të thella të saj dhe me një përkthyes të sprovuar, i cili në tërësi i ka qëndruar korrekt tekstit origjinal të veprës. Megjithatë në përkthimin e vëllimit të parë të këtij romani gjejmë harresa, fjalë, fjali apo edhe paragrafë të papërkthyer ose, e kundërta, shtohen fjalë që s’janë në tekstin origjinal të veprës. Duke qenë se kemi të bëjmë me botimin e tretë të romanit, mendoj se me një punë të kujdesshme redaktoriale, duke ndjekur hap pas hapi me shumë vëmendje origjinalin e veprës, mjaft prej pasaktësive që do t’i rendisim më poshtë, do të qenë shmangur.

Pasaktësitë kanë të bëjnë me harresat që përmendëm dhe me shtesat e fjalëve që s’janë në tekstin origjinal, me fjalë a fjali të papërkthyer si duhet, me dhënien e gabuar të shumë fjalëve në frëngjisht dhe gjermanisht që janë në tekstin origjinal, me mosrespektimin e paragrafëve në kuptimin që në origjinal është kryeradhë dhe në përkthim jepet si vazhdim i paragrafit dhe, e kundërta, kur është vazhdim paragrafi, jepet si kryeradhë (paragrafi, siç është formuluar nga autori, s’preket, duhej dhënë me saktësi siç është, si një e tërë, le të jetë edhe një apo dy faqe, se ato mendime ka dashur të përmbledhë në të autori dhe ne s’kemi kurrfarë të drejte ta copëzojmë atë, duke kaluar disa herë në kryeradhë); pastaj shumë emra të personazheve shqiptarizohen, në një kohë që duheshin lënë siç tingëllojnë në gjuhën e tyre, nuk respektohen si duhet rastet e hapësirave ndërmjet rreshtave, nuk jepen me shkronja kursive fjalët që në tekstin origjinal janë me kursive, vihen thonjëza në fjalë e fjali, të cilat nuk i ka autori i veprës etj.

Po le t’i shohim konkretisht në roman këto që thamë:

Harresat dhe shtesat:

Në f.324 janë harruar pa u përkthyer gati shtatë rreshta: - Ну-ка, как вы из этого выйдете? –спазал он. – Будем стараться, - отвечал Берг, дотрогиваясь до пешки и опять опуская руку. – В это время дверь открылась. – Вот он наконец! – закричал Ростов. – И Берг тут! Ах ты,петизанфан, але куше дормир! – закричал он, повторяя слова няньки, над которыми они смеивались когда-то вместе с Борисом (- Па të shohim pakëz si do t’ia bëni tani për të shpëtuar? – tha ai. – Do të përpigemi, - u përgjigj Bergu, duke zgjatur dorën deri te guri i shahut dhe duke e tërhequr atë. Në këtë moment u hap dera. – Ja ai më në fund! – thirri Rostovi. – Qenka edhe Bergu këtu! Ah ti, *pëtizanfan, ale kushe*, dormir! – thirri ai, duke përsëritur fjalët e dados, me të cilat talleshin dikur bashkë me Borisin.) Në f.141 është harruar një paragraf i tërë pas fjalëve “një kapiten i madh”: - Михайл Иванович! – закричал старый князь архитектору, который, занявшись жарким, надеялся, что про него забыли. – Я вам говорил, что Бонапарте великий тактик? Вот и он говорит. – Как же, ваше сиятельство, - отвечал архитектор. (Mihajll Ivanoviç! – i thirri princi plak arkitektit, i cili, i zënë i gjithi me mishin e pjekur, mendonte se e kishin harruar. – A ju kam thënë që Bonaparti është një takticien i madh? Dëgjojeni, po e thotë edhe ai. – Pikërisht kështu Shkëlqesia Juaj, - u përgjigj arkitekti.) Në f.109: Князь Василий на ходу сказал несколько слов Лоррену и прошёл в дверь на цыпочках. Он не умел ходить на цыпочках и неловко подпрыгивал всем телом. (Prici Vasili, në lëvizje e sipër, i tha disa fjalë Lorrenit dhe shkoi te dera në majë të gishtërinjve. Ai s’dinte të ecte në majë të gishtërinjve dhe bënte hapa të vegjël pa shkathtësi me të gjithë trupin.) Në f.279: Она оглянулась, взглянула прямо на него, блестя чёрными глазами, и улыбнулась. (Ajo ra greth e rrotull, pastaj ia nguli atij sytë e saj të zinj që shkëlqenin, dhe buzëqeshi.) Në f.239 është harruar pa u përkthyer një paragraf: Но ружья остались заряжены, бойницы в домах и укреплениях так же грозно смотрели вперёд, и так же, как прежде, остались друг против друга обращённые, снятые с передков пушки. (Mirëpo pushkëve nuk iu hoqën fishekët, frëngjitë e baterive, nga shtëpitë dhe fortifikatat, shikonin gjithnjë me të njëjtën mënyrë kërcënuese përpara, dhe po kështu, si më parë, mbetën duke iu drejtuar njëri-tjetrit topat e shkëputur nga parakarrocëritë.) Në f. 91 lihet pa u përkthyer брегет (breget) që ishte një orë e vjetër xhepi, e cila e kishte marrë emrin nga shpikësi i saj Breget. Në f. 219: Прежде чем ехать к Билибину, князь Андрей поехал в книжную лавку запастись на поход книгами и засиделся в лавке. (Para se


Pasaktësitë në përkthimin e vëllimit të parë të romanit “Lufta dhe paqja”

Nga Theodor Cico



Pasaktësitë:

Në f.78-79...S’ka asgjë të pamundur për të, dhe kjo më pëlqen... Jo, s’është thënë kjo, sepse konti Rostov nuk thotë që s’ka asgjë të pamundur për Mitenjkën, në kuptimin që ky është i zoti të bëjë gjithçka. Jo, ai e ka fjalën në përgjithësi që gjithçka mund të bëhet. (Нет того, чтобы нельзя. Я же этого терпеть не могу. Всё можно. Pra, s’ka asgjë që s’mund të bëhet. Unë pra këtë s’e duroj dot. Gjithçka mund të bëhet.) Në f.120...çdo funksionar i krahinës. Jo, është kryetari i guvernës (начальник губернии). Në f. 135...Plaku...thoshte se gjumi pas drekës (после обеда) është i argjenditë, kurse para drekës (до обеда) është i artë. Pra, s’mund të përkthehet pas buke dhe para buke, se bukë hahet edhe në darkë, kurse këtu është përcaktuar për drekën. Në f.175, por edhe kudo në roman personazhi Denisov nuk e shqipton mirë “r”- në dhe Tolstoi e nënvizon këtë në të gjitha rastet kur flet Denisovi. Prandaj kjo nuk mund të kalohej duke mos i dalluar “r”-të në të folmen e Denisovit. P.sh. ...Kurse unë... dreqi e di se sa... (duhej bërë Kurse unë...dreqi e di se sa...), ose në f.191 Jepu urdhër këtyre dreqërve, këtyre shejtanëve... (duhej bërë Jepu urdhër këtyre dreqërve, këtyre shejtanëve). Në f.173 ...u përgjigj hoholli... Është lënë pa u përkthyer fjala ruse «холол» që do të thotë “ukrainas” dhe jepet kjo fjalë vetem me shkronja shqipe. E njëjta gjë ndodh edhe në f.176 ku fjala «Грачик» që do të thotë “Mëllenjëzë” (Kështu i drejtohej kalit kalorësi i tij, nga грач=mëllenjë), në vend që të përkthehet, jepet vetëm me shkronja shqipe “Graçik”. Në f.207...Si e lexoi shkresën...Jo, nuk ishte shkresë, por telegram (депеша=телеграмма). Në f. 338...për një inspektim e për të studiuar dislokimin e trupave... Jo, është për të kontrolluar zbatimin e udhëzimit (поверять диспозицию). Udhëzimi ishte një urdhër me shkrim, në të cilin jepeshin imtësisht të gjitha lëvizjet e pjesëve të veçanta të ushtrisë në faza të ndryshme të sulmit. Fjala udhëzim (диспозиция) është përdorur me ironi në tekst, për të treguar pedantizmin e gjeneralëve gjermanë. Kjo fjalë është përkthyer në roman në mënyrë të pasaktë herë plan dhe herë udhëzime në shumës, kur është thjesht “udhëzim”. Në f.213...një nga ato “xhevahiret”...Jo, s’janë xhevahire, por është un mot (në frëngjisht=një fjalë) në kuptimin e një thënieje të spikatur që diplomati Bilibin e thoshte me zgjuarsinë e tij në një moment të caktuar; gjejmë disa raste kur ai e thotë këtë un mot (një fjalë), e cila pastaj përhapej e përdorej në të gjitha sallonet dhe në zyrat qeveritare. Pra ishte diçka karakteristike e këtij personazhi dhe s’kemi të bëjmë këtu me “xhevahire”, por me një thënie të mençur, të goditur e me vend. Pikërisht kjo un mot është bukuria e Bilibinit. Në f.5 përkthehet “suarenë” në vend të “mbrëmjen”, por po kjo fjalë e frëngjishtes “la soirée” në f.6 përkthehet si duhet “mbrëmjen”, kurse në f.12 e gjejmë edhe “suaretë”. Po kështu fjala e frëngjishtes “livrée” lihet në f. 5 siç është me shkronja shqipe “livre”, në vend që të përkthehej “uniforma”, siç edhe është përkthyer për bukuri në f.15. Në f.8 gjejmë “dy njerëz shumë të shquar”, kur është “interesantë” (интересные). Në f.10 gjejmë “asaj i erdhi keq për ju”. Mirëpo nuk është se vetëm



perandoreshës i erdhi keq për princin Vasilij, sepse keq u erdhi edhe të tjerëve që ishin të pranishëm dhe po bisedonin me perandoreshën, pra duhej “u erdhi keq për ju” (жалуют вас). Në f.10 gjejmë “që heq të zitë e ullirit nga i ati”; është fjala për princeshën Marja dhe babanë e saj, por si shumë rëndë tingëllojnë këto fjalë, sepse në fund të fundit babai, në thellësi të shpirtit, e donte të bijën dhe s’mund ta kuptonte jetën pa të. Në tekst është «очень несчастлива с отцом» (ishte shumë fatkeqe me babanë), po jo deri në atë shkallë, sa të thuhet “hiqte të zitë e ullirit nga i ati”. Në f.13 gjejmë “me çantën e punës në dorë”, por ç’punë? Se mos punonte princesha e vogël Bollkonskaja dhe shkonte në punë me atë çantë. Ajo ishte një çantë e vogël e punimit (qëndisjes) në dorë (с рабочей сумочкой на руке). Princesha e vogël Bollkonskaja e thotë vetë në frëngjisht “J’ai apporté mon auvrage”, pra “unë kam sjellë punimin tim”. Sa mirë në f.20, po për këtë, thuhet “duke ngulur gjilpërën në qëndismë”. Në f. 19 gjejmë “ishte ndodhur kështu në mëshirën e armikut”; çarmik, ku ka armik këtu? Në tekst thuhet thjesht «находился во власти герцога» (ishte në dorë të dukës). Në f.20 thuhet “për ekuilibrin evropian”, por është “politik” (политический). Në f.21 gjejmë “si ju bën zemra të largoheni nga nusja juaj e mrekullueshme?” Jo, atje është thënë “Si s’ju vret ndërgjegjja që do të na lini pa shoqërinë e gruas suaj magjiplotë?” (Как вам не грех лишать нас вашей прелестной жены?) Në f.23 ...s’ju kam përmendur “dashurinë”, jo, është “miqësinë” (дружбу). Në f. 23 “si të gdhendura në mermer”, jo, është “si të statujave antike” (на античных плечах). Në f.24 ...Ky mendim i fundit e kënaqi. Jo “e kënaqi”, por e bëri atë “të lëkundet” (поколебало его). Në f.24.. të gjitha zonjat, jo, është “bejlereshat” (барыни). Në f.27...vrasjes së pabesë...Jo, nuk ka “së pabesë”, por është thjesht “pas vrasjes” (после убийства). Në f.32 лакей është shërbëtori dhe jo kamerieri. Sa mirë në f.33 po kjo fjalë përkthehet shërbëtori. Në f.34 E njëjta folje фыркнул një herë jepet “turfulloi”, një herë “ia krisi gazit”, kur është thjesht “turfulloi”. Në f.37 ...të zemëruar, jo, është llomotitës (ворчливый). Në f.40 ...është një grua që s’e ka shoqen; në ç’kuptim s’e ka shoqen? Është e keqe apo është e mirë? Jo, këtu është thjesht «прекрасная женщина», pra “një grua shumë e bukur”. Në f.46 fjala “imperiale” shpjegohet duke thënë “Monedhë me fytyrën e perandorit”, kur është “një monedhë ari ruse me vlerë sa dhjetë rubla”. Në f.49 gjejmë “fëmijët e shumtë që kishte bërë, gjithsej dymbëdhjetë”. Nuk ishte kështu, sepse kontesha Rostova nuk kishte lindur dymbëdhjetë fëmijë, por në shtëpi kishte gjithsej dymbëdhjetë fëmijë, për të cilët kujdesej, sepse fëmijë të vetët ishin vetëm katër: Vera, Natasha, Nikollaji dhe Petja. Të tjerët ishin kushërinj të tyre, por që jetonin bashkë me ta. Në f.50 Apo s’është llafazane... Jo, është fodulle, tepër kryelartë (чопорна). Në f.65 ...aspirant...Jo, duhej lënë junker që do të thotë “nxënës në shkollën ushtarake në Rusinë cariste, që përgatitej për t’u bërë oficer. Në f.77...kamerieres... Në fakt është горничной (shërbëtoreshë për rregullimin e dhomave, por jo për në kuzhinë). Në f.82...kishte nisur nga qyfyret; s’ka këtu “nga qyfyret”. Këtu thuhet vetëm se “po bënte një bisedë” (ведёт разговор). Në f.111...po e ngrinin të sëmurin. Jo “të sëmurin”, por “atë që ishte në grahamat e vdekjes (умирающего). Në f.154...As edhe fusha e ushtrimeve... Ç’do këtu fusha e ushtrimeve? Në tekst është «на Царицыном Лугу» që ishte “Sheshi i Perandoreshës”, sheshi i madh i Petërburgut, ku zhvilloheshin paradat ushtarake dhe kalimi i trupave në revistë. Nga viti 1818 e në vijim u quajt Sheshi i Marsit. Në f.158...dyqind e shtatëdhjetë... Jo, është e shtatëmbëdhjetë (семнадцать). Në f.172...vetëm një rrugaçi mund t’i lejohet të sillet ashtu...Jo, s’është “rrugaç”, por “kalamajve” (мальчишкам) dhe është me kursive. Në f.173...Më 11 tetor... Jo, është më 8 tetor (8-го октября). Në f.174... një dhelpër plakë...Jo, është “batakçi” (плут). Në f.186...i gostiste oficerët me ëmbëlsira... Jo, janë “byreçka” (пирожками nga пирог), se ishin në luftë dhe s’bëhej fjalë për ëmbëlsira. Në f.214...i njëqindfishohej...Jo, është “i dhjetëfishuar” (удесятерённой). Në f.223...mbi tëmthin e djathtë... Jo, është e majtë (левый). Në f.257 “Jemi të rrethuar!” Jo, është «Отрезали!» që do të thotë “Na prenë!”. Në f.267 ...e nga darka...Jo, është “dreka” (обеда). Në f.284... kishte marrë e kishte lexuar dekretin e famshëm të perandor Aleksander Pavloviçit...Jo, nuk është “dekret”, por reskript (рескрипт=letër e monarkut drejtuar nënshtetasit, zakonisht një personi me post të lartë), në të cilën ai shpreh falënderime. Dhe këtu në fakt letra e carit i drejtohet gjeneralit Sergej Kuzmiç. Në f.292...Dhashë urdhër ta pastronin rrugën...Jo, s’është “rrugën”, por “preshpektin”. Është vënë qëllimisht kështu nga Tolstoi, sepse kemi të bëjmë me një shtrembërim popullor të fjalës “prospekt”, që është një rrugë e gjerë, një shëtitore. Në f.294...shkruhet gabimisht “Lisia Gori”; në fakt është “Llisie gori” (Лысье Горы), që do të thotë “Male të zhveshura” e që ishte çifligu i princit Bollkonskij në roman, por që kishte shumë karakteristika të njëjta me çifligun “Jasnaja Poljana”, ku u lind dhe kaloi gati 60 vjet të jetës së tij Lev Tolstoi. Në f.323...Ja kishte hipur një kali të Fonit... Në fakt është të “Donit”, pra lumi Don dhe krahinat rreth tij. Në

f.325...Ti e di që lartësia e tij...Cili “lartësia e tij”, se këtu është Trashëgimtari i Fronit (në Rusinë cariste), pra цесаревич. Sa mirë në f.328 po kjo fjalë «цесаревич» përkthehet si duhet “trashëgimtarit të fronit”. Në f.340 fjalën Hofkrigsrat Tolstoi e ka lënë kudo të shkruar si në original, prandaj edhe në përkthim duhej lënë kështu. Kjo është zbatuar vetëm në këtë faqe,sepse kudo jepet e përkthyer, pra “Këshilli i Lartë i Luftës”. Duhej lënë Hofkrigsrat, siç e ka autori dhe diku në fund të faqes të jepej shpjegimi. Në f.384...ishin luanët tanë të Gardës...Jo, është ulanët (уланы) tanë të Gardës. Ulanët ishin kalorës të veçantë të ushtrisë cariste.

Gabimet në shkrimin e fjalëve në frëngjisht dhe gjermanisht

(do të jepet forma e pasaktë që është në përkthimin e romanit, dhe në kllapa e sakta): f.6 commencent a devenir (à); f.7 dépeche (dépêche); f.7 brûlés (brûlé); f.8 parait (paraît); f.11 apprenfissage (apprentissage); f.14,118,125,128,222, etre ose être (être); f.16 ma tante-s (ma tante); f.25 erauçant (exauçant); mi la dona (me la dona; kjo është në italisht); f.30 regale (régale); f.32 arreté (arrêté); f.40 Je suis aimable (Je suis très aimable); et très castique (caustique); f. 71 de son âme (âme); f.73 traitre (traître); f.83 Vous êtes (êtes); lacomtesse (La comtesse); f.101 Un batard (batârd); f.118 pas fjalëve “voilà à la tête” jane harruar fjalët “d’une immense fortune, je l’espère. Le testament n’a pas été; po në këtë faqe avant hier (avant-hier); f.123 de lien (des liens); f.124 empereur à quitté (a); connaitre (connaître); héritage (héritage); f.127 ne puis les approuver (“les” është e tepërt, s’duhet); ne lès condamne pas (les); pere (père); la parole du notre (de); n’au-ra-t-il pas (n’aura-t-il pas); f.128 grâces (grâces); parait (paraît); être (être); tâcherai (tâcherai); Taut-Puissant (Tout); Ce sera une joie (joie); f.129 expédiées (expédiés); f.131 Ivànoviç (Ivanoff); f.132 grâce (grâce); f.137 Malbroug (Malbrough); f.141 Mille (Mademoiselle); f.142 peut-être (être); f.148 defir (défier); f.167 schalgen (schlagen); wen (wenn); Communikations (Kommunikations); und (um); Allirte (Allierte); Ansicht (Absicht); Veise (Weise); kaiserlich (Kaiserlich); ausgerustet (ausgerüstet); muthig (mutig); f.211 le charme (“le” nuk është); f.212 Durenstein (Dürenstein); f.215 le compagne (la); f.216 Majeste (Majesté); nonintervention (non-intervention); dépêche (dépêche); f.219 nochëeiter (noch weiter); Bösewichtschon (Bösewicht ist schon); f.221 çelui (celui); arrets (arrêts); lacheté (lâcheté); f.222 héroisme (héroïsme); f.224 méme (même); f.232 necontentement (mécontentement); sur le champ (sur-le-champ); quai à signé (qui a signé); d’truissez (détruisez); Lâide de camp (Lâide-de-camp); f.264 Guntersdorg (Guntersdorf); f.277 Hèlène (Hélène); Pètersbourg (Petersbourg); f.299 ausquelles (auxquelles); égal (égal); f.309 main a baiser (main à baiser); f.314 tâcherai (tâcherai); f.317 pouche (mouche); f.355 Flugel (Flügel); langs (längs); Gegenthell (Gegenteil); sechr (sehr); debordiner (debordieren); vortheilhaft (vorteilhaft); diesen (letzteren); forfer (Dörfer); Flanke (Flanke); Shlapanitz (Schlapanitz); Turassa (Thuerassa); konnen (können); ausëeichen (ausweichen); nothig (nötig); marschirt (marschiert); f.357 géographi (géographi); f.396 epuisées (épuisées); reserve (réserve); Voila (Voilà); f.400 rechappera (réchappera).



Mosrespektimi i paragrafëve. Nuk janë kryeradhë, por vazhdim paragrafi:

F.9...Në çastin kur...; F.11...Princi Vasilij...; F.16...Ana Pavlovna dukej sikur...; F.20...Ishte princ Andrea Bollkonski...; F.22...Deshi të shtonte diçka...; F.26...Princi Ipolit, që e kishte parë...; F.28...Viskonti ngriti supet...; ...Por Pjeri, pa u përgjigjur...; F.33...Ngaqë s’i vinte ndore...; F.41...Për Pjerin Andrea ishte...; F.43...Po menjëherë i ra ndër mend...; F.61...Borisi i shkonte prapa...; ...E kapi për mënge...; F.62...Kontesha i shtrëngoi...; F.63...Po, duke kaluar...; ...Dhe ia mori...; F.75...Pjeri kishte frikë...; F.78...Dhe, me shaminë e saj...; ...Më sill...; F.80...Tjetri, një oficer i Gardës...; F.84...Në një krye të tryezës...; F.85...Konti, që prapa...; ...Nga ana e grave...; F.88...Sonja u drodh...; ...Pjeri dëgjonte...; F.89...Maria Dmitrevna iu kërcënua...; F.95...Të dy valltarët...; F.98...Një këlysh zuri të lehte...; F.108...Dhe e humbi...; F.111...Pjeri e mori me mend...; F.116...Po Ana Mihaillovna...; F.118...Si foli me Pjerin...; F.119...Kryegjenerali, princ Nikolla...; F.121...Nga lëvizja e këmbës...; F.133...Vous ne nous attendiez...; F.139...Uluni, uluni...; F.149...Plaku palosi letrën...; F.154...Megjithëse adjutantit...; F.163...Kjo këngë ishte...; F.167...Dhe Kutuzovi, me një nënqeshje ironike...; F.169...Por tamam në këtë çast...; F.174...Schön gut Morgen...; F.181...Me shpejtësinë e një shkëndije elektrike...; F.182...Ja hodhi kuletën...; F.191...Pse shtyn? Dreq!...; ...S’është koha për të pritur tani...; F.220...Me të marrë vesh...; F.235...Në heshtje e buzën...; F.241...I paraqiteshin vetëm dy hipoteza...; F.254...Trupat e krahut të majtë...; F.255... “Jo, unë jam plagosur...; F.256... “Hë, ja ku po vijnë”...; F.270...Princ Andrea doli pas kapitenit...; F.278...Ndërsa biseda zvarritej...; F.281...Po, ndërsa i shprehte...; F.283...Shpeshherë i kishte qëlluar...; F.285...Çfarëdoqë thoshin të ftuarit e tjerë...; F.288...Por, megjithëqë Allpatiçi...; F.294...Princesha vogëloshe...; F.296...Rreth e rrotull princ Vasilit...; F.297...Princeshë Maria ndihej e fyer...; F.302...Pric Vasili iu përgjigj me gjithë qejf...; F.321...Kontesha po qante...; F.324...Borisi, gjatë gjithë udhës...; ...Borisi u ngrit të takohet...; ...Me atë ndjenjën e veçantë...; F.332...Të tria pjesët e kësaj ushtrie...; F.333...Përmes këtyre tingujve...; F.361...Më nga e djathta, zotëri...; F.364...Ejani pas meje...; F.369...Ja se ç’urdhra të çmendura...; F.390...Pastaj, si e ktheu kalin.

Nuk janë vazhdim paragrafi, por kryeradhë:

F.9 Princi u përkul...; F.13 – Shikoni, Annete...; F.20 Ana Pavlovna nuk e lëshoi më...; F.43 Megjithëkëtë, pas një çike...; F.46 – Vë bast...; F.48 Dhe, duke thënë kështu, rroku ariun...; F.60 “Le të më kërkojë”...; Natasha, pa lëvizur nga vendi...; F.63 Të prehej shpirti e të kënaqej syri...; F.64 Ti s’kupton nga këto gjëra...; F.69 Princ Vasili e vështroi...; F.83 “Les Razoumovsky... (dhe është pa thonjëza); F.88 Fytyra e saj u bë flakë...; F.89 Sonja dhe Petja topolaku...; F.90 Vështroi rreth e rrotull...; -Hyri me vrap në dhomën e Sonjës...; F.91 – Dhe ia dha prapë...; - Ti je e lumtur...; F.93 Ndërsa çiftet po zinin vend...; F.102 E largoi nga gjunjët konen...; Kjo qenka mirënjohja e tij për njerëzit...; F.116 Princesha e lëshoi portofolin...; F.121 Mori radhuan e gjeometrisë...; F.125 Je vous avoue que je comprends très peu...; F.134 Edhe Liza psherëtiu...; F.145 – I vëllai tundi kokën...; - Veç për një gjë më vjen keq...; F.146 Bëri kryq, puthi figurëzën e shenjtë...; - Unë nuk të kam thënë asgjë, ama ty...; F.147 Princ Andrea e vështroi rreptë...; F.149 – Hodhi firmën dhe përnjëherësh...; - Keq puna, hë? F.150 Plaku heshti...; - Desha t’ju lutesha edhe për një gjë...; F.151 Princ Andrea tërhoqi me kujdes...; F.154 Kur dëgjoji këto fjalë...; F.161 Dollohoi i hodhi një vështrim...; F.171 Nesvicki, duke ia plasur gazit...; F.176 Togerri nuk e vështronte kurrë në sy...; Ia kishit hipur sot...; F.181- Rostovi s’hapte gojë...; - Po ju? Edhe ju...; F.189 Prapa tij vinin ca ushtarë...; f.192 – Ç’është ky kiamet kështu? F.200 – Dhe tregonte me gisht...; F.205 “Pardje, në Danub” (duhet pa thonjëza)...; F. 211 – Ia mbërtheu sytë princ Andreas...; F.216 Attendez, je nài pas fini...; F.226 Më të hyrë në fshat...; U kthye të shikonte...; F.228 Princ Andrea i bëri Kozllovskit pyetje...; F.231 Si bëri gjatë një nate të stuhishme...; F.234 Bagrationi, që e dinte se Bollkonski...; F.235 – Si s’keni turp, kapiten Tushin? – vazhdoi koloneli...; Princ Andrea e vështroi edhe një herë...; F.239 – Dhe, duke sharë rusisht rëndë...; F.255 “Ah, sikur të më bjerë...; F.265 “Ç’thua ashtu?...; F.266 Tushini urdhëroi...; F.275 Nesër nisemi, po të bëj vend...; F.277 – Ma bonne Hélène...; F.295 Të dy mysafirëve u qenë caktuar dhomat...; F.306 Anatoli, me buzë në gaz...; F.307 “La pauvre fille!...; F.313 Po ose jo, po ose jo...; F.317 – Ana Mihaillovna tundi kokën...; F.330 – Dhe, si hodhi sytë përqark...; F.343 Ja, të tillë njerëz, - tha Bollkonski...; F.344 Njëri prej tyre po hiqte për freri...; F.365 Po Rostovi nuk iu përgjigj. F. 379 – Por në këtë kohë gjithçka u mbulua me tym...;

Emrat e personazheve duheshin lënë siç janë në original

(Vijon në faqen 23)

GJAK URITHI

Në dyqanin tim vijnë pak klientë – hyjnë, sodisin kafazet apo qelqet me kafshë dhe, në më të shumtën e herës, dalin pa blerë gjë. Lokali është i ngushtë, nuk ke nga të vërtitesh, sidomos po të jesh i bëshëm, dhe sytë nuk të kapin gjë tjetër veçse zhaba, hardhuca e krimba, që shtriqen e shtrihen, e zgjaten e mblidhen, a thua se të ftojnë t'u avitesh. Vjen ndonjë mësues për complete kafshësh eksperimentale për orët e zoologjisë në shkollë, vjen edhe ndonjë peshkatar, që rrëmon nëpër kutija për karremë të mirë. Do ta mbyll dyqanin; nuk më leverdis, dal me humbje. Mirëpo, prapë, më prishet mendja; se jam mësuar me këtë dhomëzë të marrë, me terrin e saj e me erën e formalinës. Do të më vinte keq për hardhucat më shumë, i kanë sytë sa një kokërr thjerrëze. Nuk e di se çfarë bëjnë me këto krijesa frikëse, por besoj se, pas demonstrimit në orën e mësimit, i lenë të marrin frymë, nuk i vrasin.

Një ditë më hyri në dyqan një grua. Trupvogël, e mbledhur shuk si një toph dëbore në pranverë. M'u avit fare pranë. Në errësirën e dyqanit, duart e bardhëreme i feksën si të ishin peshq të ngordhur. Nuk më vështroi në sy, as gojë nuk hapi, vetëm se zuri vend dhe mbështeti bërrylët te banaku. Nuk ka për të blerë gjë, thashë me vete, do jetë kthyer nga rruga sa për të pushuar një grimë herë. Në çast iu morën këmbët së shkretës, aq pa fuqi ishte, dhe do të ishte rrëzuar po të mos e kisha zënë për krah. Nuk fliste fare. Dukej se nuk qe si blerësit e mij të zakonshëm.

- A keni urithë, - hapi gojën befas e panjohura. Sytë i morën një shkëlqim si të një rrjete të vjetër merimange, kur ka merimangëzën e vockël në mes.

- Urithë, the? - brofa në vend. Duhet t'i thoja se nuk kisha shitur urithë kurrë, madje nuk kisha parë urithë me sy. Por ajo grua priste fjalë të tjera nga unë – vështrimin e kishte të ndezur, duart – të shtrira drejt meje. Ç't'i bëja, nuk e ndihmoja dot, e dija si buka që ha.

- Nuk kam, - i thashë.

Ajo psherëtiu, e pastaj befas u kthye e bëri për nga dera pa nxjerrë gjysëm fjale. Ishte rrëgjuar, e mbledhur grusht, a thua se mundohej më kot të mbyste zhgënjimin, duke hedhur hapat me kujdes e pa u ndjerë.

- Pa dale! - i thirra. - Prit, më duket se kam. Urithë, the, apo jo? - As vetë nuk e mora vesh përse i nxora ato fjalë.

U ndal në vend. Më vështroi në sy.

- Gjaku i urithit është ilaç, - mërmëriti. - Tri pika dhe të shëron.

Më sëmboi në zemër. Më hipi një valë frike. Pastaj ankthi. Gruas para meje vështrimi i humbi në zgavrat e thella të syve të nemitur.

- Të paktën, ta ndalte dhimbjen për ca kohë... - mezi munda të thotë me zë të mekur, që erdh e u shua pa vijuar më tej.

- Qenkeni e sëmure kështu? - e pyeta, pa vrarë mendjen se mos e ligështoja.

- Jo unë. Im bir. - Qepallat iu drodhën. Duart karrthi i shkuli nga banaku. Desha ta qetësoj, t'i jepja diçka - të paktën një gotë ujë. E uli kryet me sytë ngulur përdhë, e me ato shpatulla imcake nën pallton gri të mbyllur, që i rrinte kabá.

- A doni pak ujë? - Nuk m'u përgjigj. Por, kur mori gotën dhe piu, qerpikët e zinj përreth syve iu dridhëruan edhe më shumë. - S'ka gjë, s'ka gjë, - mërmërita, duke mos ditur ç'të thosha tjetër. Ajo u kthye dhe bëri prapë nga dera, ashtu e gërmuqur e me sytë përdhë.

- Dale, - i thirra. - Prit të të jap gjak urithi. Gruaja u ndal. Zuri ballin me dorë dhe ashtu ngriu.

Menjëherë m'u dha të kthehesha e të sulesha vrik në aneksin që e mbaja si depo. Nuk e vrava mendjen fare për atë, që po bëja. Nuk më interesonte fare se po e gënjeja. Aty,

ZDRAVKA
EFTIMOVA

Dy tregime

Përktheu Abdurrahim Myftiu



në aneksin e errët, dikush po më vështronte – ishin hardhucat. Nga t'i merrja pikat e gjakut? Urithë nuk kisha. Kurse gruaja më priste jashtë. Ndoshta akoma e mbante dorën te balli e nuk shihte gjë. Përplasa deriçkën, që të mos më shihte fare. Mora një brisk të vogël, që e mbaja përhera në sirtarin me lapsa e letra, dhe preva pakëz dorën. Nga plaga nisi të rrjedhë gjak. Dhimbje nuk ndjeja, se pak e kisha prerë, por nuk kisha zemër ta shihja si rridhte në shishen e vogël. U mblodh ca, dy glënjka ndocá, mu në fund të shishes. Mjaftonte. Dola nga aneksi dhe drejt e te gruaja.

-Urdhëro, - i thashë. - Gjak i pastër urithi!

Ajo nuk bëri zë, por m'ia nguli sytë dorës, nga ku ende binin pika gjaku. Mblodha krahët prapa shpinës. Gruaja më hetonte pa bërë zë. Shishen e vockël nuk e zu me dorë. U kthye për të dalë. Pa vajtur te dera e zura për krah dhe ia ngjesha flakonin në pëllëmbë.

- E ke gjak urithi! Gjak të pastër urithi!

E mori si me përtesë. Brenda vezullonte gjaku si me qenë zjarr i një prushi të fundit. Pas pak, hapi çantën e grisur e të dalë boje qëkuri, dhe nxori paratë.

- Jo, nuk i marr, - i thashë.

Nuk i ngriti sytë fare, hodhi paratë në banak dhe bëri për nga dera. Desha ta përcjell, ose të paktën t'i jepja prapë pak ujë, para se të largohej. Por e ndjeva se nuk

i duhesha më e se për askënd nuk kishte nevojë. Mbete vetëm me dyqankën time. Nga kafazet më vështronin kafshëzat e mija. Si përhera. Si përhera.

Vjeshta po e mbulonte pa prâ parkun me ditët e saj të mjegullta, të gjitha binjake me njëra-tjetrën, e të gjitha me gjethe e verdhëreme të drurëve, që nuk i hynin në punë kërkujt. Po vinte ora e mbylljes së dyqanit. Ajo grua mund të kthehej tek unë nga çasti në çast. E kisha bërë mendjen top, nuk do t'i thosha gjysëm fjale. I biri zor se do të gjente shërim me gjak urithi, e megjithatë unë e kisha gënjer. Jashtë bënte ftohtë. Para vetrinës së dyqanit njerëzit kalonin me nxitim, vetëm çunat e vegjël ndaleshin për të soditur kafshëzat në formalinë. Në këtë acar nuk bëhej fjalë për blerës.

Një mëngjes dera m'u hap me tërsëllëmë. Kush hyri, do të thoni ju. Ajo, gruaja trupvogël. M'u sul e tëra. Desha të fshiheja në koridorin e errët aty pranë, por nuk munda, më zuri. Më hodhi krahët e më përqafoi. Ishte skelet e dobët dhe e lehtë. Qante me dënesë. E mbajta për të mos rënë, aq e pafuqishme më dukej. Befas, ma ngriti dorën e majtë. Plaga më qe tharë krejt, por vendin ia gjeti. I ngjiti buzët mu aty, ndërsa lotët i rrodhën dhe ma njomën dorën krejt, madje edhe përparësen e punës.

- Është ngritur më këmbë, më këmbë, më këmbë, - dha ngashërimin e fundit,

fshiu lotët me dorë dhe, në fund, u mundua të verë buzën në gaz.

Donte të më jepte pará. I kishte në një çantë të madhe të kafenjtë. Më mbante për dore, qante me lot e nuk donte të ikte. E ndjeva se e kishte mbledhur veten, ishte bërë më e fortë dhe nuk dridhej më. E përcolla me sy, edhe pse qëndroi ca te kthesa, e vockël siç ish, por me buzë në gaz edhe në atë të ftohtë. Pastaj më humbi sysh. U ktheva në dyqankë, dhe atbotë ajo m'u duk më e bukur. Kurse era bajate dhe e marrë e formalinës m'u bë më e këndshme dhe e ëmbël. Kafshëzat m'u bënë të gjitha të bukura e të shtrënja si fëmijë.

Po atë pasdreke, para banakut të dhomës së errët, erdhi një tjetër. Burrë i gjatë, i merakosur, i trembur.

- A keni gjak urithi? - më pyeti, pa m'i hequr sytë. Me një vështrim, që më trembi.

- Nuk kemi. Urithë nuk kemi shitur kurrë.

- Keni, keni! Si nuk keni! Do më vdesë gruaja. Tri pika, vetëm tri! - më kapi dorën e majtë, ma ngriti me forcë e ma spërdrodhi.

- Tri pika! Aman, përndryshe më iku!

Gjaku mezi më doli nga e prera me brisk. Burri mbante shishen e vogël, ndërsa pikat binin në fund si milingona. Pastaj doli, duke më lënë një tufë kartëmonedhash në banak.

Të nesërmen në mëngjes, para derës së dyqankës më priste një turmë e madhe. Njerëz me brisqe të vegjël e shishe flakoni të lara në duar.

- Gjak urithi! Gjak urithi! - thërrisnin, vikatin, shtyheshin. Të gjithë me vuajtje në shtëpi e me brisk në dorë.

KORRIKU

A të kujtohet Hverleni, kodrina e lashtë pranë Pernikut, e cila nga larg dukej si vapor? Dimrit aty sajoheshin rrëshqita të hatashme, verës shpateve të saj nuk gjallonte kurrfarë bime tjetër, nuk kishte as hithra, as pemë. As lule nuk kishte. Hidhte bojë e harlisej vetëm lëpjeta, lëpjeta e livadheve.

Një herë në korrik ti më shpure në Hverlen. Asokohe nuk e njihja lëpjetën e livadheve dhe bëra disa hapa për ta gjetur, por ti më ndale e më the: hap sytë, te këmbët e tua e ke, e ke gjithandej. Provoje dhe do më besosh. Ashtu ishte, kurrë nuk pata parë një mreullit të tillë. Ti këpute do kërcëj për mua – mishtake me fllad e vapë bashkë, mishtake – dhe me ty brenda ato fletë lëpjete livadhi të athëta. Kodrina u bë e jona, gjigande, e pafund, e hatashme: që nga rruga gërmuqe me autobuzët e vjetër drejt Pernikut e deri lart në re ndrinte lëpjeta. E sheh, më the. Nuk të gënjeva. Unë kurrë nuk gënjej dhe me mua nuk ke për të vuajtur urie.

Për çdo ditëlindje ti më sillje një tufë lëpjete. I ke të Hverlenit, më thoshe. Ja tek i ke, merri. T'u bëfshin shëndet e jetë. Dhe unë i provoja. Edhe sikur të mos kisha ngrënë, edhe sikur pará për bukë të mos kisha – urie nuk vuaja. Më pas, larg asaj kodrine morëm udhët, larg atij korriku u shpërngulëm. Ai fllad, që ishte mësuar të na sillte habere të mira, se nga humbi e u bë fir diku. Miqt e mij, zhapikët, më harruan.

Ti hape një dyqan mallrash të përdorur, pastaj një dyqan lavatriçesh e televizorësh të përdorur, pastaj hape një restorant. Thonë se u bërë pasunar i madh, kurse unë zura të përkthej romane të sojit, ku gjithë kohën dikush tërhiqte këmbëzën e armës dhe vriste të ligjtë. Libra zbavitës – sa më shumë përkthen, aq më tepër i harron shkronjat e alfabetit, sepse në librat interesantë nuk ka shkronja, por plumba. Andaj digjem dëshire për të përkthyer ndonjë libër me lëpjetë livadhi, me zhapikë, mbi të cilët të ketë kaluar një fashë rrezesh dielli e aqë, sa për t'ia kënduar bijës sime. Dua që ajo të kërktojë e të gjejë një livadh kodrine, jo të mbushur plot e përplot me barishte, por të dendur tej e tej me qiell e me korrik.

Pastaj, më thanë, dasma jote kishte qenë e mbytur në salltanete. Për të paskëshin shkruar në gazetën lokale. Paskëshin shkruar edhe për bashkëshorten tënde – qenëka magjia vetë, nur i bukurisë, si askush tjetër në qytet. Aq i pasur u bëre, sa që bleve kodrinën. Krejt Hvërlenin. E rrethove me mur dhe askush tashmë nuk mund t’i afrohet. Me siguri edhe vetë stinën e verës e ke rrethuar me mur dhe e ke paguar të qëndrojnë gjithë vitin në oborrin tënd.

Tashmë nuk marr autobuzin për në Pernik, sepse ai përsëri kalon nëpër xhadenë e vjetër bashkë me biçikletat shkatarrake. Nganjëherë më vete mendja se mos në restorantin tënd shet nga ato gjërat e shijshme, që bëja për ty në korrik. Unë jam mirë, i kam pak a shumë të gjitha, fëmijët po më rriten. Më të rrallë bëj supë me lëpjetë – pa pikë lëng mishi, në shtëpi rrudhin buzët, por unë kështu i pres ditëlindjet e mija – me asgjë tjetër, pa bërçolla, pa gatesa të shtrenjta, vetëm me lëpjetë sade. Këtë u jap fëmijëve. Ata nuk e dinjë pse bëj kështu.

Ajo kështu e ka, ka lajthitur pakëz, thonë për mua, por e dinjë se vetëm miqtë për kokë, pa të cilët e ndjej veten keq, provojnë gatesat e mija fshatarake. Në të është qielli fund e majë, është dielli, është kodrina, e cila zë fill në korrik dhe përfundon në zemrën time. Në të harliset lëpjeta. Nuk mund ta rrethosh me mur për kurrfarë restoranti. Në të kalamajtë luajnë me top pesëqind ditë në vit, por bash për këtë arsye lëpjeta bëhet edhe më e fortë, edhe më e harlisur.

Unë kam gjithçka tani. Dhomë të ngrohtë, frigorifer. Por në ditëlindjen e fundit nuk e bëra çorbëzën e zakonshme. Nuk kisha me se. Megjithatë gjeta një copë letër, copë gazete, në të cilën dikush kishte shkarravitur fjalën LËPJETË. Kishte mbetur në tryezën e kuzhinës, pranë bukës. Marrëzi është, por e di se ti i ke qejf marrëzitë, më tha im shoq. Hajde pijmë nga një birrë, pa qeni qepën të hajë. Edhe pse më e rëndësishmja është sa pará ka mbledhur njeriu, më mirë është të ketë lëpjetë në shtëpi.

Mund të shkosh t’i kërkosh pará Mlladénit, më tha im shoq. Gjashtë pranvera dhe dimra kishin kaluar qysh atëhere, por mbaj mend se nuk më kishte vështruar aq me ngulm sa tani, që po thoshte këto fjalë për paratë. Goxha restorant të madh ka Mlladéni. Ka edhe gjithë ato dyqane, për rroba të përdorura, për lavatriçe e televizorë të përdorur. Mund t’i kërkosh pará, nuk kemi nga t’i gjejmë. Për djalin është puna. Duhet të paguajmë për operacionin. Hajde, de, mos u tremb. Djali do të bëhet mirë, por duhet paguar, kurse për Mlladénin, a nuk thua se e ke patur shok?

Dal nga shtëpia dhe marr mengadalë shtegun drejt atij muri, prapa të cilit është ngujuar vera. Tashmë nuk duket gjëkundi tokë, as drurë nuk duken. Larg nga rruga, majë kodrinës ngrenë kryet do kulla të një vile. Më vjen të kthehem mbrapsht, por nuk kthehem. I them njeriut, që më del në citofon: “Jo, nuk kam lënë orë takimi me zotin Mlladénov. Kam qenë shoqe klase me të, dikur kemi qenë miq të ngushtë.” “A e dini sa veta thonë se dikur kanë qenë miq të ngushtë me të? Për çfarë pune e doni?” “Për një çështje personale.” “A e dini sa veta në ditë vijnë për të folur për çështje personale me të? Po ju them qysh përpara, ai nuk pranon të bëjë sponsorizime.”

Unë me zor po qëndroj më këmbë, po më merret fryma. E kotë të shpjegohem me bëlbëzimet e mija për t’i thënë përse më duhen paratë, por më në fund arrij ta ngrej zërin: “I thoni zotit Mlladénov se kërkon ta takojë shoqja e tij e klasës Maria, Maria Georgíeva. “Më jepni numrin e telefonit dhe nëse zoti Mlladénov vendos, do t’ju kërkojë vetë.”

Zoti Mlladénov nuk më kërkoi. Shitëm apartamentin, makinën dhe kompjuterin. Përktheva aq shumë vrasje në bullgarisht, sa që gjuha jonë tani e tutje nuk ka për të qenë

si më parë. Pas çdo fjale do të jetë e fshehur një kufomë, pas çdo shkronje të alfabetit tonë do të ketë një pus gjaku nga përkthimet e mija. Mësova përmendësh fjalorët. Më vjen turp që di që shumë fjalë në anglisht se në bullgarisht. Nuk më zë gjumi i natës veçse kur, në kokën time, të jenë rreshtuar varg e vistër në errësirë sinonimet e anglishtes – sakatoj, prish, shqyej, masakroj, shfaros...

Djali është bërë mirë. Kur nuk jam në terezí nga mërzhitja dhe para syve më dalin fjalí me foljen „vras“ më shumë se ç’hipin njerëz në tren, në mbrëmje në tryezën e kuzhinës gjej një copë gazete, në të cilën dikush ka shkruar me shkronja shtypi LËPJETË. Kaq më mjafton. Gjithçka bëhet e ngrohtë dhe e bukur. Brenda dhjetë minutash korriku ndrin në shtëpinë tonë. Dritë, hapësirë. „Masakroj“ dhe „Shfaros“ marrin arratinë. U rrëfej fëmijëve përralla me zhapikë e fllade. Në ato çaste e kuptoj në palcë se nuk jam njeri i mirë. Nuk e kam shpurë babanë e tyre në atë livadh kodrine, ku nuk ka barëra, ku zë fill korriku dhe pastaj përfundon në zemrën time, ku xhadeja për në Pernik arrin deri tek retë. Atje buit e harliset lëpjeta ime e livadhit. Mbi një copë gazete. Atje edhe gurët janë lëpjetë.

„E nderuara zonja Georgíeva, e dashur Maria! Po të shkruan shoku yt i klasës Mlladén Mlladénov. Do të ishte kënaqësi e madhe për mua sikur të takoheshim. Shumë po dëgjoj të flitet për ty si përkthyesë e mirë. Të lutem të pranosh t’i japësh mësim djalit tim në anglisht. Është djalë i zgjuar, por ka rënë në mësues koti. Jam gati të paguaj shumë, që do ta caktosh vetë. Pres me padurim të më marrësh në telefon. Misho.

P. S. E di se ke ardhur para disa vitesh tek unë. Edhe kam dashur të të marr në telefon, por gjithmonë nuk më mbetej kohë. Ti e di si janë këto punë. Shpresoj se do të kem mundësi ta laj këtë përshkujdesje timen. Po më kujtohet – më duket se të pëlqente lëpjeta. Urdhëro e hajde. Kur të vish, tryezën do ta gjesh të shtruar. Do të mbetesh e kënaqur nga puna tek unë. Të garantoj! I magjepsur prej teje, Misho.“

Nuk e grisa letrën, edhe pse për herë të parë po provoja kënaqësi nga të gjitha sinonimet e foljes “gris”, që dija. Ashtu siç ishte, e hodha në koshin e plehrave. Pranë pallateve ndodhej një lulishte e vogël me lule krokëlle të sapoçelur. Aqë shumë e aq të dendura qenë, sa që toka skuqej flakë nën to. Një djalë dhe një vajzë po vraponin anës krokëllave. Me siguri për ta bota zinte fill në tetor. Tetori im vjen në korrik. E çë, më mbetet të pres vetëm treqind e tridhjetë ditë deri në lëpjetën e re.

Zdravka Eftimova (l. 24. 09. 1959) është një nga shkrimtaret më të njohura bullgare brenda e jashtë vendit, autore e dhjetëra romaneve dhe përmbledhjeve me tregime, si dhe fituese e dhjetëra çmimeve letrare kombëtare e ndërkombëtare – i fundit, ai i vitit 2022, Çmimi „Mihaj Eminesku“ për prozën.

E diplomuar për filologji angleze, ka punuar si mësuese e anglishtes, më pas në 15 vjet si përkthyesë në Sofie e në Bruksel, kurse aktualisht jeton dhe shkruan në qytetin e lindjes – Pernik, në Bullgarinë jugperëndimore. Ka përkthyer romane e tregime në anglisht, frengjisht e gjermanisht. Është sekretare e PEN-klubit bullgar.

Romanet dhe tregimet e saj janë botuar në mbi 30 vende të botës. Tregimi „Gjak urithi“, rrëfim prekës për dhimbën njerëzore e për vlerën e dhembshurisë, mirësisë dhe shpresës, është botuar në po aq vende dhe ka fituar, ndër të tjera, çmimin e një konkursi të prozës së shkurtër në Liban, me konkurrentë 1632 autorë nga 56 shtete.

Në shqip „Gjak urithi“, i botuar në Bullgari më 1997, u përkthye e u botua në shqip më 1999, në revistën „Mehr Licht“, nga e cila po e ribotojmë. Në përkthimin anglisht „Blood“ („Gjaku“) është përfshirë në disa antologji në SHBA, si dhe në tekste mësimore – në SHBA në tekstin e kl.VIII, në Danimarkë në tekstin e anglishtes për gjimnazet. Më 2004, në Javën e Letërsisë Europiano-Lindore, BBC transmetoi dy tregime të saj, krahas prozave të Ismail Kadaresë.

Tregimi tjetër, „Korriku“, është i viteve të fundit. (Shën. i përkth.)



(Vijon nga faqja 21)

dhe jo të shqiptarizoheshin, se duhej të tingëllonin si në gjuhën e tyre. Kështu duhej princi Andrej (Андрей) dhe jo princ Andrea (se duket sikur është shqiptar ose grek), princesha Marja (Марья) dhe jo Maria, Nikollaj (Николай) dhe jo Nikolla, se është rus dhe jo shqiptar; princi Vasiliy (Василий) dhe jo Vasili, Olga (Ольга) dhe jo Ollga; është Ilja (Илья) dhe jo Ilia etj. Mirëpo, kur në tekst emrat vihen siç tingëllojnë në frëngjisht, duheshin lënë siç janë, se kështu ka dashur autori, pra André, Marie, Lise, m-lle Bourienne dhe jo zonjusha Buriena; është tjetër gjë kur autori e shkruan me shkronja ruse Бурьен, pra vetëm në këtë rast duhej dhënë Burjen. Në kapitullin VI të pjesës së tretë të këtij vëllimi të parë të romanit, kur familja Rostov merr një letër nga i biri Nikollaji, që ishte në luftë, gjejmë disa variante të emrit Nikollaj (Николай), të cilat duheshin lënë siç i ka autori. Gjejmë Nikollushka (Николушка), kurse në përkthim, në shumicën e rasteve, jepet thjesht Nikolla, kur duhej Nikollushka. Po kështu ndodh edhe me variantin Nikolenka (Николенька) që jepet Nikolla; Sonja, e cila ishte e dashuruar me Nikollajin, e thërriste atë me Nicolas, siç tingëllon ky emër në frëngjisht, dhe duhej lënë kështu dhe jo Nikolla, se vetëm Sonja e thërriste kështu; pra dallimi këtu nuk është kot. Pastaj ne e dimë që personazhi quhet Nikollaj Rostov, por s’kemi asnjë të drejtë ta përmendim atë me Rostov, kur autori e ka të shkruar me Nikollaj dhe, e kundërta, të shkruajmë Nikollaj, kur autori e ka me Rostov.

Parregullsitë në zbatimin e hapësirave ndërmjet rreshtave, vënia e thonjzave, kur s’i ka autori etj.

Jo gjithnjë është zbatuar momenti kur në vepër hasim hapësirë ndërmjet rreshtave, si në f.30, ku pas fjalëve “edhe së shoqes që të ngrihej” ka një hapësirë ndërmjet rreshtave, pra një a dy rreshta bosh, çka duhej zbaruar. Po kështu edhe në f.34 pas fjalëve “se do ta përcillte në shtëpi”; ose në f.93 pas fjalëve “zunë të lëviznin këmbët e të kolliteshin”, apo në f.98 pas fjalëve “dhe u largua”, po kështu edhe në f.393 pas fjalëve “prapë përsëritej po kjo shaka”. Mirëpo ndodh edhe e kundërta, pra lihet hapësirë ndërmjet rreshtave, kur kjo nuk është në origjinal: f.64 pas fjalëve “u bë më e ftohtë e më e qetë”; në f.295 pas fjalëve “u qenë caktuar dhoma të veçanta”. Sa mirë në f, 42 lihet hapësira ndërmjet rreshtave, ose në f.82 pas fjalëve Konti...hyri në sallon. Pastaj vihen thonjëza, kur në origjinal s’ka thonjëza: f.43 “Fundi i fundit...; f.44 “Eja këtu të ta shpjegoj bastin!”; f.50 “Shiko, Mitjenka, ki mendjen...; f.79 “Ende s’ka ardhur ajo”; f.80 “i fejuari”; f.92 “është fare e kollajshme”; f.104 “pikërisht kështu duhet të ishte”; f.136 “Të bardhin! Të bardhin!” Dhe, e kundërta, nuk vihen thonjëza, kur në origjinal ka thonjëza, si në f.202 – O Zot i madh! Ti që je atje lart në qiell...deri te... mbromë! Ka raste që fjalët në tekst janë me shkronja kursive, por nuk respektohet kjo, si në f.93 fjalët *me një të madh*; f.37...pa miqtë *e mi*; f.70...edhe një herë *xhaxhanë*; f.145...nuk mund ta nxirrte *atë gjë* nga çanta; f.147...as që do ta qortoj kurrë *time shoqe*; f.189...Sikur *ai* (*ai* = armiku); f. 199...Nga të *dyja* anët; f.215 *si të tyrin*; 244...se në frëngjisht titulli *princ...*; f.253... Unë *ju lutem, ju lutem*, - përsëriti ai, - të zini *pozicionin...*; f.256..*Mua*, që më duan aq shumë...; f.300...Përfytyronte një fëmijë *të saj*in...; f.303...po ju *nuk do të zini të më flisni* për politikë...; f.322...Çfarë *still*!; f.330...*Unë* atje isha...; f.336...*si djalli* ...; f.358...dhe vetë jeta *ime*.

Isha e fshehur, stoli e artë;
Më zbuloi rrezja e zjarrtë.
Kurani

Çdo premtim i shpirtit përmbushet në mënyra të panumërta. Natyra, e papërmbajtshme, rrjedh vrullshëm, largpamëse, në më të parën ndjenjë të mirësisë paralajmëron një mirëdashje që do të bëjë të humbasë të gjitha veçoritë në dritën e saj të përgjithshme. Shfaqja e kësaj lumturie ndodh në marrëdhënien vetjake dhe delikate midis dy personave, një magji e jetës, e cila, si një lloj furie dhe entuziazmi hyjnor, e pushton njeriun në një kohë të caktuar të jetës, shkakton revolucion te mendja dhe trupi, e bën pjesë të racës së tij, të marrë zotime ndaj detyrimeve shtëpiake dhe civile, të ripërtërijë afërsinë me natyrën, i rrit fuqinë e shqisave, i hap imagjinatën, i shton karakterit veti heroike e të shenjtë, krijon institucionin e martesës dhe garanton qëndrueshmërinë e shoqërisë njerëzore.

Bashkëshoqërimi i natyrshëm i ndjenjës së dashurisë me njeriun që i ndizet gjaku, e portretizon dashurinë me ngjyra të gjalla, ashtu si çdo djalë dhe vajzë mund të pohojë se e ka përjetuar me tërë qenien e vet, por nënkupton që s'duhet të jesh shumë i vjetër. Fantazitë e zjarra të rinisë nuk e pranojnë kripën e jetës së një filozofie të pjekur, e cila venit fuqinë e lulëzimit me kalimin e moshës dhe shtimin e pedantizmit. Ndaj, e di që u ngarkoj barrën e një ngurtësie dhe stoicizmi të panevojshëm atyre që mbushin oborrin dhe kuvendin e dashurisë. Por, përballë këtyre censuruesve të tmerrshëm do t'u bëj thirrje të moshuarve të mi, sepse duhet marrë parasysh që ky pasion për të cilin flasim, edhe pse fillon me të rinjtë, nuk i braktis të vjetrit, ose më mirë nuk e lejon atë që është me të vërtetë shërbëtori i tij të plakët, por përkundrazi, bën që pleqtë të jenë pjesë e tij jo më pak se vajzat e brishta, megjithëse në një mënyrë të ndryshme dhe më fisnike.

Sepse është një flakadan që, pas flakës së parë të vogël që ndizet në qoshen e një kraharori, prej një shkëndije endacake që kalon nga zemra e një njeriu te një tjetër, merr flakë dhe bëhet më e madhe derisa të ngrohë dhe shndrijë mbi burra e gra pafund, mbi zemrën universale të të gjithëve, dhe ndriçon me flakët e saj bujare gjithë botën dhe natyrën. Kësisoj, s'ka rëndësi nëse përpiqemi ta përshkruajmë pasionin në moshën njëzet, tridhjetë apo tetëdhjetë vjeçare. Ai që e portretizon në fazën e parë s'do të arrijë të përshkruajë diçka nga e fundit, ai që e portretizon në fund, s'do të përshkruajë dot disa nga veçoritë e saj më të hershme. Ajo që na mbetet të bëjmë është vetëm të shpresojmë që me durim dhe me ndihmën e Muzave, të mund të arrijmë të rrokim pamjen e brendshme të ligjit, e cila do të na japë një të vërtetë përgjithnjë të re dhe të bukur, kaq qendrore sa mund të këqyret nga çdo lloj këndi shikimi.

Dhe kushti i parë është që duhet të çlirohemi nga respekti i tepërt e absolut ndaj fakteve, dhe ta studiojmë ndjenjën siç është shfaqur te shpresa njerëzore, jo në histori. Çdo njeriu jeta e tij i duket e shfytëruar dhe e përçudnuar, ngaqë nuk është ashtu siç e imagjinon. Çdo njeri sheh në përvojën e tij një lloj njolle gabimi, ndërsa ajo e njerëzve të tjerë duket e bukur dhe ideale. Kushdo që u kthehet atyre marrëdhënieve të këndshme që janë bukuria e jetës, prej të cilave kanë nxjerrë mësimet më të mëdha dhe i kanë bërë të përfetojnë ndjenjat më të singerta, do të sprapset dhe do të ankohet. Mjerisht po! Nuk e di se pse, por brejtjet e pafundme të ndërgjegjes i bëjnë të hidhura në fazën e pjekurisë në jetë kujtimet e një gëzimi të thellë dhe lënë në hije çdo emër të shtrenjtë. Gjithçka është e bukur e parë nga pikëpamja e intelektit, ose si e vërtetë, por gjithçka është e hidhur nëse shihet si përvojë. Detajet janë të zymta, e përgjithshmja është e denjë dhe fisnike. Në botën e kohës sonë, në mbretërinë e dhimbshme të kohës dhe hapësirës, banojnë hallet e individit, plagët e shoqërisë dhe frika. Te mendimi, tek ideali, gjendet hareja e pavdekshme, trëndafili i

RALPH WALDO EMERSON

DASHURIA

përktheu Granit Zela

gëzimit. Rreth saj këndojnë të gjitha Muzat, por brengat i lidhim me emra, individë dhe interesa të vogla të djeshme dhe të sotme.

Prireja e fortë e natyrës shihet në përpjesëtimin që zë tema e marrëdhënieve intime në diskutimet e shoqërisë. Çfarë duam kaq shumë të njohim në përvojën e çdo personi të shquar në historinë e kësaj ndjenje? Çfarë librash me këtë temë gjenden në biblioteka sot? Sa na ndezin këto romane pasionante kur historia tregohet me një shkëndijë të së vërtetës dhe natyrës! Çfarë na tërheq më shumë vëmendjen në marrëdhënien e jetës, sesa një fragment që zbulon të fshehtën e dashurisë mes dy vetave? Mund të mos i kemi parë kurrë më parë dhe mund të mos i takojmë më, por i shohim të shkëmbejnë një vështrim ose të zbulojnë një emocion të thellë dhe s'jemi më të huaj. I kuptojmë dhe ndiejmë interesin më të përzemërt për zhvillimin e romancës.

I gjithë njerëzimi e do të dashuruarin. Shfaqjet më të hershme të vetëkënaqësisë dhe mirësisë janë tablotë më tërheqëse të natyrës. I dashuruari është agimi i sjelljes së qytetëruar dhe hijeshia e natyrës së ashpër e sjelljes fshatarake. Djaloshi i vrazhdë i fshatit i ngacmon vajzat te porta e shkollës, por sot vrapon për te hyrja dhe gjen një vajzë që i bien libra nga çanta. Ai ngre librat nga toka për ta ndihmuar dhe sakaq i duket sikur ajo ikën prej tij në pafundësi dhe është një qenie e shenjtë. Vrapon midis vajzave duke u treguar

i vrazhdë, por vetëm njëra e mban larg dhe këta dy fqinjë të rinj, që tani ishin kaq të afërt, kanë mësuar ta pranojnë personalitetin e ndryshëm dhe ta respektojnë njëri-tjetrin.

Për më tepër, kush mund të heqë sytë nga gjestet tërheqëse, pak dinake, pak të ngathëta të shkollares që hyn në dyqanin e fshatit për të blerë një top mëndafshi ose një fletë letre, dhe për gjysmë ore fjaloset me shitësin natyrëbutë e fytyrëmbushur të dyqanit? Në fshat ata jetojnë në barazi të përsosur, prej së cilës dashuria ngazëllet dhe pa naze, natyra e lumtur dhe e dashur e grave shket në këtë thashethemnajë të lezetshme. Vajzat mund të mos jenë shumë të bukura, por ato krijojnë qartë mes tyre dhe djalit të mirë marrëdhëniet më të këndshme dhe më të besueshme, dhe gjysmë me shaka e gjysmë seriozisht pyesin për Edgarin, Jonasin, Almirën e këdo që ishte i ftuar në festë, kush kërcëu në mbrëmjen e vallëzimit, kur do të fillojë kursi i kantos, e gjëra të tjera të vogla si këto. Me kalimin e kohës ai djalë dëshiron të ketë një grua dhe në të vërtetë, edhe në zemrën e tij do të dijë se ku të gjejë një shoqe të singertë e të ëmbël, pa rrezikun që të hidhërohet siç thotë Milioni se ndodh me dijetarët dhe njerëzit e mëdhenj.

Më kanë thënë se në disa nga fjalimet e mia publike, nderimi im për intelektin më ka bërë padrejtësisht të ftohtë ndaj marrëdhënieve personale. Por tani gati stepem sa herë kujtoj fjalë të tilla përçmuese, sepse njerëzit janë

bota e dashurisë dhe filozofi më i ftohtë nuk mund të rrëfejë borxhin e shpirtit të të riut, që endet këtu në natyrë me fuqinë e dashurisë pa tundimin për të tërhequr fjalët, për të tradhtuar natyrën, nga instinktet nënçmuese tek ato shoqërore. Edhe pse ekstaza qiellore e rënë nga qielli pushton vetëm ata në moshën më të brishtë, dhe megjithëse rrallë shohim pas moshës tridhjetë vjeçare një bukuri të aftë të tejkalojë çdo analizë apo krahasim për të na nxjerrë përballë vetes, sidoqoftë, kujtimi i këtyre vizioneve i rron më gjatë se të gjitha kujtimet e tjera, dhe është një kurore me lule në kryet e më të moshuarve. Megjithatë, kemi një fakt të çuditshëm: shumë njerëzve, kur i rikthehen përvojës së tyre, mund t'u duket se nuk kanë faqe më të bukur në librin e jetës, sesa kujtimi i paharrueshëm i disa fragmenteve në të cilat dashuria arriti të krijojë një magji që shkoi përtej tërheqjes së madhe të së vërtetës së vet, ndaj një morie rrethanash rastësore dhe të parëndësishme. Kur hedhin sytë pas në jetë, ata mund të zbulojnë se gjëra të ndryshme që nuk ishin magjike, në të vërtetë ishin më reale sesa vetë magjia që i ka gdhendur në kujtesë.

Cilado qoftë përvoja jonë e veçantë, asnjë njeri nuk i ka harruar asnjëherë vizitat e asaj fuqie në zemrën dhe trurin e tij, të cilat krijuan të gjitha gjërat e reja, duke u bërë tek ai agimi i muzikës, poezisë dhe artit, që e bën fytyrën e natyrës të rrezatojë dritë shprese, mëngjeset dhe netët magjepsëse, kurse tonin e zërit të tillë që ta bëjë zemrën të hovë dhe rrethanat më të parëndësishme të bëra njësh në qelbarin e kujtesës, kur u bë i gjithi sy e veshë kur dikush ishte i pranishëm dhe gjithë kujtesë kur largohej, kur i riu vëzhgonte dritaret, këqyrte i përhumur një dorashkë, një vello, fjongon ose rrotat e karrocës me kuaj, kur asnjë vend nuk është shumë i vetmuar dhe asnjë vend nuk është shumë i heshtur për atë që ka shoqëri më të mirë dhe bisedë më të ëmbël me mendimet e tij të reja, sesa miqtë e vjetër, edhe nëse janë më të mirët dhe më të kulluarit, sepse figurat, lëvizjet, fjalët e njeriut të shtrenjtë, nuk janë si imazhet e tjera të shkruara në akull, por janë, siç thoshte Plutarku, "të farkëtuara në zjarr" dhe janë lënda e përsiatjeve të mesnatës.

*Ti je larguar, por nuk ke ikur, kudo që të jesh,
Ata sy vigjilentë e zemër të dashur, tek ai
do ta kesh.*


Në mesditën dhe muzgun e jetës ne ende na emocionon kujtimi i ditëve kur lumturia nuk ishte aq e lumtur, por duhej të trajtohej me melhem e dhimbjes dhe frikës, sepse sekretin e saj e zbuloi ai që tha për dashurinë se: "S'ia vlen të provosh dhimbjen për asnjë kënaqësi tjetër"¹ dhe kur dita s'mjaftonte e as nata, duhej të zhyteshe në kujtime të bukura, kur gjumi nuk të zinte me kryet mbi nënkresë, me aktin bujar për të cilin duhej të shërbente, kur drita e hënës ishte një ethe e këndshme, yjet ishin shkronja, lulet ishin kumte dhe ajri kishte krijuar një këngë, kur çdo vepër dukej e paturpshme dhe të gjithë burrat e gratë që rendnin lart e poshtë nëpër rrugë, ishin thjesht imazhe.

Pasioni rindërton botën për të rinjtë. I bën të gjitha gjërat të gjalla dhe me kuptim. Natyra bëhet e ndërgjegjshme. Çdo zog në degët e pemës tani i këndon zemrës dhe shpirtit të tij. Notat janë pothuajse të plota. Retë kanë fytyra kur ai i shikon. Pemët e pyllit, bari valëvitës dhe lulet bëhen të mençura, dhe ai pothuajse ka frikë t'ua besojë atyre sekretin që duket se e ftojnë të tregojë. Sidoqoftë, natyra të qetëson dhe të pëlqen. Në vetminë e gjelbër ai gjen një shtëpi më të dashur se ajo me njerëz.

"Burime dhe korije pa shtigje,
Vende që pasioni i zbehtë i do,
Shëtijte në dritën e hënës, kur të gjithë
shpendët
Strehohen të sigurt, përveç lakuriqëve
dhe bufave,
Një rënkim që shuhet, një zile në mesnatë,
Këto janë tingujt që na mbajnë gjallë".²

¹ John Done, *Këngë për martesën*.

² Vargje nga akti i tretë i *Guximi i këndshëm*, ose, *I çmenduri pasionant*.



RALPH WALDO EMERSON

Vetëbesimi

dhe ese të zgjedhura

Minerva

Ja atje në pyll i çmenduri i mirë! Ai është një pallat tingujsh e pamjesh të ëmbla, zmadhohet, është sa dy burra, ecën me krahë në ijë, flet me veten, përkulet mbi bar dhe u afrohet pemëve, ndien gjakun e manushaqes, tërfilit dhe zambakut në damarët e tij, flet me përroin që i lag këmbët.

Zjarrmia që i ka hapur perceptimet për bukurinë natyrore e ka kthyer atë në muzikë dhe vargje. Është një fakt i vërejtur shpesh se ka nga ata që kanë shkruar vargje të mira nën frymëzimin e pasionit, edhe pse s’mund të shkruajnë mirë në asnjë rrethanë tjetër. E njëjta forcë bën që pasioni të zotërojë të gjithë natyrën e saj. Zgjeron ndjenjën, e bën gaztorin e butë dhe i jep guxim frikakakut. Më fatkeqit dhe të mjerit, i jep zemër dhe i ngjall guximin të sfidojë botën vetëm për njeriun që do. Duke i dhënë një tjetri, ai i jep vetes më shumë. Ai është njeri i ri, me perceptime të reja, me objektiva të reja e më të qarta, ndërsa karakteri dhe synimet marrin solemnitet fetar. Nuk i përket më familjes dhe shoqërisë, ai është diçka, është person, është shpirt.

Atëherë, le të shqyrtojmë më nga afër natyrën e këtij ndikimi të fuqishëm te rinia njerëzore. Bukuria, shfaqjen e së cilës te njeriu ne kremtojmë sot, e mirëpritur si dielli kurdo që shkëlqen, e pëlqyer nga të gjithë dhe me të cilën të gjithë gëzohen, duket e vetë-mjaftueshme. I dashuruari nuk mund ta pikturojë të dashurën me fantazinë e tij të varfër dhe i vetmuar. Ashtu si një pemë në lulëzim, kaq e butë, me sytha që çelin, përcjell magjinë e së bukurës te shoqëria dhe ajo i mëson vështrimit të syrit të tij pse bukuria është portretizuar me dashuri dhe hijeshi kudo ku ajo ka shkelur. Ekzistenca e saj e pasuron botën. Edhe pse i dëbon të tjerët nga vëmendja e tij si të lirë dhe të padenjë, ajo e kompenson atë duke e kthyer qenien e saj në diçka jo personale e të madhe të kësaj bote, në mënyrë që vasha t’i duket atij përfaqësuese e të gjitha gjërave dhe virtyteve të zgjedhura. Për këtë arsye, i dashuruari nuk sheh kurrë ngjashmëri mes së dashurës së tij, të afërmve ose të tjerëve. Për miqtë e tij ajo ngjan me të ëmën, motrat ose njerëzit jo të afërm. I dashuruari nuk sheh asnjë ngjashmëri përveç perëndimit të verës dhe mëngjeseve të shndritshme, me ylberet dhe këngët e zogjve.

Të lashtët e quanin bukurinë lulëzim të virtytit. Kush mund të analizojë sharmin e paemër që shfaqet sa nga njëra fytyrë dhe trup në tjetrën? Ne prekemi nga emocionet e butësisë dhe vetëkënaqësisë, por s’mund ta dimë se ku të çon ky emocion delikat, ky shkëlqim endacak. Çdo përpjekje për ta lidhur me diçka e shkatërron atë për imagjinatën. As nuk tregon për marrëdhënie miqësie apo dashurie të njohura dhe të përshkruara në shoqëri, por, siç besoj, drejt një sferë tjetër e të paarritshme, te marrëdhëniet me delikatesë dhe ëmbëlsi transcendentale, të cilat i nënkuptojnë dhe paralajmërojnë trëndafilat dhe manushaqet. Nuk mund t’i afrohemi bukurisë. Natyra e saj është si ajo e shkëlqimit ngjyrë qumështi në qafën e pëllumbave, që luhatet dhe zhduket. Prandaj ngjan me gjërat më të përkryera, ato që kanë këtë karakter të ylbertë, që sfidojnë çdo përpjekje për përvetësim dhe përdorim.

Çfarë donte të përçonte tjetër Zhan Pol Rihteri³ kur tha për muzikën: “Ik, ik, sepse ti më flet për gjëra që në jetën time të pafund nuk i kam gjetur dhe as do t’i gjej”? E njëjta rrjedhshmëri mund të vërehet në të gjitha veprat e arteve plastike. Statuja është e bukur kur fillon të jetë e pakuptueshme, kur shkon përtej kritikës dhe s’mund të matet më me busull dhe metrin e gjeometrit, por përkundrazi kërkon imagjinatë aktive për ta deshifruar dhe për të thënë se çfarë është. Zoti ose heroi i skulptorit gjithmonë përfaqësohet te kalimi nga ajo që është e përfaqësueshme për shqisat, në atë që nuk është. Pastaj, për herë të parë pushon së qeni gur. E njëjta gjë mund të vërehet edhe për pikturën, edhe për poezinë, ku suksemi nuk arrihet kur ajo të nanurit dhe të kënaq, por kur të mahnit

^[1] Jean-Paul Richter (1847 – 1937) historian arti nga gjermania

dhe të emocionon me përpjekje të reja drejt të paarritshmes. Në lidhje me këtë, Landor⁴ kërkon të marrë vesh “nëse nuk duhet t’i referohet një gjendjeje më të pastër ndjesie dhe ekzistence”.

Në të njëjtën mënyrë, bukuria personale është fillimisht magjepsëse dhe ajo vetë kur na lë të pakënaqur prej çdo fundi që ka, kur bëhet një histori pa fund, kur sugjeron pamje dhe vizione, jo kënaqësi tokësore, kur e bën shikuesin të ndiejë se ai është i padenjë e nuk ka të drejtë ta ketë, sikur të ishte Cezari, ai as nuk mund të ndiejë se ka më shumë të drejtë ta ketë, ashtu siç nuk mund të ketë qiellin dhe madhëstlinë e një muzgu.

Këtu vjen thënia, “nëse të dua, çfarë ndryshimi bën kjo?”. E themi këtë sepse mendojmë se ajo që duam nuk varet nga vullneti ynë, por qëndron përtej tij. Nuk jeni ju, por rrezatimi juaj. Është ajo që ju nuk e dini në vetvete dhe nuk mund ta dini kurrë.

Kjo përputhet me atë filozofi të lartë të bukurisë që vlerësonin të ngazëllyer shkrimtarët e lashtë, të cilët thoshin se shpirti i njeriut, i mishëruar këtu në tokë, endej lart e poshtë në kërkim të asaj bote tjetër të vetën nga e cila kishte dalë, por shpejt u mahnit nga drita e natyrshme e diellit dhe nuk ishte në gjendje më të shihte asnjë objekt përveç atyre të kësaj bote, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse hije të gjërave reale. Prandaj Hyjnia dërgon lavdinë e rinisë para shpirtit, në mënyrë që ajo të përfitojë nga trupat e bukur për të kujtuar mirësinë dhe bukurinë qiellore, dhe burri që admiron një njeri të tillë të seksit femër vrapon pas saj dhe zbulon gëzimin më të madh në soditjen e formës, lëvizjes dhe inteligjencës së këtij personi, sepse i sugjeron atij praninë e asaj që, në fakt, është brendësia e bukurisë dhe shkaku i së bukurës.

Mirëpo, nëse në trajtimin e tepërt të sendeve materiale shpirti ishte vulgar dhe e zhvendosi kënaqësinë e tij në trup, ai nuk mori asgjë tjetër veç trishtimit, sepse trupi nuk arrin të përmbushë premtimin që ofron bukuria; por nëse, duke pranuar shenjat e këtyre vizioneve dhe sugjerimeve që bukuria i jep mendjes, shpirti përshkon trupin dhe arrin të admirojë gjurmët e karakterit, e të dashuruarit shohin njëri-tjetrin në bisedat dhe veprimet e tyre, atëherë ata kalojnë nëpër pallatin e vërtetë të bukurisë, bukuria, dashuria e tyre për të bëhet gjithnjë e më e ndezur dhe ndërsa kjo dashuri shuan tërheqjen fillestare, ashtu siç shuan dielli zjarrin që ndriçon në vatër, ata bëhen të pastër dhe të shenjtë.

Duke u marrë me atë që është në vetvete e shkëlqyer, madhështore, e lartë dhe e drejtë, i dashuruari ndien një dashuri më të ngrohtë për këtë lloj fisnikërie dhe e rrok atë më shpejt. Pastaj ai kalon nga dashuria e një njeriu te dashuria për të gjithë, dhe kështu shpirti i bukur është vetëm dera përmes së cilës njeriu hyn në shoqërinë e të gjithë shpitrave të vërtetë e të pastër. Në shoqërinë e veçantë të bashkëshortes, ai fiton një pamje më të qartë të çfarëdo mangësie, çfarëdo të mete që bukuria e saj ka marrë në këtë botë, e është në gjendje ta vërë në dukje, dhe kjo bëhet me gëzim të ndërsjellë që tani mund të vënë në dukje, pa fyerje, të metat dhe pengesat te tjetri, si dhe t’i japin njëri-tjetrit ndihmën dhe rehatinë për t’i hequr ato. Duke soditur në shumë shpirtira tiparet e bukurisë hyjnore dhe duke ndarë në secilin shpirt atë që është hyjnore nga e meta që ka marrë në botë, i dashuruari ngjitet te bukuria më e epërme, te dashuria dhe njohja e Hyjnisë, me anë të kësaj shkalle shpirttrash të krijuar.

Diçka të ngjashme me këtë na është thënë për dashurinë nga të urtët e vërtetë në të gjitha epokat. Doktrina nuk është as e vjetër dhe as e re. Nëse Platoni, Plutarku dhe Apuleiusi⁵ na e kanë mësuar këtë, kështu kanë bërë edhe Petrarka, Mikelanxhelo dhe Miltoni. Kjo doktrinë pret një shfaqje më të vërtetë duke kundërshtuar dhe hedhur poshtë atë maturi të nëndheshme që mbizotëron në

^[2] Walter Savage Landor (1775 – 1864) shkrimtar, poet dhe aktivist anglez

^[3] Apuleius-i ishte prozator, filozof dhe orator platonist

martesat me fjalë të rrëmbyera nga bota e epërme, ndërsa njëri sy vështron në bodrum, në mënyrë që ligjërata e tij më serioze të ketë shijen e proratës dhe grurit. Më e keqja është kur ky sensualizëm ndërhyt në edukimin e grave të reja dhe vyshk dashurinë dhe shpresën e natyrës njerëzore, duke na mësuar se martesa nuk do të thotë asgjë më shumë se shpëtimi i shtëpiakes, dhe se jeta e gruas nuk ka qëllim tjetër.

Por kjo ëndërr dashurie, edhe pse e bukur, është vetëm një skenë në dramën tonë. Në shtegtimin e shpirtit nga jashtë, ai gjithmonë shton rrathët e tij, si guraleci i hedhur në pellg ose drita që vjen nga një rruzull. Rrezet e shpirtit ndriçojnë së pari gjërat që janë më afër, në çdo vegël, lodër, shtëpinë, kopshtin dhe kalimtarët, rrethin e të njohurve të fisit, politikën, gjeografinë dhe historinë. Por gjërat gjithmonë grupohen sipas ligjeve më të larta ose më shumë të brendshme. Lagjja, madhësia, numrat, zakonet, njerëzit gradualisht humbasin fuqinë e tyre mbi ne. Më pas mbizotërojnë shkaku dhe pasoja, afritë e vërteta, dëshira e madhe për harmoninë midis shpirtit dhe rrethanës, instinkti përparimtar, idealizues, mbizotëron më vonë dhe hapat pas nga marrëdhëniet e njiveleve më të larta te ato më të ulëta bëhet i pamundur. Kështu edhe dashuria, e cila është hyjnizimi i personave, duhet të bëhet çdo ditë më jopersonale. Në fillim nuk ka asnjë shenjë të kësaj. Nuk mendojnë shumë i riu dhe e reja që shikojnë njëri-tjetrin në dhoma të mbushura me njerëz, me sytë që shkreprijnë nga inteligjenca e ndërsjellë, nuk mendojnë për frytin e çmuar që do të burojë nga ky stimul i ri, tërësisht i jashtëm.

Puna e bimësisë fillon së pari me ashpërsimin e lëvores dhe sythave. Pasi shkëmbejnë shikime, ata përparojnë tek aktet e mirësjelljes, guximit, pastaj i pushton pasioni i zjarrtë, derisa arrijnë te zotimet dhe martesa. Pasioni e sheh objektin e tij si një tërësi të përsosur. Shpirti mishërohet plotësisht dhe trupi shpirtëzohet plotësisht.

“Gjaku i saj i pastër dhe i rrjedhshëm Fliste në faqet e saj, aq qartë e dallueshme Sa gati mund të thuhej se trupi i saj mendonte”.⁶

I vdekur, Romeos iu desh të ndahej në yje të vegjël për të zbukuruar qiellin. Jeta, me këtë çift, nuk ka qëllim tjetër, s’kërkon gjë tjetër veç Xhulietës, veç Romeos. Nata, dita, studimet, talenti, mbretëritë, feja, të gjitha janë të përfshira në këtë formë shpirtërore, në këtë shpirt që është e gjitha forma. Të dashuruarit gjejnë kënaqësi te përkëdheljet, te pohimet e dashurisë, kur krahasohen mes tyre. Kur janë vetëm, ata ngushëllohen me shëmbëlltyrën e kujtuar të tjetrit.

A sheh tjetri të njëjtin yll që zhduket, a lexon të njëjtin libër, ndjen të njëjtin emocion që tani më gëzon? Ata e testojnë dhe matin dashurinë e tyre dhe, duke shtuar përparësi të dukshme, miqtë, mundësitë, pronën, gëzohen kur zbulojnë se me dëshirë, me gëzim do të dorëzojnë gjithçka si shpërblim për zemrën e bukur e të dashur, me kusht që të mos dëmtohet asnjë fije floku. Fati i njerëzimit është te këta fëmijë. Rreziku, pikëllimi dhe dhimbja i vijnë si gjithë të tjerët. Dashuria lutet. Në emër të këtij shoku të dashur, ajo vulos paktin me fuqinë e përjetshme. Bashkimi i jetësuar në këtë mënyrë, i cili i shton një vlerë të re çdo atomi në natyrë, sepse shndërron çdo fije në të gjithë rrjetin e marrëdhënieve në një rreze të artë dhe e lan shpirtin me një element të ri dhe të ëmbël, është megjithatë një gjendje e përkohshme. Lulet, perlat, poezitë, deklaratat solemne, madje as foleja në zemrën e dikujt tjetër s’mund të kënaqin gjithmonë shpirtin e keq që është zhytur në baltë. Ai lind më në fund nga këto përkëdhelje, si lodrat, dhe vendos parzmoren dhe bën përpara drejt qëllimesh të gjera dhe universale. Shpirti që gjendet në shpirtin e secilit, duke dëshiruar fort një lumturi të përsosur, zbulon mospërputhjet, të metat dhe sjelljen jo të njëjtë të tjetrit.

Prej kësaj lindin habia, qortimi dhe dhimbja. Megjithatë, ajo që i tërhoqi drejt njëri-tjetrit ishin shenja të dashurisë, shenja të virtytit dhe këto virtyte, edhe pse të lëna në hije, janë ende aty. Ato shfaqen dhe rishfaqen dhe vazhdojnë të tërheqin, por ndryshojnë, braktisin shenjën dhe i bashkohen thelbit. Kjo përmirëson dashurinë e dëmtuar. Ndërkohë që jeta vazhdon, ajo shfaqet si një lojë ndryshimi dhe kombinimi i të gjitha mundësive të palëve, për të shfrytëzuar të gjitha burimet përkatëse dhe për t’i bërë të ditur secilës prej tyre forcën dhe dobësinë e tjetrit. Sepse ata duhet t’i tregojnë njëri-tjetrit dhe racës njerëzore natyrën dhe synimin e kësaj lidhjeje. Gjithçka në botë, ajo që dihet ose duhet ditur, është farkëtuar me dinakëri në strukturën e burrit, të gruas.

Te ai që dua dhe është shpirti binjak Janë të gjithë të tjerët nga pak.⁷

Bota rrotullohet, rrethanat ndryshojnë nga ora në orë. Engjëjt që banojnë në këtë tempull të trupit, shfaqen në dritare ashtu si edhe veset. Ato bashkohen prej të gjitha virtyteve. Nëse ka virtyt, të gjitha veset njihen; ato shfaqen dhe zhduken. Forma dikur e ashpër me kalimin e kohës zbutet në gjoksin e secilit dhe, duke humbur ashpërsinë që fiton me shtrirjen në kohë, ajo merr kuptimin themelor. Ata i dorëzohen njëri-tjetrit, pa u ankuar, për të kryer në kohë detyrat e mira për të cilat janë përcaktuar qartë burri dhe gruaja, dhe shkëmbejnë pasionin që dikur nuk arriti të humbte nga sytë objektin e tij me një lehtësi, gëzim, prani ose mungesë, sipas tipareve të secilit.

Më në fund ata zbulojnë se gjithçka që i bashkonte fillimisht, ato tipare që dikur ishin të shenjta, ajo lojë magjike tërheqjesh, shembej, kishte një fund të parashikuar, si skela me të cilën ndërtohet shtëpia, dhe pastrimi i intelektit dhe zemrës, vit pas viti, është martesa e vërtetë, e planifikuar dhe e përgatitur që nga fillimi dhe plotësisht në ndërgjegjen e tyre.

Me këto qëllime, sipas të cilave dy njerëz, një burrë dhe një grua, të pajisur me dhunti kaq të larmishme dhe të bashkëlidhura, jetojnë në një shtëpi për të kaluar dyzet apo pesëdhjetë vjet jetë martesore, nuk jam i befasuar nga mënyra me të cilën zemra e profetizon këtë krizë që në fëmijërinë e hershme, te bukuria e begatë me të cilën instinktet stolisin strehën martesore dhe që natyra, intelekti dhe arti rivalizojnë njëri-tjetrin në dhuratat dhe melodinë e këngës së martesës.⁸


Kështu përgatitemi për një dashuri që s’njuh as gjininë, as njeriun, as anshmërinë, por kërkon kudo virtytin dhe mençurinë me qëllim që t’i shtojë ato. Ne jemi nga natyra vëzhgues dhe për këtë arsye xnëës. Kjo është gjendja jonë e përhershme, por shpesh mendojmë se dashuritë tona janë vetëm tenda të një nate. Edhe pse ngadalë dhe me dhimbje, objektet e dashurisë sonë ndryshojnë, ashtu si objektet e mendimit. Ka raste kur dashuritë sundojnë dhe përpijnë njeriun dhe bëjnë që lumturia e tij të varet nga një ose më shumë njerëz; por kur gëzon shëndet, mendja shihet menjëherë sërisht, harku i saj i lartë, që shkëlqen prej galaktikave të përhershme të dritës, dhe dashuritë e frikërat e ngrohta që kaluan mbi ne si retë duhet të humbasin kuptimin e tyre dhe të bëhen njësh me perëndinë për të arritur përsosmërinë e tyre.

S’duhet të kemi frikë se mund të humbasim ndonjë gjë nga përparimi i shpirtit. Shpirtit mund t’i besohet deri në fund. Diçka kaq e bukur dhe tërheqëse sa këto marrëdhënie duhet të ndiqet dhe të zëvendësohet vetëm nga diçka më e bukur, e kështu me radhë, përgjithmonë.

^[4] Vargje nga një poezi e poetit Abraham Coëley me titullin, “I vendosur për t’u dashur”. Strofa e parë: E vërtetë që kam dashur tre ose katër/dhe do të dua tre ose katërqind të tjerë/Këdo prej tyre do ta dua/Derisa të gjejë atë që më do mua. Strofa e fundit: “Nuk kërkoj shumë, më jep vetëm një/Me të jetoj në përjetësi/te ai që dua dhe është shpirti binjak/Janë të gjithë të tjerët nga pak

^[5] Një këngë ose poezi që kremton martesën

Një debutim mbresëlënës dhe krejtësisht origjinal, nga një yll në ngritje i letërsisë koreane. Fabula surreale, drithëruese që sfidojnë patriarkatin, kapitalizmin dhe mbretërimin e teknologjive të mëdha, me humor absurd.



Nga një shkrimtare e pabotuar më parë në Shqipëri, “Lepurushi i mallkuar” është unik dhe plot imagjinatë, përzier horrorin, fantashkencën, përrallat dhe trillimin spekulativ, në tregime që sfidojnë kategorizimin. Njëherë provokues e njëherë të neveritshëm, përbindëshat këtu marrin format e krijesave me gëzof të pyllit dhe rreziku fshihet në cepat e papritura të godinave të zakonshme. Por në këtë përmbledhje të paharrueshme, universi absurd dhe përndjekës i Chung-ut mund të jetë i yni, duke hedhur dritë mbi të këqijat e shoqërisë bashkëkohore.